

Diana Gaxha

LIBËR PËR MËSUESIN/EN

BIOLOGJIA 6

Për klasën e 6-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2024



Lejohet për botim teksti shkollor për klasën e gjashtë, me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, nr. 01B-080, të datës 19.07.2024.

BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t: Valon MORINA,
Edison KASUMAJ, Rozafa SHALA
Korrektore letrare: Orida DAJKO
Paraqitja grafike dhe kopertina: Elvis BEJTJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-843-25-6

© Botime Pegi sh.p.k., dega në Kosovë, korrik 2024
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Hyrje

Mësues të dashur!

Ky libër për mësuesin/en, ju vjen në ndihmë në punën tuaj të përditshme, me anë të planifikimeve dhe udhëzimeve që ofron.

Udhëzimet e tij bazohen në programin mësimor të miratuar nga MASHTI.

Libri për mësuesin/en dhe teksti mësimor janë hartuar në përputhje me programet orientuese. Nëpërmjet njësive mësimore model, që ndodhen në këtë libër për mësuesin/en, ju do t'i orientoni nxënësit/et tuaj drejt krijimit të kompetencave, punës kërkimore, gjetjes dhe zgjidhjes së situatave problemore.

Përveç udhëzimeve që të ofron dhe të detyron programi mësimor, në këtë libër sugjerohen plani vjetor, si dhe një model i planit dymujor dhe modele të planifikimeve ditore. Ju mund t'i përmbaheni këtyre planifikimeve, por jeni të lirë të bëni planifikimet tuaja në përputhje me kërkesat dhe nivelin e nxënësve tuaj.

Mirëpresim çdo këshillë dhe mendim nga ju.

Ju urojmë punë të mbarë!

Lëndët e fushës kurrikulare I	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës
	Gjysmëvjetori i parë		Gjysmëvjetori i dytë		
	Shtator-Tetor 18 orë	Nëntor-Dhjetor 15 orë	Janar-Shkurt-Mars 22 orë	Prill-Maj-Qershor 19 orë	
Biologji	Biodiversiteti (18 orë)	Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor (5 orë)	Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor (22 orë)	Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor (13 orë) Shëndeti,sjelljet dhe emocionet e njeriut (6 orë)	Komunikues efektiv I. 1, 2, 3, 4, 6. Mendimtar kreativ dhe kritik II. 3, 4, 5, 6, 7. Nxënës i sukseshëm III. 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8. Kontribues produktiv IV. 2, 3, 4, 7. Individi i shëndoshë V. 7, 9. Qytetar i përgjegjshëm VI. 1, 4.

PLANI DYMUJOR: SHTATOR-TETOR

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Lënda mësimore: Biologji

Klasa: VI

Tema mësimore: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

I. Komunikues efektiv

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

I.3 Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II. Mendimtar kreativ dhe kritik

II.1 Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.

II.3 Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematikor, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim

II.7 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

III. Nxënës i suksesshëm

III.1 Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

III.7 I parashtrohet pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

III.8 Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:
Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe**

mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë së ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Biodiversiteti	2- Shpjegon konceptin, Biologjia – shkencë natyrore. 3- Identifikon rregullat themelore të emërimit, klasifikimit dhe kategoritë taksonomike të qenieve të gjalla. 5- Përshkruan organizimin shkallë – shkallë të sistemeve biologjike- ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve , organizmi (individ), popullata, bashkësia jetësore, ekosistemi dhe biosfera. 6- Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike.	1-Njohja e nxënësve me plan-programin e vitit shkollor 2023/24 2-Objekti i studimit të biologjisë. Metoda shkencore e studimit të saj. 3-Veçoritë e gjallesave 4-Ushtrim 5-Qeliza, njësia më e vogël e ndërtimit të gjallesave. Qeliza bimë dhe ajo shtazore. 6-Punë praktike	1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë	Mësimdhënie dhe nxënëse me në qendër nxënësin dhe gjithëpërfshirjen Mësimdhënia dhe të nxënësve integruar Mësimdhënia dhe të nxënësve të diferencuar Mësimdhënie dhe të nxënësve bazuar në arritjen e kompetencave Çështje/tema ndërkurrikulare Tabelat, Kllaster, Ndërturja II, Brainstorming, Shqyrtimi kategorizues,	Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësimi i diskutimeve, prezantime. Vlerësimi me shkrim (ese, raportet e punës) Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale Vlerësimi për ecuren dhe produktin e punës me projekte	Gjuhë shqipe Matematikë Fizikë Art Kimi Çështje ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Teksti i nxënësve

8- Përkshkruan organizimin shkallë – shkallë të sistemeve biologjike- ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve , organizmi (individu), popullata, bashkësia jetësore, ekosistemi dhe biosfera.	7-Punë praktike (shpjegojmë si të mësojmë përmes projekteve)	1 orë	Projekt diskutimi, Shqyrtime, Ese, Parashikime me tema paraprake, Leximi në dyshe, Diagrami i Venit, Mendo/puno në dy dhe/thuaja grupit, Tabela e koncepteve	Vlerësimi individual dhe grupor, gjatë punës kërkimore Vlerësimi i detyrave të shtëpisë Vlerësim për të nxënë	
10,11,12- Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike.	8-Nga qelizat tek organizmi. Nivelet e organizimit të qelizave. 9-Ushtrime	1 orë			
13,14- Identifikon produktet e jetës së përditshme të cilat kanë origjinë nga diversiteti i organizmave (p.sh., mëndafshi nga krimbi i mëndafshit, suplementet ushqimorë, shampoonët, pastaj e dhëmbëve dhe deodorantët që përmbajnë polen të mbledhur nga bletët etj.).	10-Bota e gjallesave 11-Punë eksperimentale 12-Protistët	1 orë			
15- Tregon vetëdijësim që bakteret mund të kenë efekte të dobishme dhe të dëmshme për organizmin (bakteret në traktin digjestiv mund të ndihmojnë tretjen ose të shkaktojnë sëmundje.)	13-Mikroorganizmat 14- Mikroorganizmat dhe sëmundjet	1 orë			
	15-Mikroorganizmat dhe kalbëzimi 16-Roli pozitiv i disa mikroorganizmave	1 orë			
	17-Projekt (bakteret në traktin digjestiv mund të ndihmojnë tretjen ose të shkaktojnë sëmundje.)	1 orë			
	18- Projekt	1 orë			

PLANI DYMUJOR: NËNTOR-DHJETOR

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Lënda mësimore: Biologji

Klasa: VI

Tema mësimore: Tema 1-Biodiversiteti ; Tema 2-Qenjet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: Tema 1-Biodiversiteti

I. Komunikues efektiv:

1.1 Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.

1.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

1.3 Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

1.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

1.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II. Mendimtar kreativ dhe kritik

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III. Nxënës i suksesshëm

III.2 Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Tema 2-Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

I. Komunikues efektiv:

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

I.3 Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II. Mendimtar kreativ dhe kritik

II.1 Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III. Nxënës i suksesshëm

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela).

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Biodiversiteti	19- Identifikon dhe përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve dhe shpezëve (p.sh. invertetorët nuk kanë shyllë rruzore; insektet kanë tri pjesë themelore të trupit; bimët me lule prodhojnë lule dhe fryje) dhe i përdorë këto karakteristika për klasifikimin e mëtejshëm të llojeve të ndryshme të bimëve dhe shpezëve (p.sh. invertetorët- arthropodat- insektet; vertetorët- gjitarët- primatë; bimët me fare- bimët me lule- bimët barishtore). 20- Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike . 21- Identifikon dhe përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve dhe shpezëve (p.sh. invertetorët nuk kanë shyllë rruzore; insektet kanë tri pjesë themelore të trupit; bimët me lule prodhojnë lule dhe fryje) dhe i përdorë këto karakteristika për klasifikimin e mëtejshëm të llojeve të ndryshme të bimëve dhe shpezëve (p.sh. invertetorët- arthropodat- insektet; vertetorët- gjitarët- primatë; bimët me fare- bimët me lule- bimët barishtore). 21- Krahason karakteristikat e organizmave brenda mbretërive të bimëve ose shpezëve (p.sh. krahason karakteristikat e një peshku dhe një gjatari, të një pemë gjetëmbajtëse -halore dhe një pemë gjetërrëse, të farnave dhe bimëve me lule). 22- Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike.	19-Kërpudhat dhe algat 20- Bimët 21-Gjallesat shumëqelizore pa kolonë vertebrore (jovertebroret) 22-Kafshët me shyllë kurrizore (vertebroret) 23-Identifikimi i një gjallese bazuar në veçoritë e saj	1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë	Mësimdhënie dhe nxënie me nxënësin në qendër dhe gjithpërfshirjen Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar Mësimdhënia dhe të nxënit të diferencuar Mësimdhënie dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave Format e punës: Leximi në dyshe, tabela e koncepteve, Vëzhgo, analizo thuaja grupit, Organizues grafik, Teknika e pyetjeve, Copëzat e përziera, Tabela e tipareve semantike, Kllaster, Ruaje fjalën e fundit për mua, Pesëvargëshi, D.R.T.A, Brainstorming, Ditari dypjesësh, shkrimi i lirë	Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësimi i diskutimeve, prezantime. Vlerësimi me shkrim(ese, raportet e punës) Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale Vlerësimi individual dhe grupor, gjatë punës kërkimore Vlerësimi i detyrave të shtëpisë Vlerësim për të nxënë Vlerësimi përmbledhës Vlerësimi i ndërsjellët Lista e kontrollit	TIK-un, Kimi, Art, Gjuhë shqipe, Matematikë, Gjeografi, Fizikë Çështje ndërkurrikulare: Edukim për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Teksti i nxënësit, Interneti, Natyra.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor	23- Përdorë çelësa të thjeshtë dikoromik për identifikimin dhe klasifikimin e organizmave të gjallë.	24-Aktivitet (identifikimi i gjallesave)	1 orë				
	25- Demonstron të kuptuarit e biodiversitetit si llojllojshmëri e jetës në Tokë, duke përfshirë llojllojshmërinë brenda secilës specie, ndërmjet specieve të bimëve dhe shtazëve në bashkësi jetësore, si dhe ndërmjet bashkësive jetësore dhe peizazhit fizik që i mbështet ato.	25-Llojet e gjallesave dhe emërtimi shkencor i tyre	1 orë				
	26- Demonstron të kuptuarit e biodiversitetit si llojllojshmëri e jetës në Tokë, duke përfshirë llojllojshmërinë brenda secilës specie, ndërmjet specieve të bimëve dhe shtazëve në bashkësi jetësore, si dhe ndërmjet bashkësive jetësore dhe peizazhit fizik që i mbështet ato.	26-Ndryshueshmëria brenda llojit	1 orë				
	27- Demonstron të kuptuarit e biodiversitetit si llojllojshmëri e jetës në Tokë, duke përfshirë llojllojshmërinë brenda secilës specie, ndërmjet specieve të bimëve dhe shtazëve në bashkësi jetësore, si dhe ndërmjet bashkësive jetësore dhe peizazhit fizik që i mbështet ato.	27- Ndryshueshmëria (Variacioni)	1 orë				
		28-Aktivitet (ndryshueshmëria brenda llojit)	1 orë				
		29-Testi	1 orë				

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	30-Përdorë fjalor të duhur shkencor dhe teknologjik gjatë komunikimit gojor ose me shkrim duke përfshirë: klasifikimi, biodiversiteti, bashkësia jetësore natyrore (biocenoza), marrëdhëniet e ndërsjella, vertebrorët- kurrizorët, invertebrorët- parvuarorët, stabiliteti, karakteristikat, organizmi etj.	30-Vendbanimi i gjallesave. Biosfera	1 orë				
	31- Identifikon faktorët të cilët ndikojnë në ekzistencën e një organizmi- karakteristikat fizike të mjedisit (temperatura, drita, uji), disponueshmëria e ushqimit- tipat e organizmave tjerë të pranishëm (prodhuesit, konsumuesit, shpërbërësit).	31-Faktorët fizikë dhe kimikë që ndikojnë në jetën e gjallesave	1 orë				
	32- Identifikon faktorët të cilët ndikojnë në ekzistencën e një organizmi- karakteristikat fizike të mjedisit (temperatura, drita, uji), disponueshmëria e ushqimit- tipat e organizmave tjerë të pranishëm (prodhuesit, konsumuesit, shpërbërësit).	32-Cilësia e tokës, ujit dhe ajrit ndikon në jetën e gjallesave 33-Ushtrime (cilësia e tokës, ajrit, ujit)	1 orë 1 orë				

PLANI TREMUJOR: JANAR-SHKURT-MARS

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Lënda mësimore: Biologji

Klasa: VI

Tema mësimore: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

I. Komunikues efektiv

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

I.3 Veçon porositë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II. Mendimtar kreativ dhe kritik

II.4 Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

II.7 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

III. Nxënës i suksesshëm

III.1 Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

III.7 I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

III.8 Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhembijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmëria e ekosistemeve, ndërtimi dhe funksioni i sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor	34- Diskuron efektin në organizma kur mjedisi bëhet i pafavorshëm (organizmi përshtrahet dhe mbijeton, zhvendoset në një vend tjetër ose vdes). 36- Bënë dallimin mes termave organizëm, popullatë dhe bashkësi jetësore.- Organizmi është qenie e gjallë. Popullata definohet si grup i bimëve ose shtazëve të llojit të njëjtë që jetojnë dhe riprodhohen në një vend dhe kohë të caktuar. Bashkësia jetësore përbëhet nga shumë popullata të cilat jetojnë në një vend të veçantë. 37- Hulumton organizmat e gjetur në një habitat specifik (oborr shkollë, park qyteti, kënetë, lum, pyll, livadh etj..) dhe i klasifikon organizmat sipas sistemit të klasifikimit.	34-Ndikimi i gjallesave në cilësinë e mjedisit 35-Veprimtari (pranë lumit, pellgut të ndenjtur) 36-Nivelet e organizimit të gjallesave 37-Punë eksperimentale 38-Përshatshmëria e gjallesave 39-Përshatshmëria e gjallesave (vazhdim) 40- Gjallesat kanë nevojë për energji 41-Gjallesat dhe mjediset natyrore. Veçoritë e ekosistemit	1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë	Mësimdhënie dhe nxënie me nxënësin në qendër dhe gjithpërfshirjen Mësimdhënia dhe të nxëniet e integruar Mësimdhënia dhe të nxëniet të diferencuar Mësimdhënie dhe të nxëniet e bazuar në arritjen e kompetencave Çështje/tema ndërkurrikulare Forma pune: Kllaster, Ndërthurja, Organizues grafik, Teknika e pyetjeve, Mendo puno në grup, punë praktike, Gushkuqi rrethorë, Shqyrtimi kategorizues, Ditari dypjesësh, Pesëvargëshi, Shqyrtimi i përbashkët, Copëza të përziera, Inserti, Loja me role, Kubimi, Vrojto/puno/thuaja grupit	Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësimi diskutimeve, prezantime. Vlerësimi me shkrim (ese, raportet e punës) Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale Vlerësimi për ecurën dhe produktin e punës me projekte Vlerësimi individual dhe grupor, gjatë punës kërkimore Vlerësimi i detyrave të shtrëpisë Vlerësim për të nxënë	Fizikë, Kimi, Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Gjeografi, Artet, Matematikë Çështje ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Edukim për media	Teksti i nxënësit, Interneti, Natyra

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	38- Përshkruan se si përshatjet shërbejnë për të mundësuar mbijetesën dhe ato mund të jenë strukturale dhe të bazuara në sjellje, sigurimi i ushqimit, strehimi, ikja nga grabitqari, riprodhimi duke gjetur ose tërhequr partnerin ose shpërndarë farat/frytë.	42-Funksionimi i ekosistemit. Klasifikimi i gjallesave sipas vendit që zënë në zinxhirin ushqimor	1 orë				
	39- Përdor falor të duhur shkencor dhe teknologjik gjatë komunikimit gojor ose me shkrim duke përfshirë: klasifikimi, biodiversiteti, bashkësia jetësore natyrore (biocenoza), marrëdhëniet e ndërsjella, vertebrorët-kurrizorët, invertebrorët-paruazorët, stabiliteti, karakteristikat, organizmi etj.	43-Zinxhirët ushqimorë. Rrjetat ushqimore	1 orë 1 orë				
	40,41- Përshkruan shndërrimin e energjisë së dritës në energji kimike gjatë krijimit të lëndëve ushqyese në shembullin e fotosintezës duke mos u shërbyer me simbole kimike në pasqyrimin e ekuacionit të fotosintezës	44-Rrjedha e energjisë në ekosistem 45-Punë praktike (Dheu, ekosistemi natyrorë me shumëllojshmëri gjallesash) 46-Aktivitet (lidhur me punën praktike) 47, 48-Projekt (zinxhirët, piramidat ushqimore) 49-Test 50-Marrëdhëniet midis gjallesave	1 orë 2 orë 1 orë 1 orë				
		51-Format të tjera të marrëdhënieve midis gjallesave. Simbioza 52-Ushtrime	1 orë 1 orë 1 orë				

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	42- Shfrytëzojnë organizues grafik për të treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme. 43- Përkruan shndërrimin e energjisë gjatë zërthimit të lëndëve ushqyese në shembullin e zinxhirit të ushqimit duke shpjeguar nocionet prodhuesit dhe konsumuesit. 44- Gjurmon rrugën e energjisë prej Diellit nëpër qeniet e gjalla dhe identifikon rolet e organizmave të ndryshëm (prodhuesve, konsumuesve, grabitqarëve, presë) në zinxhirin e ushqimit dhe në rrjetën e ushqimit 50- Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim).	53-Biomat natyrore dhe ekosistemet e kultivuara 54- Llojet e bimëve dhe kafshëve të rrezikuara në vendin tonë 55- Shkaqet e zhdukjes së gjallesave dhe mbrojtja e llojeve të rrezikuara	1 orë 1 orë				

Temat mësimore	Rezultatet e të nxëniet për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	50- Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet specieve të ndryshme duke mos përdorur emërtime shkencore për këto marrëdhënie vetëm duke pasur parasysh dobinë ose dëmin nga bashkëjetesa e tyre dhe shpjegojnë se si këto marrëdhënie mbështesin qëndrueshmërinë e biodiversitetit. 51- Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim). 52- Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet specieve të ndryshme duke mos përdorur emërtime shkencore për këto marrëdhënie vetëm						

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	duke pasur parasysh dobinë ose dëmin nga bashkëjetesa e tyre dhe shpjegojnë se si këto marrëdhënie mbështesin qëndrueshmërinë e biodiversitetit. 53- Tregon të kuptuarit se habitatet e ndryshme mbështesin bashkësitë e ndryshme jetësore (kopshti, livadhi, pema, kënetat, përroi etj.). 54,55- Diskuton arsyet e zvogëlimit dhe zhdukjes së disa bimëve ose shtrazëve (p.sh. për shkak të gjuetisë së tepruar, sëmundjeve, llojeve invazive, ndryshimeve dhe shkatërrimeve të habitatit).						

PLANI TREMUJOR: PRILL-MAJ-QERSHOR

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Lënda mësimore: Biologji

Klasa: VI

Tema mësimore: Tema 1: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor Tema 2: Shëndeti sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Tema 1 - Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

I. Komunikues efektiv

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

I.3 Veçon porositë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II. Mendimtar kreativ dhe kritik

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

II.7 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

III. Nxënës i suksesshëm

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

III.7 I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

IV. Kontribues produktiv

IV.3 Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.

Tema 2 –Shëndeti sjelljet dhe emocionet e njeriut

I. Komunikues efektiv

I.2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

I.4 Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

I.6 Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II. Mendimtar kreativ dhe kritik

II.6 Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III. Nxënës i suksesshëm

III.3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III.5 Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

III.8 Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

V. Individ i shëndoshë

V.7 Kërkon ndihmë/këshillë pa hezitim nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje a mbështetje në situata të supozuara si potencialisht të rrezikshme në të cilat cenohet shëndeti fizik dhe mendor.

V.9 Përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës.

VI. Qytetar i përgjegjshëm

VI.4 Shfaq mirëkuptim për personat të cilëve u është shkelur ndonjë e drejtë, duke ilustruar me shembuj nga jeta e përditshme nga mediat, të dhënat historike, personazhet nga romanet që ka lexuar apo nga filmat që ka parë në mënyrë që të mos përsëriten më.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor	56- Tregon të kuptuarit se habitatet e ndryshme mbështesin bashkësitë e ndryshme jetësore (kopshiti, livadhi, pema, kënetat, përroi etj.).	56- Punë praktike. Të zbulojmë lidhjet ushqimore në pyllin, lulishten ose kopshtin pranë zonës sonë të banimit.	1 orë	Mësimdhënie dhe nxënie me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen	Vlerësim i vazhdueshëm	Gjeografi	Teksti i nxënësit,
	57- Vlerëson përfitimet që ka shoqëria njerëzore nga biodiversiteti si dhe problemet që shkaktohen nga zvogëlimi i biodiversitetit.	57- Të mësuarit përmes projekteve	1 orë	Mësimdhënie dhe të nxëniti e bazuar në arritjen e kompetencave	Vlerësimi me shkrim (ese, raportet e punës)	Kimi TIK-un Gjuhë shqipe	Interneti,
	58- Ndorja	58- Ndorja	1 orë	Çështje/tema ndërkurrikulare	Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale	Histori Edukata qytetare	
	59- Aktivitet (ndorja)	59- Aktivitet (ndorja)	1 orë				
	60- Njerëzit dhe zinxhirët ushqimorë	60- Njerëzit dhe zinxhirët ushqimorë	1 orë	Format e punës Rrjeti i diskutimit, Teknika e pyetjeve, Tabela e koncepteve, Stuhi mendimesh, Insert, Diagrami i Venit, Dua të di mësova, Shqyrtimi kategorizues, Xhigsa, Minitesti, Shkrimi i lirë	Vlerësimi për ecutën dhe produktin e punës me projekte Vlerësimi individual dhe grupor, gjatë punës kërkimore	Çështje ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Edukim për media	
Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut	61- Aktivitet (hulumtim në internet për njerëzit dhe zinxhirët ushqimorë)	61- Aktivitet (hulumtim në internet për njerëzit dhe zinxhirët ushqimorë)	1 orë				
	62- Ruajtja e mjedisit	62- Ruajtja e mjedisit	2 orë		Vlerësimi i detyrave të shtëpisë		

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	60- Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij.	63-Pyetje dhe ushtrime përmbledhëse 64-Aktivitet (ruajtja e mjedisit)	1 orë 1 orë 1 orë		Vlerësimi përmbledhës ViN VpN		
	62-Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij.	65, 66-Projekt (ndotja e ambientit)	1 orë 1 orë				
	61- Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Ndikimi pozitiv: p.sh., ruajtja-konservim i biodiversitetit, pyllëzimi; ndikimi negativ: p.sh., zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale.	67-Puberteti. Ndryshimet në organizëm 68-Aktivitet (Puberteti) 69-Test 70-Higjiena personale 71- Aktivitet (Higjiena personale)	2 orë 1 orë				

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	67- Shpjegon ndryshimet biologjike të pubertetit. Analizon dhe diskuton zhvillimin seksual gjate cikleve të ndryshme të jetës. 70,71- Vlerëson rëndësinë e higjienës personale për shëndetin e tyre. 72- Shpjegon procesin e rritjes dhe zhvillimit, proceseve riprodhuese njëjësore dhe problem abuzimit seksual. 73- Identifikon institucionet ku mund të kërkojë ndihmë adekuatë	72,73-Abuzimi seksual dhe institucionet ku mund të kërkohet ndihmë 74-Aktivitet (të dhëna nga interneti për abuzime, mbrojtje, ndihmë)					

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon konceptin, Biologjia – shkencë natyrore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2; I. 3; I. 6; III. 3.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen, si dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërisë e ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
Njësia mësimore: Objekti i studimit të biologjisë. Metoda shkencore e studimit të saj.			
Fjalët kyçe: Shkencat natyrore, metoda shkencore e studimit në biologji (vëzhgimi, pyetjet, eksperimenti, hipoteza, teoria dhe ligji)			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore			
Nxënësi/ja:			
- përcakton biologjinë si shkencë natyrore; - dallon metodat shkencore të studimit të biologjisë duke e ruajtur rrjedhën logjike në detyrën e dhënë; - zbaton metodat shkencore të studimit të biologjisë për hulumtim shkencor. -			
Kriteret e suksesit:			
Rendit biologjinë si shkencë natyrore. Përcakto llojin e metodës në detyrën e dhënë. Gjej emrin e metodës në fishat e dhëna.			
Burimet: Teksti i nxënësit			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketat, fishat, teksti i përgatitur, fotografite.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Matematikë			
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1			
Mësuesi/ja në fillim të orës ndan tabelën në dy shtylla, ku shënon <i>Shkencat e natyrës</i> dhe <i>Shkencat ekzakto</i> . Paraprakisht ka përgatitur etiketat ku shënohen lëndët mësimore: Biologji, Kimi, Fizikë dhe Matematikë. Kërkohet nga nxënësit që të vendosin stilolapsat para vetes mbi bankat e tyre			

dhe mësuesi/ja bën zgjedhjen e 4 stilolapsave. Nxënësve që u takojnë stilolapsat bëjnë tërheqjen e etiketës me emërtimin lëndor dhe vendosen në njëërën shtyllë.

Mësuesi/ja hap diskutimin mbi vendosjen e etiketave në shtyllat përkatëse.

Në fund, bën përmbledhjen duke sqaruar saktësisht përkatësinë e biologjisë si lëndë e shkencave natyrore.

Hapi 2

Frohen nxënësit të plotësojnë hartën e mendimeve të paraqitur në tabelë, duke shënuar metodat shkencore për studimin e biologjisë që njohin.



Mësuesi/ja në fund sqaron radhitjen e këtyre metodave shkencore të studimit të biologjisë duke e ruajtur rrjedhjen logjike të saj: vëzhgimi - marrja e informacioneve; pyetja - identifikojnë problemin; hipoteza - mundësi apo një mendim për të shpjeguar pse ndodh ky ose ai proces; eksperiment - krijon bindje mbi vërtetësinë e hipotezës; teoria - shpjegimi mbi përfundimet e arritura; dhe ligji - përmbledhje e shkurtër dhe e saktë e informacionit të grumbulluar.

Hapi 3

Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe të emërtuara me numra nga 1-6 dhe çdo grupi i shpërndan tekstin:

Biologët kanë studiuar dy lloje të specieve: gaforren (*regna saltatore*), që në këtë rast paraqitet si gjahtari kundrejt gjahut, si dhe llojin e mizës me flatra të vijëzuara (*rhagoletis zephyria*) duke pasur parasysh se kur egërsohet ky lloj i mizës i ngjason gaforres së lartpërmendur dhe i kundërpërgjigjen.

Paraqesim para nxënësve detyrën me shkrim: në dy enë qelqi të mbyllur kemi gaforre dhe miza. Ena 1 ka një gaforre dhe dy miza me flatra të vijëzuara (*ragoletis zephyri*). Ena 2 ka një gaforre dhe dy miza të shtëpisë.

Po të kemi mundësinë e vëzhgimit do të shohim se mizës (*rhagoletis zephyria*) mbi flatra i pasqyrohen njolla e vijëzime që imitojnë këmbët e gaforres. Duke u bazuar në këto të dhëna, cili grup ka mundësinë më të madhe (probabilitetin) për të mbijetuar?

Grupeve iu caktojmë 2 detyra të ndryshme.

Grupet teke (1, 3, 5): Nxirrni një hipotezë mbi probabilitetin e grupit mbijetues në detyrën e dhënë dhe arsyetoni hipotezën.

Grupet çifte (2, 4, 6): Nxirrni një teori mbi probabilitetin e grupit mbijetues në detyrën e dhënë dhe argumentoni teorinë.

Çdo grup paraqet para klasës zgjidhjen e detyrës së kërkuar. Nxënësit vlerësojnë komentet e bëra. Në fund, mësuesi/ja përmbledh dhe hedh hipotezën dhe teorinë e duhur.

Hapi 4

Mësuesi/ja iu shpërndan pakon e përgatitur të fishave me metodat e studimit në biologji nxënësve në grupet ekzistuese.

Në fisha janë dhënë situatat e ndryshme ku ata duhet të specifikojnë metodat shkencore të studimit në biologji duke i radhitur ato sipas një vije logjike. Fishat përzihen kur të dorëzohen në grupe. Fishat janë:

1- Në prani të mizave, gaforret kundërpërgjigjen me lëvizje dhe anasjelltas. (vëzhgim) 2- Çfarë funksioni ka lëvizja e flatrave? (pyetja)

3- Lëvizja e flatrave dhe vijëzimet mbi to rritin probabilitetin e mbijetesës së mizave. (hipoteza) 4- Nxirr numrin përfundimtar të mizave me flatra të vijëzuara dhe ato të shtëpisë në praktikë. (eksperimenti) 5- Numri i mizave me flatra të vijëzuar është i njëjtë, kurse i atyre të shtëpisë është 0. (teoria)

6- Modifikimi i mizës probabiliteti i mbijetesës. (ligji)

Çdo përfaqësues i grupit komenton një radhitje të caktuar të fishës, duke zbatuar radhitjen logjike të metodave shkencore të studimit në biologji.

Nxënësit vlerësojnë komentet e shokëve, kurse mësuesi/ja bën përmbledhjen duke sqaruar saktësisht radhitjen e fishave.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë diskutimit dhe komentimin të metodave shkencore në biologji. Mësuesi/ja vlerëson qëndrimet dhe radhitjen logjike të metodave shkencore në biologji duke mbajtur shënime.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Vëzhgo një insekt në natyrë dhe nxirr një hipotezë lidhur me ndonjë karakteristikë të tij.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Fusha kurrikulare:**

Shkencat e natyrës

Lënda:

Biologji

Shkalla e kurrikulës:

III

Klasa:

VI

Tema: Biodiversiteti**Rezultati i të nxënit të temës:** Identifikon rregullat themelore të emërimit, klasifikimit dhe kategoritë taksonomike të qenieve të gjalla.**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 2; I. 4; III. 1; III. 3; III. 5**Rezultatet e fushës së kurrikulës:**

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla në varësi të kushteve të mjedisit, qëndrueshmërisë të ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturave dhe proceseve të përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Njësia mësimore: Veçoritë e gjallesave**Fjalët kyçe:** Gjallesë, jogjallesë**Rezultatet e të nxënit për orën mësimore**

Nxënësi/ja:

- emërton pjesët e mikroskopit duke treguar vendndodhjen e tyre;
- tregon përdorimin e mikroskopit dhe funksionin e tij gjatë vërtimit;
- nxjerr rregullat për punën në laborator apo klasë gjatë punës eksperimentale.

Kriteret e suksesit:

Gjej 6 pjesët e mikroskopit duke treguar funksionin e tij/saj. Shpjego funksionin e mikroskopit gjatë vërtimit. Vendosi së paku 5-6 rregulla për punën në laborator apo në klasë gjatë punës eksperimentale.

Burimet: Teksti i nxënësit**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:****Lidhja me lëndët e tjera mësimore:** Gjuhë shqipe, Kimi**Çështjet ndërkurrikulare:** Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

Përzgjidhen në mënyrë rastësore tre nxënës, të cilët kryejnë detyrën e pavarur. Kërkohet nëse ndonjëri prej tyre ka shtuar si hipotezë “A është insekti në fjalë gjallesë e gjallë?”.

Hapi 1

Mësuesi/ja fton nxënësit që të rikujtojnë njohuritë ekzistuese nëpërmjet drejtimit të pyetjeve dhe diskutimit të tyre.

Pyetja: Vrojtë përreth ambientin ku gjendeni dhe veço gjallesat (qeniet e gjalla) dhe jogjallesat. Cila veti dalluese i dallon ato? Arsyeto!

Mësuesi/ja nga informacionet e mara bën përmbledhjen e tyre dhe veçon: *gjallesat kanë të përbashkët atë që quajmë “jetë”.*

Hapi 2

Mësuesi/ja paraqet fotografitë ku nxënësit/et veçojnë shtatë veçoritë e përbashkëta të gjallesave. Detyra jepet të punohet në grupe (1-6) dhe përzgjedhja e grupeve prezantuese do të bëhet me anë të hedhjes së zarit. Nxënësit/et prezantojnë punën në grup. Pas prezantimeve, mësuesi/ja liston në tabelë veçoritë e dala nga puna e grupeve. Mësuesi/ja në fund shënon shtatë veçoritë e përbashkëta sipas vijës logjike duke i plotësuar ato.

- 1- Gjallesat janë të organizuara (qelizë, inde, organe apo sisteme).
- 2- Gjallesat dallohen nga jogjallesat (mbajnë konstante strukturën dhe funksionin edhe pse kushtet në mjedis ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme. Jogjallesa ndryshon formën, vëllimin, masën.). 3- Gjallesat rriten e zhvillohen (embrioni bimorë i vogël rritet derisa bëhet bimë, bebja rritet gjersa bëhet një njëri i rritur, kurse jogjallesat nuk mundën të rriten shtojnë vëllim masën etyre).
- 4- Gjallesat shkëmbejnë energji me mjedisin (njerëzit ushqehen, marrin energji nga mjedisi dhe e kthejnë atë energji duke punuar).
- 5- Gjallesat iu përgjigjen ngacmimeve të mjedisit (kur prekim një sipërfaqe të ngrohtë, bëjmë tërheqjen e dorës).
- 6- Gjallesat i përshtaten ambientit në të cilin jetojnë (kameleoni ndryshon ngjyrën sipas ambientit).
- 7- Gjallesat në dallim nga jogjallesat kanë aftësi të riprodhohen (krijohen pasardhësit).

Hapi 3

Mësuesi/ja në fund kërkon nga nxënësit që të shënojnë një esë me temën: Gjallesat dhe jogjallesat janë të lidhura dhe bashkëpunojnë me njëra-tjetrën.

Kriteret e eses: Eseja të ketë së paku 15 rreshta; së paku dy bashkëpunime mes të gjallesave dhe jogjallesave; të shënohen së paku 5-6 veçori të gjallesave; koha për këtë aktivitet do të jetë 10 minuta.

Në fund, nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin me anë të teknikës dy yje dhe një dëshirë (dy veti të mira dhe një këshillë).

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë diskutimeve dhe saktësinë e materialit të prezantimit, shkrimit të esesë.

Mësuesi/ja vlerëson pjesëmarrjen në diskutim, bashkëpunimin në grupe, saktësinë nga ana shkencore, plotësimin e kriterëve të esesë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë diskutimeve, saktësisë të materialit të prezantimit, shkrimit të esesë.

Mësuesi/ja vlerëson pjesëmarrjen në diskutim, bashkëpunimin në grupe, saktësinë nga ana shkencore, plotësimin e kriterëve të esesë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Dalloni gjallesat nga jogjallesat që vëzhgoni nga dritarja e shtëpisë dhe plotësoni tabelën.

Lëviz (si?)	Gjallesa (emri)	Jogjallesë (emri)
Ushqehen (lloji i ushqimit)		
Rritjet (sa ka mundësi të rritet)		
Reagon ndaj mjedisit (si?)		

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti	Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan organizimin shkallë-shkallë të sistemeve biologjike-ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve, organizmi (individi), popullata, bashkësia jetësore, ekosistemi dhe biosfera.		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 6; III. 3; II. 6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërisë e ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
Njësia mësimore: Qeliza, njësia më e vogël e ndërtimit të gjallesave. Qeliza bimë dhe ajo shtazore			
Fjalët kyçe: Qeliza prokariote, qeliza eukariote			

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- përpilon fjalinë që qeliza është karakteristikë dalluese e gjallesave;
- dallon duke krahasuar qelizat prokariote dhe eukariote me anë të fotografisë;
- modelon qelizat prokariote dhe eukariote duke specifikuar vetitë dalluese.

Kriteret e suksesit:

Përkufizo qelizën si karakteristikë dalluese të gjallesave me anë të fjalisë. Krahaso qelizën prokariote dhe eukariote duke specifikuar strukturat e tyre. Projekto strukturat e qelizave prokariote dhe eukariote.

Burimet: Teksti i nxënësit**Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fotografitë, plastelina me ngjyrë

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Arte

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**Hapi 1**

Mësuesi/ja shkruan disa terma në tabelë:

Qeliza, gjallesat karakteristike, dallon, që, nga, jogjallesat, tjetër, është; dhe kërkon nga nxënësit të punojnë në dyshe për të gjetur lidhjen mes këtyre fjalëve. Ata ndërtojnë fjalinë e saktë nga ana shkencore. Vendosen lapsat në bankë dhe mësuesi/ja zgjedhin disa dyshe me anë të lapsave. Nxënësit lexojnë fjalinë dhe diskutohen.

Hapi 2

Mësuesi/ja shfaq para nxënësve një fotografi ku shohin një qelizë bakteriale dhe një qelizë bimore. Ai/ajo kërkon nga nxënësit/et të vëzhgojnë me kujdes e më pas t'i përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë po vëreni në figurat e prezantuara?
- Trego pjesët e përbashkëta të fotografisë 1 dhe 2.
- Specifikoj vetitë dalluese të bërthamave të figurave të prezantuara 1-2.

Hapi 3

Nxënësit/et ndahen në grupe dhe iu shpërndahen fotografitë e qelizave me forma dhe madhësi të ndryshme. Kërkohet prej tyre që në grupe të përshkruajnë formën dhe madhësinë e saj. Mësuesi/ja me anë të hedhjes së zarit bën përzgjedhjen e grupit prezantues. Përfaqësuesi/ja i çdo grupi prezanton punën e grupit. Nxënësit/et e tjerë parashtrojnë pyetje, të cilave do t'u përgjigjen edhe anëtarët e tjerë të grupit.

Hapi 4

Nxënësve të ndarë në grupe iu ndahen plastelina me ngjyra. Ata duhet të ndërtojnë qelizën prokariote ose qelizën eukariote. Duhet pasur gjithnjë kujdes në ndryshimet e strukturës qelizore të kërkuar nga mësuesi/ja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë përgjigjet, komentet, prezantimin dhe veprimtarinë.

Mësuesi/ja vlerëson dallimin e gjallesave me jogjallesat me anë të termave paraprakë, vlerëson përgjigjet, komentet, bashkëpunimin në grupe dhe punën individuale gjatë veprimtarive praktike.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Specifikoj disa qeliza me funksione të ndryshme duke përshkruar madhësinë e tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II. 3; II. 6; III. 3; III. 8.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërisë e ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
Njësia mësimore: Punë eksperimentale			
Fjalët kyçe: Vrojtim, qelizë bimore, qelizë shtazore			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon hapat e realizimit të një hulumtimi shkencor; - zbaton hapat e një hulumtimi shkencor në mënyrë praktike; - raporton rezultatin e arritur gjatë një hulumtimi shkencor. Kriteret e suksesit: Veço hapat e një hulumtimit shkencor. Praktiko hapat gjatë një hulumtimit shkencor. Prezanto rezultatet e një hulumtimi shkencor.			
Burimet: Teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: mikroskop optik, qelqi special, qelqi mbulues, ujë, spatul druri, pikatore, tinkturë jodi.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Fizikë Çështjet ndërkurrikulare: Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja sjell dhe i vendos të gjitha mjetet e nevojshme për kryerjen e eksperimenteve në tavolinën e vet. Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në dy grupe dhe u shpërndan detyrën e shënuar në etiketë.			

Grupi 1 ka për detyrë të punojnë një preparat të qelizës shtazore. Nxënësit/et e këtij grupi do të ndahen në katër nëngrupe:

Nëngrupi i parë ka për detyrë të lexojë eksperimentin dhe të sjellë mjetet e nevojshme për kryerjen e eksperimentit.

Nëngrupi i dytë lexon mënyrën e realizimit të eksperimentit.

Nëngrupi i tretë punon preparatin (lamën).

Nëngrupi i katërt shënon rezultatet përfundimtare që nxjerrin pas vrojtimit të çdo nxënësi dhe diskutimit në grup.

Grupi 2 ka për detyrë të punojnë një preparat të qelizës bimore. Nxënësit/et e këtij grupi do të ndahen në katër nëngrupe:

Nëngrupi i parë ka për detyrë të lexojë eksperimentin dhe të sjellë mjetet e nevojshme për kryerjen e eksperimentit.

Nëngrupi i dytë lexon mënyrën e realizimit të eksperimentit.

Nëngrupi i tretë punon preparatin (lamën).

Nëngrupi i katërt shënon rezultatet përfundimtare që nxjerrin pas vrojtimit të çdo nxënësi/e dhe diskutimit në grup.

Hapi 2

Zgjidhet në grup nxënësi/ja raportues, i cili raporton rezultatin përfundimtar të grupit gjatë punës praktike, si dhe vështirësitë që ata hasën gjatë punës praktike.

Hapi 3

Mësuesi/ja shtron pyetjen: Cilët janë hapat për krijimin e preparatit? Pas prezantimit të nxënësve nxirren përfundimet.

1- Vendoset mukoza ose copa e membranës së qepës në qelqin special. 2-

Hidhet një pikë ujë dhe një pikë tinkturë jodi.

3- Vendoset qelqi mbulues (lamela) mbi mukozën apo cipën e qepës butësisht dhe me kujdes, që mos të mbeten fluskat e ajrit.

4- Preparati i përgatitur vrojtohet me mikroskop dhe vizatohen qelizat.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë bashkëpunimin e shokëve/shoqeve në grupe dhe komentet e rezultateve të fituara.

Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin e nxënësve në grupe, angazhimin e tyre, punimin e saktë të preparatit sipas udhëzimeve të detyrës, raportimin e detyrës (eksperimentit) të përfunduar, si dhe bashkëpunimin e tyre në nxjerrjen e përfundimeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Njohuritë e fituara i përmbledhim me anë të një poemthi prej pesë vargjesh.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan organizmin shkallë-shkallë të sistemeve biologjike-ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve, organizmin (individi), popullata, bashkësia jetësore ekosistemi dhe biosfera.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2; II. 6; III. 3; III. 7.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërisë e ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
Njësia mësimore: Nga qeliza tek organizmi. Nivelet e organizimit të qelizave			
Fjalët kyçe: Organizëm njëqelizor, shumëqelizorë, qeliza, indet, organet, sistemet, organizmi.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - krahason organizmat njëqelizorë dhe shumëqelizorë; - shqyrton ndërlidhjen e qelizave, indeve organeve, sistemeve në organizmat shumëqelizorë; - konstaton nivelet e organizimit të qelizave në organizmat shumëqelizorë. -			
Kriteret e suksesit: Dallo vetitë e veçanta dhe dalluese mes organizmave njëqelizorë dhe shumëqelizorë. Analizo ndërtimin e indeve, organeve, sistemeve të organeve dhe organizmave. Argumento me anë të lidhjeve e qelizave, indeve, organeve e sistemeve në krijimin e organizmave shumëqelizorë.			
Burimet: Teksti i nxënësve			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Matematikë			
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Nxënësit/et punojnë në dyshe dhe krahasojnë organizmat njëqelizorë dhe ata shumëqelizorë. Ata/ato tregojnë vetitë e veçanta dhe të përbashkëta të tyre. Nxënësit/et komentojnë krahasimet.

Hapi 2

Mësuesi/ja së bashku me nxënësit/et shqyrtojnë ndërtimin e gjallesave shumëqelizore:

A janë të gjitha qelizat në organizmat shumëqelizorë të njëjta? Çfarë ndryshon tek ato? Si mund ta paraqesim me anë të një barazimi formimin e indit, organit, sistemit dhe organizmit?

Nxënësit shqyrtojnë dhe komentojnë duke dalë në përfundime se:

Qelizat janë të specializuara, kanë formë e madhësi të ndryshme dhe lidhen me funksionin që kryejnë kurse qelizat me formë, madhësi dhe funksion të njëjtë krijojnë indin.

(madhësi, formë, funksion i njëjtë) $\Rightarrow$ Qeliza + Qeliza = Ind

(indet e ndryshme) $\Rightarrow$ Ind + Ind = Organ

(punojnë së bashku) $\Rightarrow$ Organ + Organ = Sistem

(të ndryshme, punojnë së bashku) $\Rightarrow$ Sistem + Sistem = Organizëm

Hapi 3

Kërkohet nga nxënësit/et që të punojnë në dyshe dhe të shënojnë shembuj të indeve, organeve e sistemeve të trupit tonë.

Shënimet e shkruara lexohen dhe komentojnë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë komentet, diskutimet dhe shënimet e mbajtura.

Mësuesi/ja vlerëson vetitë krahasuese të prezantuara nga nxënësit, paraqitjen e barazimeve të kërkuara, shënimin e prezantuar, bashkëpunimin në dyshe dhe në grup.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Vizato qelizat me forma të ndryshme dhe emërto sistemin që i përket.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësorë		Rezultati i të nxënit të temës: Bënë dallimin mes termave organizëm, popullatë dhe bashkësi jetësore. Organizmi është qenie e gjallë. Popullata definohej si grup i bimëve ose shtazëve të llojit të njëjtë që jetojnë dhe riprodhohen në një vend dhe kohë të caktuar. Bashkësia jetësore përbëhet nga shumë popullata të cilat jetojnë në një vend të veçantë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: III. 1; I. 6; II. 7; III. 7.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërisë e ekosistemeve, ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
Njësia mësimore: Nivelet e organizimit të jetës			
Fjalët kyçe: Habitat, popullatë, bashkësia biologjike, biotop, biocenoza dhe ekosistem			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - hulumton për të treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme me anë të një veprimtarie studimore; - interpreton nivelet e organizimit të gjallesave në biocenoza të ndryshme; - kategorizon habitatet në bazë të kushteve që ai i siguron me anë të fotografisë.			
Kriteret e suksesit: Trego disa mundësi që u ofron mjedisi gjallesave duke specifikuar disa karakteristika dhe përshtatshmëri. Krahaso nivelet e organizimit të gjallesave në biocenoza të ndryshme duke i paraqitur ato me anë të shembujve. Veço habitatet në bazë të kushteve të paraqitura.			
Burimet: Teksti i nxënësit, interneti Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: posteri, fotot			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuha Shqipe, Gjeografi, Kimi, Arte Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, edukim për media			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1 Çdo grup ka realizuar paraprakisht një veprimtari studimore lidhur me mbledhjen e informacioneve rreth biotopit përkatës.

Grupi 1 - pylli; grupi 2 - oqeani; grupi 3 - shkretëtira dhe grupi 4 - poli i veriut.

Çdo grup, me anë të posterit, tregon mundësitë që ofron ai mjedis për jetën e të gjitha gjallesave që jetojnë aty (karakteristikat dhe përshtatshmërinë e tyre).

Parashtrijmë pyetjen: Si mendoni, a ka raste që e njëjta gjallesë të përshtatet në habitate të ndryshme?

Hapi 2

Çdo grupi ekzistues (4 grupeve), mësuesi/ja iu cakton nga një nivel organizimi. Materiali mësimor lexohet nga nxënësit e të gjitha grupeve. Më pas, çdo grup përpilon nga tri pyetje për nivelin e caktuar të organizimit të gjallesave. Njëri grupi i parashtron pyetjet grupit tjetër, ku anëtarët e këtij grupi përgjigjen (p.sh. gr. 1-> gr. 2; gr. 2-> gr. 1; gr. 3 -> gr. 4; gr. 4 -> gr. 3).

Mësuesi/ja në fund përmbledh informatat lidhur me nivelet e organizimit të gjallesave.

Hapi 3

Nxënësi/ja, individualisht, kryen një veprimtari. Përshkruan habitatet e gjallesave të paraqitura në foto, kushtet që secili habitat ia siguron gjallesës përkatëse, si dhe tregon se cilat nga gjallesat e dhëna jetojnë në më shumë se një habitat.

Dy-tre/i nxënës/e paraqesin punën para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin sipas informacioneve për biotopin, pyetjeve, përshkrimit të kushteve. Mësuesi/ja vlerëson mbledhjen e informatave të paraqitura për biotopin, prezantimin e përshtatshmërisë dhe karakteristikat e gjallesave që jetojnë në habitate të ndryshme.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shpjego me shkrim: A mund të jetoni ju në një habitat, i cili nuk është për ju p.sh., në një shkretëtirë apo në Polin e Veriut? Pse? Argumentoni përgjigjen.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2; I. 6; II. 6; III. 3; III. 5.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan organizmin shkallë-shkallë të sistemeve biologjike-ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve, organizmin (individi), popullata, bashkësia jetësore ekosistemi dhe biosfera.			
Njësia mësimore: Bota e gjallesave			
Fjalët kyçe: protistët			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - përgatit preparatet me mjetet përkatëse; - nxjerr rezultatet përfundimtare në bazë të vrojtimit të preparateve; - paraqet tabelën e krahasimit të mikroorganizmave sipas disa tipareve. Kriteret e suksesit: Puno preparatet me mjetet e disponueshme. Shpjego përfundimet e ndalura nga krahasimi i preparatit 1-2. Plotëso tabelën e krahasimit të monerëve dhe protozoarëve me anë të tri tipareve.			
Burimet: Libri i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: mikroskopi, qelqi special, qelqi mbulues, kopshtorja, pikatorja, fletorja e punës eksperimentale (shënimeve).			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Kimi Çështjet ndërkurrikulare: Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Mësuesi/ja përgatit përzierjen (përzien 50 ml xhelatinë dhe e vlon për 5 minuta, pasi xhelatina të ftohet, lini shenjat e gishtërinjve të cilën e lë të qëndrojë 3-4 ditë).

Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në grupe dhe në çdo grup vendos, nga një kopshtore të pastër preparati ku ata/ato duhet të hedhin një pikë nga kjo përzierje dhe ta tretin me 2 ml ujë. Secili/a prej tyre merr 1 pikë nga kjo përzierje, e pikon mbi qelqin special dhe e mbulon me qelqin mbulues.

Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të vrojtojnë preparatin (nëse në shkolla kemi vetëm një mikroskop, nxënësit/et ftohen një nga një që të vrojtojnë preparatin).

Nxënësit/et vizatojnë format e baktereve dhe shënojnë përfundimet e vërtetimit nga ky aktivitet në fletoret e tyre.

Hapi 2

Nxënësit/et punojnë preparatin e dytë (mësuesi/ja iu sjell në një gotë, ujë pellgu të ndenjur).

Nxënësit/et pikojnë një pikë nga ky ujë në xhamin special, më pas vendoset xhami mbulues.

Preparati i përgatitur vërtetohet nga nxënësit/et dhe vizatojnë format e tyre (algat e gjelbra dhe protozoarët) si dhe nxjerrin përfundimet e vërtetimit.

Hapi 3

Parashtrohen këto pyetje:

1- Pse këto gjallesa nuk shihen me sy të lirë? Si mendoni se quhen ato? 2-

Nëse krahasojmë preparatin 1-2, çfarë përfundimi mund të nxjerrim?

Hapi 4

Mësuesi/ja në bazë të përgjigjeve dhe rezultateve të dhëna nga nxënësit/et shpjegon ndarjen e gjallesave mikroskopike në grupin e monerëve dhe protistëve, si dhe prek 5 mbretëritë e gjallesave.

Hapi 5

Nxënësit plotësojnë tabelën e dhënë:

Mikroorganizmat:	Forma	Ndërtimi	Lëvizja
Monerët (bakteret)			
Protozoarët (protistët)			

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë bashkëpunimin e tyre gjatë aktivitetit praktik, si dhe komentet dhe rezultatet e prezantuara.

Mësuesi/ja vlerëson saktësinë dhe përshtatshmërinë e përfundimeve që kanë arritur si përgjigje ndaj pyetjeve të ngritura në fillim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Çfarë tregon ngjashmëria e strukturës qelizore të disa protozoarëve (protistëve)?

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VI	
Tema: Biodiversiteti	Rezultati i të nxënësve të temës: Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës: I.2; I.6; II.6; III.3; III.5	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan organizmin shkallë-shkallë të sistemeve biologjike-ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve, organizmin(individi), popullata, bashkësia jetësore ekosistemi dhe biosfera	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 1.7 Protistët	
Fjalët kyçe: Monerët, Protozoarët (protistët)	
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore: 1.Përgatit preparatet me mjetet përkatëse. 2.Nxjerr rezultatet përfundimtare në bazë të vërtetimit të preparateve. 3.Paraqit tabelën e krahasimit të mikroorganizmave sipas disa tipareve. Kriteret e suksesit: 1.Puno preparatet me mjetet e disponueshme. 2.Shpjego përfundimet e dalluara nga krahasimi i preparatit 1-2. 3.Plotëso tabelën e krahasimit të monerëve dhe protozoarëve me anë të tri tipareve.	
Burimet: Libri i nxënësit/es	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Mikroskopi, qelqi special, qelqi mbulues, kopshtorja, pikatorja, fletorja e punës eksperimentale (shënimeve)	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Kimia	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Hapi 1. Arsimitari/ja ka përgatitur përzierjen, duke përzier 50 ml xhelatinë dhe e vlon për 5 minuta. Pasi xhelatina të ftohet, lini shenjat e gishtrinjëve të cilën e lë të qëndroj 3-4 ditë. Arsimitari/ja kërkon që nxënësit/et të ndahen në grupe dhe në çdo grup vendos nga një kopshtore të pastërt porcelani, ku ata duhet të hedhin një pikë nga kjo përzierje dhe ta tresin me 2 ml ujë dhe një mikroskopë. Merret 1 pikë nga kjo përzierje dhe e pikon mbi qelqin special dhe e mbulon me qelqin mbulues. Arsimitari/ja kërkon që nxënësit/es të vërtetojnë preparatin (nëse në shkollë kemi vetëm një mikroskopë. Nxënësit/et ftohen një nga një që të vërtetojnë preparatin). Nxënësit/et vizatojnë format e bakterieve dhe shënojnë përfundimet e vërtetimit nga ky aktivitet në fletoren e tyre.	

Hapi 2.

Nxënësit/et punojnë preparatin e dytë (arsimtari/ja u sjell në një gotë, ujë të pellgut të ndejtur).

Nxënësit/et pikojnë një pikë nga ky ujë në xhamin special dhe vendoset xhami mbulues.

Preparati i përgatitur vrojtohet nga nxënësit/et dhe vizatojnë format e tyre (algat e gjelbërta dhe protozorët), si dhe përfundimet e vrojtimit.

Hapi 3. Parashtrohen këto pyetjet

1-Pse këto gjallesa nuk shihen me sy të lirë? Ç'mendoni si quhen ato? Emërtoi ato duke i dalluar?

2-Nëse krahasojmë preparatin 1-2, çfarë përfundimi mund të nxjerrni?

Hapi 4-Arsimtari/ja, në bazë të përgjigjeve dhe rezultateve të dhëna nga nxënësit/et, shpjegon ndarjen e gjallesave mikroskopike në grupin e monerëve dhe protistëve, si dhe cek 5 mbretëritë e gjallesave.

Hapi 5-Nxënësit/et plotësojnë tabelën e dhënë:

Mikroorganizmat:	Forma	Ndërtimi	Lëvizja
Monerët (bakterjet)			
Protozoarët (protistët)			

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësi/ja vlerëson bashkëpunimin e tyre gjatë aktivitetit praktikë, si dhe komentet dhe rezultatet e prezantuar.

Arsimtari/ja vlerëson saktësinë dhe përshtatshmërinë e përfundimeve që kanë arritur si përgjigje ndaj pyetjeve të ngritura në fillim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ç'tregon ngjashmëria e strukturës qelizore të disa protozoarë (protistë)?

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon vetëdijesim që bakteret mund të kenë efekte të dobishme dhe të dëmshme për organizmin (bakteriet në traktin digjestiv mund të ndihmojnë tretjen ose të shkaktojnë sëmundjet). Identifikon produktet e jetës së përditshme, të cilat kanë origjinë nga diversiteti i organizmave (p.sh., mëndafshi nga krimbi i mëndafshit, suplementet ushqimor, shampot, pastat e dhëmbëve që përmbajnë polen të mbledhur nga bletët etj).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2; II. 3; II. 5; III. 3; III. 5; III. 8.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut,			
Njësia mësimore: Mikroorganizmat			
Fjalët kyçe: bakteret, toksinat, bakteret TBC, malaria			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - paraqet qëndrimet lidhur me pyetjen e shtruar; - formulon përgjigjet në fletëzat e ekspertëve; - zgjidhni ndonjë shembull të mikroorganizmave duke rreshtuar qëndrimet pozitive dhe negative. Kriteret e suksesit: Prezanto qëndrimet pro dhe kundër në pyetjen e shtruar. Argumento përgjigjet e dhëna. Gjej së paku dy-tri shembuj kur mikroorganizmat janë të dobishëm dhe të dëmshëm.			
Burimet: Teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletat e ekspertit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe Çështjet ndërkurrikulare: Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në grupe dhe brenda grupit formon dyshet, të cilat ndahen me qëndrimet “pro” dhe “kundër”, dhe shtron pyetjen: A mund të themi se shumica e mikroorganizmave janë të dobishme dhe përdoren në jetën e përditshme?

Dyshet diskutojnë dhe shënojnë përfundimet e tyre në fletoren e shënimeve. Tani anëtarët e dyshëve “pro” dhe “kundër” ndahen dhe duhet të bashkohen në çift me një anëtar/e tjetër, i cili po diskuton të njëjtin qëndrim pra. Duhet të krahasojnë arsyet për 4-5 minuta. Dyshet fillestare duhet të ribashkohen, të krahasojnë shënimet dhe të paraqesin arsyet kryesore të zgjedhura. Nxënësit/et nxiten të bashkëbisedojnë për arsyet dhe argumentet.

Hapi 2

Nxënësit/et vazhdojnë ashtu të ndarë në grupe me nga 6 anëtarë. Mësuesi/ja kërkon të lexojnë tekstin dhe çdo nxënësi iu shpërndan fletën e ekspertit me pyetjet:

Fleta e ekspertit Nr. 1

- 1- Si kthejmë qumështin në kos?
- 2- Çfarë ndodh nëse mikroorganizmat që shkaktajnë sëmundjet futen në trupin tonë? 3- Çfarë nënkuptojmë me sëmundje infektive?

Fleta e ekspertit Nr. 2

- 1- Kush e shkakton sëmundjen e tuberkulozit?
- 2- Ku i hasim ato dhe çfarë mund të shkaktojnë me kalimi e kohës? 3- Çfarë përdorim për të parandaluar apo shëruar sëmundjen?

Fleta e ekspertit Nr. 3

- 1- Kush e shkakton malarien? 2- Ku jeton dhe si bartet ai?
- 3- Arsyeto pse infektimi i trurit është i rrezikshëm.

Fleta e ekspertit Nr. 4

- 1- Cili është shkaktari i gripit?
- 2- A mundemi ta shohim me sy?
- 3- A janë viruset mikroorganizma të gjalla?

Fleta e ekspertit Nr. 5

- 1- Çfarë hulumtoi Lui Pasteri?
- 2- Çfarë zbuloi ai me anë të hulumtimit?
- 3- Sqaro termin “antiseptikë” përmes mënyrës përdoruese të tyre.

Fleta e ekspertit Nr. 6

- 1- Sëmundjet infektive shkaktohen nga?
- 2- Rendit disa lloje të mikroorganizmave që shkaktojnë sëmundjet infektive.
- 3- Çfarë përdorim për shërimin e sëmundjeve të shkaktuara nga bakteret dhe viruset?

Në grupin e ekspertëve 1 zgjidhet një ekspert me anë të zarit dhe kjo vlen për të gjithë ekspertët e grupeve tjera. Te përzgjedhurit do të prezantojnë dhe komentojnë përgjigjet e tyre.

Hapi 3

Nxënësit/et plotësojnë tabelën T duke iu përgjigj pyetjes: A munden të jenë të dobishme dhe të dëmshme bakteret?

Qëndrimet pozitive për bakteret	Qëndrimet negative për bakteret
• Shëndërimi i qumështit në kos. • ...	• Shkaktare të sëmundjeve infektive. • ...

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë diskutimet në dyshe, në grup, marrjen e qëndrimeve dhe prezantimin e tyre. Arsimtari/ja vlerëson diskutimin në dyshe rreth çështjeve pro dhe kundër, bashkëpunimin në dyshe dhe grup, komentimin dhe nxjerrjen e përfundimeve si dhe prezantimet e tyre.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Zgjidh pyetjet 2 dhe 3 në tekstin e nxënësit/et në faqet 21.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon vetëdijesim që bakteret mund të kenë efekte të dobishme dhe të dëmshme për organizmin (bakteret mund të ndihmojnë tretjen ose të shkaktojnë sëmundjet).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës: I. 4; III. 3; III. 5; III. 7.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen, si dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
Njësia mësimore: Mikroorganizmat			
Fjalët kyçe: mikroorganizma, baktere, kërpudha mikroskopike, algat, protozoarët.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - tregon çfarë dinë për mikroorganizmat; - dallon disa grupe mikroorganizmash; - krahason mikroorganizmat në bazë të disa vetive. Kriteret e suksesit: Shpjego çfarë janë mikroorganizmat në mënyrë verbale. Veço 4 grupe kryesore të mikroorganizmave në bazë të vetive të tyre dalluese. Gjej vetitë dalluese në mes të algave dhe protozoarëve.			
Burimet: teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografi të mikroorganizmave të ndryshëm.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe Çështjet ndërkurrikulare: Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Ndajmë tabelën në tri shtylla dhe kërkojmë nxënësit/et të tregojnë se ç'dinë për mikroorganizmat. Mësuesi/ja plotëson shtyllën e parë me informacione dhe nga nxënësit/et, meqenëse nxënësit/et kanë informacione rreth mikroorganizmave. Nxiten nxënësit/et që të tregojnë se çfarë dëshirojnë të dinë më tepër rreth mikroorganizmave, duke parashtruar pyetje. Këto pyetje shënohen në shtyllën e dytë të tabelës (Njëkohësisht i shënojnë edhe nxënësit/et në fletoren e tyre).

Hapi 2

Hapet teksti dhe nxënësit/et fillojnë të lexojnë njësinë mësimore duke pasur parasysh që të gjejnë përgjigjet në pyetjet e parashtruara. Pas leximit, mësuesi/ja lexon pyetjet, kurse nxënësit/et japin përgjigjet e gjetura të cilat shënohen në shtyllën e tretë. Gjatë përgjigjeve të nxënësve, mësuesi/ ja i plotëson ato duke dhënë informacione shtesë. Nëse ka ndonjë pyetje pa përgjigje, i drejtojmë që ta kërkojnë në internet si detyrë shtëpie.

Di	Dua të di	Mësova
1. Mikroorganizmat janë gjallesa të cilat nuk vërehen me sy, por me mikroskop.	1. Si ndahen mikroorganizmat?	1. Kemi shumë grupe të mikroorganizmave: bakteret, kërpudhat mikroskopike, algat njëqelizore dhe protozoarët.
2. Që të gjitha kanë ndërtim qelizor.	2. Ku jetojnë mikroorganizmat?	2. Bakteret jetojnë në tokë; kërpudhat mikroskopike jetojnë në substrat; algat njëqelizore dhe protozoarët jetojnë në ujë.
3. Janë gjallesa njëqelizore.	3. A lëvizin mikroorganizmat?	3. Hulumto në Internet.
...	• • •	

Hapi 3

Nxënësit/et duke vrojtuar figurën e dhënë në tekst, në të cilën shihen ose tregohen ca pika ujë pellgu të para në mikroskop, do të dallojnë algat nga protozoarët duke i përshkruar ato. Përshkrimet e këtyre mikroorganizmave do t'i shkëmbejnë me shokun/shoqen e bankës dhe kështu do të vlerësojnë punimet e njëri-tjetrit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë shtrimin e pyetjeve, dhënien e përgjigjeve dhe përshkrimin e algave dhe protozoarëve duke i dalluar ato.

Mësuesi/ja vlerëson informacionet e njohura, llojet e pyetjeve, përgjigjet, dallimin e mikroorganizmave mes tyre si dhe vlerësimin e njëri-tjetrit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Veprimtaria – Kultivimi i mikroorganizmave në ajër. Për orën e ardhshme sjell disa fruta të kalbëzuara.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës / Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VI	
Tema: Biodiversiteti	Rezultati i të nxënit të temës: Tregon vetëdijesim që bakteret mund të kenë efekte të dobishme dhe të dëmshme për organizmin(bakteriet në traktin digjektiv mund të ndihmojnë tretjen ose tëshkaktojnë sëmundjet); Identifikon produktet e jetës së përditëshme të cilat kanë origjinë nga diversiteti i organizmve (p.sh.mëndafshi nga krimbi i mëndafshit,suplimentet ushqimor, shamponët, pastat e dhëmbëve dhe dezodorantët që përmbajnë polen të mbledhur nga bletët etj.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.2; II.3; II.5; III.3; III.5; III.8;	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 1.8 Mikroorganizmat dhe sëmundjet	
Fjalët kyçe: bakteriet, toksinat, bakteriet TBC, malaria	
Rezultati/et e të nxënit përorë mësimore: 1-Paraqet qëndrimet lidhur me pyetjen e shtruar. 2-Formulon përgjigjet në fletëzat e ekspertëve. 3-Zgjidhni ndonjë shembull të mikroorganizmave duke rreshtuar qëndrimet pozitive dhe negative.	
Kriteret e suksesit: 1- Prezanto qëndrimet pro dhe kundër në pyetjen e shtruar. 2-Argumento përgjigjet e dhëna. 3-Gjej së paku dy-tri shembuj kur mikroorganizmat janë të dobishëm dhe të dëmshëm.	
Burimet: Teksti i nxënësit/es	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletat e ekspertit.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	

Hapi 1. Arsimtari/ja ndan nxënësit në grupe dhe brenda grupit formon dyshet të cilat ndahen me qëndrimin „pro” dhe „kundër” shtron pyetjen:

A mund të themi se shumica e mikroorganizmave janë të dobishme dhe përdoren në jetën e përditshme? Dyshet diskutojnë dhe shënojnë përfundimet e tyre në fletoren e shënimeve Tani anëtarët e dyshëve „pro” dhe „kundër” ndahen dhe ata duhet të bashkohen në çift me një anëtar tjetër i cili po diskuton të njëjtin qëndrim pra „pro” dhe „kundër” ata duhet të krahasojnë arsyet për 4-5 minuta. Dyshet fillestare duhet të ribashkohen të krahasojnë shënimet dhe të paraqesin arsyet kryesore të zgjedhura dhe debatohen për arsyet dhe argumentet.

Hapi 2. Nxënësit/et vazhdojnë ashtu të ndarë në grupe me nga 6 anëtarë. Arsimtari/ja kërkon të lexojnë tekstin dhe çdo anëtar/je u shpërndan fletën e ekspertit me pyetjet:

Fleta e ekspertit Nr.1

- 1.Si e kthen njeriun në jetën e përditshme qumështin në kos?
- 2.Çfarë ndodh nëse mikroorganizmat që shkaktojnë sëmundjet futen në trupin tonë?
- 3.Çfarë nënkuptojmë me sëmundje infektive?

Fleta e ekspertit Nr. 2

- 1.Kush shkakton sëmundjen e tuberkulozit?
- 2.Ku i hasim ato dhe çfarë mund të shkaktojnë ato me kalimin e kohës?
- 3.Çfarë përdorim për të parandaluar apo shëruar sëmundjen?

Fleta e ekspertit Nr. 3

- 1.Kush shkakton malarien?
- 2.Ku jeton ai, dhe si bartet ai?
- 3.Arsyeto pse infektimi i trurit mundet me qenë i rrezikshëm?

Fleta e ekspertit Nr.4

- 1.Cili është shkaktari i gripit?
2. A mundemi ta shohim këtë shkaktarë me sy?
2. A janë viruset mikroorganizma të gjallë?

Fleta e ekspertit Nr. 5

- 1.Çfarë u kërkua të hulumtojë Lui Pasteri?
- 2.Çfarë zbuloi ai me anë të hulumtimit?
- 3.Sqaro termin antiseptikë përmes mënyrës përdoruese të tyre.

Fleta e ekspertit Nr.6

- 1.Nga shkaktohen sëmundjet infektive?
- 2.Listo disa lloje të mikroorganizmave që shkaktojnë sëmundjet infektive.
- 3.Çfarë përdorim për shërimin e sëmundjeve të shkaktuara nga bakteret dhe viruset?

Në grupin e ekspertave 1 zgjidhet një ekspert/e me anë të zarit dhe kjo vlen për të gjithë ekspertët e grupeve tjera. Të përzgjedhurit do të prezantojnë dhe komentojnë përgjigjet e tyre.

Hapi 3.

Nxënësit/et plotësojnë tabelën T duke iu përgjigjur pyetjes:

A mund të jenë bakteriet të dobishme dhe dëmshme?

Qendrimet pozitive për bakteriet	Qëndrimet negative për bakteriet
• Shndërrimi i qumështit në kos. • ...	• Shkaktarë të sëmundjeve infektive. • ...
VLERËSIMI I NXËNËSVE	
Nxënësit/et vlerësojnë diskutimet në dyshe, grup, marrjen e qëndrimeve dhe prezantimin e tyre. Arsimtari/ja vlerëson diskutimin në dyshe rreth çështjeve pro dhe kundër, bashkëpunimin në dyshe dhe grup, komentimin dhe nxjerrjen e përfundimeve si dhe prezantimet e tyre.	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR	
Zgjidh pyetjen 2-3 në fletoren e punës f. 21.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon vetëdijesim që bakteret mund të kenë efekte të dobishme dhe të dëmshme për organizmin (bakteret mund të ndihmojnë tretjen ose të shkaktojnë sëmundje). Identifikon dhe përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 4; I. 6; II. 6; II. 1; III. 5			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
Njësia mësimore: Mikroorganizmat dhe kalbëzimi			
Fjalët kyçe: kalbëzim, prishje, lënda organike.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - rendit faktorët që ndikojnë në kalbëzimin e produkteve ushqimore; - shqyrton materialet e prezantuara duke i komentuar vetitë e tyre; - argumenton qëndrimet e tij/saj lidhur me rëndësinë e kalbëzimit. Kriteret e suksesit: Shëno së paku 1-2 faktorë që shkaktojnë kalbëzimin e produkteve ushqimore. Arsyeto së paku me 2-3 argumente lidhur me vetitë dalluese të materialit të kalbëzuar. Arsyeto së paku me 1-2 arsye qëndrimet pro dhe kundër rëndësisë së kalbëzimit.			
Burimet: Teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fruta, perimet, buka e kalbëzuara.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Kimi Çështjet ndërkurrikulare: Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Në orën paraardhëse, mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të sjellin fruta perime apo bukë të kalbëzuara. (mësuesi/ja përgatit disa produkte të kalbëzuara për çdo rast).

Hapi 1

Mësuesi/ja shtron pyetjen: “Si ndodh kalbëzimi (prishja) e produkteve ushqimore?”. Nxënësit/et shënojnë përgjigjet e tyre duke i arsyetuar ato.

Hapi 2

Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në grupe dhe prezanton para tyre materialet e sjella (të kalbëzuara). Çdo grupi i caktohet detyra përkatëse:

Grupi 1- Përshkruaj: Si duken këto produkte të kalbëzuara?

Grupi 2- Krahajo: Gjej të përbashkëtat dhe dallimet mes produkteve të prezantuara. Grupi

3- Shoqëro: Çfarë të sjellin në mendje këto produkte të kalbëzuara?

Grupi 4- Analizo: Çfarë e ka shkaktuar kalbëzimin?

Grupi 5- Zbato: Shëno etapat e hulumtimit rreth kalbëzimit të frutave.

Grupi 6- Argumento: Cilët faktorë ndikojnë në kalbëzimin e frutave?

Grupi zgjedh përfaqësuesin, i cili komenton përfundimet e detyrës së dhënë.

Hapi 3

Mësuesi/ja pas komenteve të nxënësve bën një përmbledhje dhe sqaron: që kalbëzimi shkaktohet nga mikroorganizmat, që substancat e prodhuara nga organizmat e gjallë janë lëndët organike dhe shpërbërja e tyre nga mikroorganizmat shkakton kalbëzim. Faktorët që ndikojnë në shumimin e shpejtë të mikroorganizmave janë:

1- Temperatura 2- Lagështia 3- Oksigjeni

Hapi 4

Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në dy grupe të mëdha. Nxënësit/et që në ditarë i korrespondon një numër tek do të mbajnë qëndrimin pozitiv (pro), kurse nxënësit/et me numrat çift do mbajnë qëndrimin negativ (kundër) në pyetjen: A është e nevojshme prishja (kalbëzimi) e organizmave (të gjallë dhe të vdekur)?

PO

☐

A është e nevojshme
prishja (kalbëzimi) i
organizmave (të gjallë dhe
të vdekur)?

JO

☐

Nxënësit/et shkruajnë idetë e tyre dhe më pas një përfaqësues i grupit prezanton argumentet e dala nga plotësimi i tabelës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë bashkëpunimin në grup, komentimin e rezultateve të dal nga vrojtimi, diskutimi. Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin në grup, saktësinë e rezultateve të raportuara për grup, si dhe argumentet e çështjes së diskutuar.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit/et zgjidhin pyetjen 1, 5, 6 dhe sjellin informata se si përgatitet buka ose kosi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon vetëdijesim që bakteret mund të kenë efekte të dobishme dhe të dëmshme për organizmin (bakteret mund të ndihmojnë tretjen ose të shkaktojnë sëmundje.)	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; I. 2; II. 4; II. 7; III. 3.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen, si dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
Njësia mësimore: Roli pozitiv i disa mikroorganizmave			
Fjalët kyçe: bakteret e dobishme, bakteri i kosit, mikroorganizmi (maja e bukës)			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - paraqet informata në një vijë logjike; - nxjerr përfundimet nga puna praktike; - sjell shembuj nga jeta e përditshme mbi veprimin e mikroorganizmave të dobishëm. Kriteret e suksesit: Shqyrto informatat rreth përgatitjes së bukës dhe kosit. Interpreto së paku 1-2 përfundime të nxjerra gjatë punës praktike. Gjej së paku një shembull mbi veprimin e mikroorganizmave të dobishëm nga jeta.			
Burimet: Teksti i nxënësit			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: enë sterile, thupra qelqi sterile, farë kosi, qumësht, celofan, cilindër i shkallëzuar(menzur), brumë, bukë me maja (tharmë), brumë buke pa maja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Matematikë, Fizikë, Kimi, Gjuhë shqipe.			
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja sjell në klasë një enë sterile, një enë me kos dhe me qumësht, një thupër qelqi sterile, mezurat brumë buke me maja dhe brumë buke pa maja.

Hapi 1

Nxënësit/et ndahen në grupe dhe lexojnë informatat e sjella lidhur me përgatitjen e bukës dhe kosit. Informatat e sjella shqyrtohen brenda grupit dhe nxënësit/et i përzgjedhin. Ata i renditin në fletore sipas një vije logjike. Çdo përfaqësues/e i grupit paraqet para klasës mënyrën e përmbledhjes së informacioneve.

Hapi 2

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et e grupeve teke (1, 3, 5) që të kryejnë në mënyrë praktike përgatitjen e kosit duke përdorur mjetet, kurse grupet çifte (2, 4, 6) të kryejnë veprimtarin e matjes së vëllimit të brumërave me anë të mjeteve që ka sjellë mësuesi/ja.

Hapi 3

Mësuesi/ja shënon në tabelë pyetjet kërkimore:

Grupet teke: - Përse ena e qelqit duhet të jetë sterile për të përgatitur kosin?

- Si mendoni ju, pse është mirë që enën me qumësht ta vendosim në një vend të ngrohtë?
- Përse qumështi nuk është kthyer ende në kos?

Grupet çifte - Përse duhet të vendosen cilindrat e shkallëzuar në vend të ngrohtë?

- Ç'përfundim nxorët nga matja e vëllimit të bukës me tharm dhe pa tharm?
- Argumento rritjen e vëllimit të cilindri i shkallëzuar 2.

Hapi 4

Nxënësit, pas punës praktike, duhet të prezantojnë përfundimet e nxjerra.

Mësuesi/ja rithekson edhe njëherë se mikroorganizmat apo disa baktere të veçanta e shndërrojnë qumështin në kos, pasi ato shndërrojnë sheqerin në acid laktin, si dhe tharmi i bukës ushqehet me lëndët që gjinden në miell dhe me këtë rast lirohet gazi i CO₂ i cili rrit vëllimin e bukës më maja.

Hapi 5

Nga nxënësit/et kërkohet të shënojnë ndonjë shembull të veprimit të mikroorganizmave të dobishëm nga jeta e tyre e përditshme.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë informacionet e sjella, bashkëpunimin në grup.

Mësuesi/ja vlerëson prezantimin e informacioneve të sjella, punën praktike të tyre dhe qëndrimet ndaj pyetjeve kërkimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit/et përgjigjen në pyetjen 4 në faqen 27 të tekstit të nxënësit.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon dhe përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh. invertebrorët nuk kanë shtyllë rruazore; insektet kanë tri pjesë themelore të trupit; bimët me lule prodhojnë lule dhe fryte) dhe i përdor këto karakteristika për klasifikimin e mëtejshëm të llojeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh. invertebrorët-artropodat-insektet; vertebrorët-gjitarët-primatë; bimët me fare-bimët me lule-bimët barishtore).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; I. 6; III. 3; III. 5.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
Njësia mësimore: Kërpudhat dhe algat			
Fjalët kyçe: kërpudhat, hifet sporet, bimët pa lule, bimët me lule, algat, myshqet, njëthelboret dhe dythelboret.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - komenton organizmat që vëren në këtë video prezantuese; - raporton ndarjen e organizmave në grupet (nëngrupet): kërpudhat, bimët me lule, bimët pa lule, myshqet, fieri sipas vetive të tyre dalluese. Kriteret e suksesit: Identifiko organizmat duke i përshkruar dhe dalluar ato në videon e paraqitur. Shpjego vetitë dalluese me anë të të cilave organizmat grupohen në kërpudhat, bimët me lule, bimët pa lule, myshqet, fieri. Formulo përgjigjet në pyetjet e shtruara duke plotësuar ato për grupet të ndryshme të organizmave si kërpudha, bimë pa lule, bimë me lule, myshqet, fiernat.			
Burimet: Teksti i nxënësit, video Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: laptopi, projektori, CD me materialin për prezantim			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Tik, Kimi

Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për media

Hapi 1

Mësuesi/ja me anë të laptopit dhe projektorit paraqet një video të kërpudhave, bimëve me lule dhe pa lule myshqet, algat dhe kërkon që nxënësit/et t'i komentojmë ato.

Hapi 2

Mësuesi/ja formon dyshet dhe i ndan ato me numra 1, 2, 3 dhe 4. Brenda dyshes ndan rolet A-raportuesi dhe B-dëgjuesi. Teksti i nxënësit/et (njësia mësimore) ndahet në katër pjesë, sa janë ndarë edhe dyshet. Çdo pjesë ndahet në dy paragrafë. Nxënësit, në dyshe, lexojnë paragrafin e parë dhe nxënësi A (raportuesi) shpjegon. Pastaj lexohet paragrafi i dytë, por këtë herë ndërrohen rolet d.m.th. nxënësi B raporton dhe nxënësi A ka mundësi të bëjë pyetje, të cilave iu përgjigjet nxënësi B. Kjo bëhet nga çdo dyshe. Nxënësit/et e tjerë kanë të drejtë të bëjnë pyetje, ndërsa nxënësit/et që prezantojnë duhet t'i u përgjigjen.

Hapi 3

Nxënësit/et plotësojnë tabelën:

	Janë organizma bimore	Ndahen në	Shëno disa veti karakteristike të grupit dhe nëngrupeve
Kërpudhat			
Bimët pa lule			
Bimët me lule			

Mësuesi/ja verifikon saktësinë e përgjigjeve dhe i drejton nxënësit/et te përgjigjet e sakta.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë komenteve, përshkrimeve, raportimeve, përgjigjeve. Mësuesi/ja vlerëson saktësinë e përshkrimit të vetive të organizmave të prezantuara, përgjegjësisë gjatë punës në dyshe me rolet e tyre të dyfishta raportues-dëgjues, saktësisë dhe sasisë së informacionit gjatë prezantimit të tyre, mënyrën e përzgjedhur të prezantimit, saktësisë të plotësimit të tabelës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të sjellin për orën tjetër ndonjë (invertebror) pakurrizor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VI	
Tema: Biodiversiteti	Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon dhe përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh. invertebrorët nuk kanë shtyllë rruazore; insektet kanë tri pjesë themelore të trupit; bimët me lule prodhojnë lule dhe fryte) dhe i përdorë këto karakteristika për klasifikimin e metejshëm të llojeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh. invertebrorët-arthropodat-insektet; vertebrorët-gjitarët-primatë; bimët me fare-bimët me lule- bimët barishtore).
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; I.6; III.3; III.5	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmëria e ekosistemeve, ndërtimi dhe funksioni e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 1.12 Bimët	
Fjalët kyçe: kërpudhat, hifet sporet, bimët pa lule, bimët me lule, algat, myshqet, njëthelboret dhe dythelboret.	
Rezultati/et e të nxënit përorë mësimore: 1-Komentoni organizmat që ju i vrejtët në këtë video prezantuese. 2-Raporton ndarjen e organizmave në grupet (nëngrupet): kërpudhat, bimët me lule, bimët pa lule, myshqet, fieri sipas vetive të tyre dalluese. 3-Gjenerojnë njohuritë e tyre bazë për vetitë e tyre dalluese të grupeve të kërpudhave dhe mbretërisë të bimëve. Kriteret e suksesit: 1-Identifiko organizmat duke i përshkruar dhe dalluar ato në videon e paraqitur. 2-Shpjego vetitë dalluese me anë të cilave organizmat grupohen në kërpudhat, bimët me lule, bimët pa lule, myshqet, fieri. 3-Formulo përgjigjet në pyetjet e shtruara duke plotësuar ato për grupet të ndryshme të organizmave si kërpudha, bimë pa lule, bimë me lule, myshqet, fiernat.	
Burimet: Teksti i nxënësit/es, video	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptopi, projektori, CD me materjalin për prezantim	
Lidhja me lëndet e tjera mësimore: Tik-un, Kiminë	
Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për media	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1. Arsimtari/ja me anë të laptopit dhe projektorit paraqesim një video të kërpudhave, bimëve me lule dhe pa lule myshqet, algat dhe kërkojmë t'i komentojmë ato.

Hapi 2. Arsimtari/ja formon dyshet dhe i ndan ato me numër 1, 2, 3 dhe 4 (p.sh. dyshja 1, dyshja 2, dyshja 3 etj.). Brenda dyshes i ndajmë rolet A-raportuesi dhe B-dëgjuesi. Teksti i nxënësit/es (njësia mësimore) ndahet në katër pjesë sa janë ndarë edhe dyshet. Çdo pjesë ndahet në dy paragrafë A dhe B. Nxënësit/et e dyshëve lexojnë paragrafin A dhe raporton (shpjegon) raportuesi. Paragrafin B prapë lexohet nga të dy nxënës/e, por tani ndërrohen rolet d.m.th. nxënësi/ja B raporton dhe nxënësi/ja A ka mundësi t'i shtrojë pyetje në të cilat përgjigjet nxënësi/ja B. Të gjitha dyshet e para prezantojnë, sipas mënyrës së përzgjedhur, pjesën e tyre dhe kjo vazhdon edhe me dyshet e radhës. Nxënësit/et kanë të drejtë të bëjnë pyetje kurse nxënësit/et prezantojnë duhet t'ju përgjigjen.

Hapi 3. Nxënësit/et plotësojnë tabelën:

	Janë organizma bimore	Ndahën në	Shëno disa veti karakteristike të grupit dhe nëngrupeve
Kërpudhat			
Bimët pa lule			
Bimët me lule			

Arsimtari/ja verifikon saktësinë e përgjigjeve dhe drejton nxënësit/et te përgjigjet e sakta.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë komenteve, përshkrimeve, raportimeve, përgjigjeve.

Arsimtari/ja vlerëson saktësinë e përshkrimit të vetive të organizmave të prezantuara, përgjegjësinë gjatë punës në dyshe me rolet e tyre të dyfishta raportues-dëgjues, saktësisë dhe sasisë të informacionit gjatë prezantimit të tyre, mënyrën e përzgjedhur të prezantimit, saktësisë të plotësimit të tabelës

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të sjellin për orën tjetër ndonjë (invertebror) pakurrizor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; I. 4; I. 6; II. 5; III. 5.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
Njësia mësimore: Gjallesat shumëqelizore pa kolonë vertebrore (jovetebrrorët)			
Fjalët kyçe: Jovetebrrorët (pakurizorët), sfungjerët, butakët, krimbat unazorë, këmbënyjtuarit, insektet, araknidet, gaforret dhe shumëkëmbëshat.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - përshkruan organizmin që ka para vetes duke e kategorizuar atë në kategorinë përkatëse; - vërteton organizmat e prezantuar duke nxjerr përfundime mbi vetitë dhe emërtimin e tyre; - argumenton se si i ka kategorizuar organizmat e vërtetuar në oborrin e shkollës. - Kriteret e suksesit: Përshkruaj së paku njërin organizëm me të paktën dy veti dalluese. Shiko videon (fotografitë) duke i përshkruar vetitë e tyre dalluese si dhe kategorizimin e tyre. Arsyeto kategorizimin e organizmave në oborrin e shkollës.			
Burimet: Teksti i nxënësit, video, natyra (oborri i shkollës)			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore invertebrorët (pakurizorët e sjellë dhe ata që i shohim në natyrë, hartat me fotografitë e këtyre organizmave, CD me informacione nga internet)			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: TIK, Arte Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për media			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja (ka përgatitur disa invertebrorë pakurizor të ndryshëm, mundësisht të grupeve të ndryshme). Kërkon nga nxënësit/et të punojnë në dyshe dhe t'i vendosin invertebrorët mbi bankë (nëse ndonjëra nga dyshet nuk ka, mësuesi/ja vendos prej atyre që ka përgatitur vetë). Kërkon që nxënësit/et t'i vrojtojnë dhe t'i përshkruajnë ato. Pasi bëjnë përshkrimin, me një lëvizje rrethore, brenda rreshtit, shkëmbejnë materialin. Dyshet duhet të vrojtojnë materialin e ri dhe ta përshkruajnë. Nxënësit/et prezantojnë përshkrimet e tyre dhe vetitë e dala nga ky përshkrim.

Hapi 2

Mësuesi/ja ndan dyshet me numra nga 1 në 8. Paraqet para nxënësve videon (fotografitë) e secilit prej grupeve të pakurizorëve, me të paktën një përfaqësues dhe kërkon nga nxënësit/et të vëzhgojnë me kujdes për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme

- Pyetjet për dyshen nr. 1: Çfarë ndërtimi kanë sfungjerorët? Si prodhohet enzima dhe cili është roli i saj? Përse shërben oskulumi? Cila është mënyra riprodhuese e sfungjerorit?
- Pyetjet për dyshen nr. 2: Nga rrjedh emërtimi butakë? Si lëvizin ata? Rendit disa përfaqësues.
- Pyetjet për dyshen nr. 3: Nga cilat karakteristika mundemi t'i dallojmë? Keni hasur krimba të tillë? Si lëviznin ata?
- Pyetjet për dyshen nr. 4: Si quhet grupi i organizmave me këmbë me nyje? Po trupi, a ishte me nyje?
- Pyetjet për dyshen nr. 5: Sa këmbë kishte bleta? Si ishin ato? Nga cilat pjesë ndërtohej trupi? Si quhej grupi që përfaqëson ajo?
- Pyetjet për dyshen nr. 6: Çfarë dallimesh vrojtove mes merimangës dhe bletës? Emërto disa përfaqësues të këtij grupi.
- Pyetjet për dyshen nr. 7: Çfarë ekzoskeleti kanë gaforret? A kanë më shumë këmbë apo antena?
- Pyetjet për dyshen nr. 8: Cilit grup i përkasin shumëkëmbëshat? Trego përse i emërtuan kështu? Emërto një përfaqësues të këtij grupi.

Mësuesi/ja dëgjon me vëmendje të gjitha përgjigjet e më pas plotëson njohuritë e reja në bashkëpunim me nxënësit.

Hapi 3

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të dalin në oborr të shkollës dhe t'i klasifikojnë invertebrorët (pakurizorët) që ata i gjejnë.

Mësuesi/ja mbanë shënime mbi saktësinë e kategorizimit të invertebrorëve (pakurizorëve).

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë bashkëpunimin në dyshe, përgjigjet dhe kategorizimin e invertebrorëve (pakurizorëve).

Mësuesi/ja vlerëson përgjegjësitë e nxënësve në sjelljen e materialit, formulimin e përgjigjeve në bazë të vrojtimit, bashkëpunimit në dyshe, si dhe saktësinë e kategorizimit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të përgjigjen në pyetjen 2 të tekstit të nxënësit.

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Krahason karakteristikat e organizmave brenda mbretërive të bimëve ose shtazëve (p.sh. krahason karakteristikat e një peshku dhe një gjitari, të një peme gjethembajtëse-halore dhe një peme gjetherënëse, të fiernave dhe bimëve me lule). Identifikon dhe përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh. invertebrorët nuk kanë shtyllë rruazore; insektet kanë tri pjesë themelore të trupit; bimët me lule prodhojnë lule dhe fryte) dhe i përdor këto karakteristika për klasifikimin e mëtejshëm të llojeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh. invertebrorët - artropodat - insektet; vertebrorët – gjitarët - primatë; bimët me fare - bimët me lule - bimët barishtore).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 4; I. 3; I. 2; III. 3; III. 5.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
Njësia mësimore: Kafshët me shtyllë kurrizore (vertebrorët)			
Fjalët kyçe: vertebror (kurrizorët), peshqit, amfibët, zvarranikët, shpendët dhe gjitarët.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - grupon organizmat e dhënë në grupet përkatëse; - formulon pyetjet për grupet e caktuara duke u bazuar në videon e prezantuar; - plotëson grafikun e prezantuar me fjalë dhe me vizatim. Kriteret e suksesit: Rendit së paku nga 1 organizëm për secilin grup ndarës të kurrizorëve (vertebrorëve). Përpilo 3-4 pyetje duke vendosur theksin në përshkrimin, ndërtimin dhe shumimin e tyre, pra vetive dalluese të grupit. Plotëso grafikun e ndarjes të kurrizorëve (vertebrorëve), duke e vizatuar një përfaqësues të një grupi të caktuar.			

Burimet: teksti i nxënësit, video e përgatitur nga mësuesi/ja

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektori, kompjuteri

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, TIK-un, Artet

Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për media

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të ndajnë fletën e tyre të fletores në 5 shtylla, ku mbi çdo shtyllë shënon grupin e organizmave (vertebrorët, kurrizorët):

Peshqit; Ujëtokësorët (amfibët), Zvarranikët (reptilët), Shpendët dhe Gjitarët.

Mësuesi/ja shënon në tabelë disa etiketa ku shënohet emri i kurrizorit apo vertebrorit: balena, delfini, peshkaqeni, hardhuca, gjeli, struci, breshka, sardelja, bretkosa (zhaba), salamandra. Nxënësit/et kanë për detyrë të grupojnë organizmat e shënuar në grupet përkatëse. Nxënësit/et paraqesin kategorizimin e tyre dhe mësuesi/ja ndërhyr sipas nevojës.

Hapi 2

Nxënësit/et ndahen në 5 grupe. Mësuesi/ja prezanton videon e përgatitur ku mund të vrojtohen organizmat që iu përkasin grupeve kryesore të vertebrorët (kurrizorët).


Kërkohet nga nxënësit/et të formulojnë pyetjet për grupin para tyre. Mësuesi/ja i shtyn nxënësit/et që gjatë pyetjeve të kenë mundësi t'i përshkruajnë ata/ato; të tregojnë ndërtimin dhe funksionimin e tyre si dhe shumimin.

Hapi 3

Nxënësit/et përfaqësues të secilit grup lexojnë përgjigjet, nëse përgjigja nga njëri grup nuk është e saktë kërkohet përgjigja nga grupet e tjera. Mësuesi/ja dëgjon dhe nëse nevojitet ndërhyr në përmasimin e pyetjeve, si dhe i ndihmon nxënësit/et në dhënien e përgjigjeve të sakta.

Hapi 4

Nxënësit/et mbesin të ndarë në grupe dhe secili prej tyre plotëson ndarjen e vertebrorëve (kurrizorëve) dhe çdo njëri prej tyre vizaton vetëm një organizëm për një grup të ndarjes (d.m.th. nxënësi 1 vizaton përfaqësuesin e peshkut, nxënësi 2 i grupit vizaton një përfaqësues të grupit të ujëtokësorëve e kështu me radhë).



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njeri-tjetrin për grupimin e organizmave të dhënë, shtrimin e pyetjeve dhe përgjigjeve të dhëna, si dhe vizatimin e përfaqësuesve të grupeve.

Mësuesi/ja vlerëson saktësinë e grupimin të organizmave në grupe të caktuar, bashkëpunimin në grup gjatë përpilimit të pyetjeve, mënyrën e përpilimit të pyetjeve dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna duke u bazuar në videon e prezantuar. Ajo vlerëson gjithashtu vizatimet e nxënësve të përfaqësuesve të grupeve të dhëna (Lista e kontrollit).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso pyetje dhe detyra në faqen 33 në fletoren e punës.

Të sjellin jo vertebrorët (pakurrizorët) që gjejnë në oborrin e shtëpisë.


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Përdor çelësa të thjeshtë dikotomik për identifikimin dhe klasifikimin e organizmave të gjallë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; I. 6; II. 4; III. 3; III. 5.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Identifikimi i një gjallese bazuar në veçoritë e saj			
Fjalët kyçe: Përcaktuesi biologjikë (çelësi)			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon pakurrizorët e sjellë në klasë; - deshifron emrin e invertebrorit (pakurriorit) me anë të një përcaktuesi të thjeshtë biologjik; - tregon mënyrën e përdorimit të përcaktuesit biologjik. Kriteret e suksesit: Trego disa veti dalluese të pakurrizorit duke i vëzhguar ata. Hulumto për të emërtuar invertebrorin (pakurrizorin) me anë të përgjigjeve në pyetjet të përcaktuesit biologjik. Shpjego mënyrën e përdorimit të çelësit, përcaktuesit biologjik me anë të diskutimit.			
Burimet: Teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: jovertebrorët (pakurrizorët) dorezat plastike, qelq zmadhues (lupa), çelësi (përcaktuesi) biologjik			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhën shqipe Çështjet ndërkurrikulare: Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja përgatit dhe sjell në klasë disa invertebrorë për vëzhgim, hulumtim si dhe çelësat për përcaktuesin biologjikë. Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në grupe dhe kërkon që ata t'i vendosin invertebrorët (pakurrizorët) në bankat e tyre. Mësuesi/ja verifikon se çfarë materiali kanë sjell nxënësit/et dhe iu shpërndan çelësin apo përcaktuesin biologjikë.			

Hapi 2

Mësuesi/ja iu sqaron nxënësve çelësin (përcaktuesin) biologjikë (i cili përmban një grup pyetjesh rreth gjallesës që duhet të identifikojë), mënyrën e përdorimit të tij, i cili rezulton me gjetjen e emrit të gjallesës.

Hapi 3

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të vëzhgojnë, shqyrtojnë dhe në fund të diskutojnë. Nxënësit/et në fillim vëzhgojnë organizmin pa shtyllë kurrizore, më pas fillojnë ta analizojnë duke iu përgjigjur pyetjeve të përcaktuesit biologjikë. Pra:

**Hapi 4**

Mësuesi/ja hap diskutimi me nxënësit/et lidhur me përcaktimin e invertebrorëve: Si i përcaktuat? Si vepruat? A hasët vështirësi? Çfarë përfundimi nxorët?

Hapi 5

Mësuesi/ja sqaron se për identifikimin e gjallesave përdoren përcaktuesit biologjikë të ndryshëm dhe organizimi i të dhënave në ta është i ndryshëm.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë bashkëpunimin në grup, shqyrtimin dhe diskutimin.

Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin, saktësinë e mënyrën se si emërtuan invertebrorin me përcaktuesin biologjikë dhe diskutimin me listë kontrolli.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të hartojnë një përcaktues për identifikimin e katër nxënësve të paraqitur në fotografi në tekstin e nxënësit/et në faqen 35.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Demonstron të kuptuarit e biodiversitetit si shumëllojshmëri e jetës në Tokë, duke përfshirë shumëllojshmëri brenda secilës specie, ndërmjet specieve të bimëve dhe shtazëve në bashkësi jetësore, si dhe ndërmjet bashkësive jetësore dhe peizazhit fizik që i mbështet ato.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; I. 6; II. 4; II. 6; III. 3.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Llojet e gjallesave dhe emërtimi shkencor i tyre			
Fjalët kyçe: lloji, gjinia, pasardhës pjellor, pasardhës jopjellor.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - sqaron vetit karakteristike të organizmave të prezantuara me fotografi; - shpjegon si kryqëzohet lloji dhe kur japin pasardhës pjellor dhe jopjellor; - krahasoni dy llojet e organizmave me vetitë e tyre të përbashkëta dhe të veçanta. Kriteret e suksesit: Trego vetitë e njëjta të organizmave që vrojtove në fotografi. Arsyeto kryqëzimin e llojeve të njëjta dhe krijimin e hibrideve. Veço të paktën 5 veti dalluese dhe 5 veti të njëjta gjatë krahasimit të lopës dhe kalit.			
Burimet: Teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografitë e shtazëve			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe Çështjet ndërkurrikulare: Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja duhet të përgatitë disa fotografi ku të vërehen organizmat që krijojnë llojin (p.sh. foto 1- disa lopë; foto 2 - disa sardele; foto - 3 disa elefantë) dhe fotografi me anëtarët e ndryshëm të llojeve (p.sh. foto 4 - një qen, një mace, një mi, ose foto 5 - pula, pëllumba, harabela dhe foto 6 - foka, peshkaqeni, delfini).			

Hapi 2

Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në grupe dhe vendos në grupin e parë fotografinë 1; në grupin e dytë fotografinë 6; në grupin e tretë fotografinë 2; në grupin e katërt fotografinë 5; në grupin e pestë vendos fotografinë 3 dhe në grupin e gjashtë vendos fotografinë 4.

Kërkohet nga nxënësit/et të shikojnë fotografitë dhe të nxjerrin përfundimet.

- A ngjasojnë këto shtazë me njëra-tjetrën? A munden të kryqëzohen mes tyre? Nga bashkëbisedimi i nxënësve dhe mësuesit/es arrihet në përfundimin se:

- Lloji është një grup organizmash që kanë tipare të përbashkëta. Individët e të njëjtit lloj munden të kryqëzohen dhe të japin pasardhës.

Hapi 2

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë tekstin e nxënësit/et të ndarë në dy ndalesa. Ndalesa 1 ka 3 paragrafë dhe ndalesa 2 ka 2 paragrafë. Nxënësit/et lexojnë ndalesën e parë (tre paragrafët) dhe mësuesi/ja shtron pyetjet:


- Sqaro përmes një shembulli kryqëzimin e organizmave që japin pasardhës pjellorë
- Sqaro, përmes një shembulli, kryqëzimin e organizmave që japin pasardhës jopjellorë.
- Në cilin grup bën pjesë ligeri?

Pasi nxënësit janë përgjigjur, lexojnë përsëri edhe materialin për ndalesën e dytë (dy paragrafë), dhe më të përfunduar leximin shtrojmë pyetjet:

- Si njihet apo emërtohet balena vrasëse pavarësisht nga vendbanimi?
- Si emërtohet kjo balenë në gjuhën latine?
- Ç'bëri Lineu në vitin 1735? Arsyeja veprimin e tij.
- Ç'përparësi kishin njerëzit me përdorimin e emërimit të gjallesave me sistemin e Lineut?
- Sqaro domethënien e emërimit "Homo Sapiens".

Hapi 3

Mësuesi/ja do të kërkojë nga nxënësit që të qëndrojnë në grupe dhe të bëjnë krahasimin mes dy organizmave, të njohur për ta, lopës dhe kalit, duke treguar 5 veti të përbashkëta dhe 5 veti të veçanta mes tyre:



Hapi 4

Nxënësit/et komentojnë përgjigjet e tyre të shënuara dhe mësuesi/ja ndërhyt me raste sipas nevojës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin për bashkëpunimin, prezantimin dhe komentet e bëra. Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin e nxënësve në grupe, saktësinë e përgjigjeve të dhëna, rezultatet e dala nga grupet punuese, vërtetimin e krahasimit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetjet dhe detyra në tekstin e nxënësit në faqen 37.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Demonstron të kuptuarit e biodiversitetit si shumëllojshmëri e jetës në Tokë, duke përfshirë shumëllojshmërinë brenda secilës specie, ndërmjet specieve të bimëve dhe shtazëve në bashkësi jetësore, si dhe ndërmjet bashkësive jetësore dhe peizazhit fizik që i mbështet ato.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2; I. 6; II. 4; III. 5.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ndryshueshmëria brenda llojit			
Fjalët kyçe: ndryshueshmëria e llojit, gjinia			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - interpreton arsyen e shumëllojshmërisë të llojeve me anë të diskutimit; - konstaton përfundime për ndryshueshmërinë e llojit me anë të vetive apo të dhënave në tabelë; - analizon ndryshueshmërinë e llojit me anë të njëjës veti të paraqitur në tabelë. Kriteret e suksesit: Shpjego përse pjesëtarët e një lloji dhe gjinie ndryshojnë. Shpjego ndryshueshmërinë e llojit me anë të vetive të paraqitura në tabelë. Veço rezultatin përfundimtar përmes njëjës veti të përzgjedhur.			
Burimet: Teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fishat me dy llojet e tabelave.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Matematikë. Çështjet ndërkurrikulare: Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja shtron pyetjen:

- Si mendoni ju, a janë të gjithë individët e një lloji dhe gjinie të njëjtë, për shembull llojet e qenve edhe pse racat e qenve shfaqin ndryshim mes tyre, ose te njeriu? Arsyeto përgjigjen!

Mësuesi/ja dëgjon dhe, sipas nevojës, i nxit nxënësit/et për arsyetimin e përgjigjeve të dhëna. Mësuesi/ja duhet të kujdeset që nxënësit/et të mos i korrigjojnë përgjigjet e dhëna, në mënyrë që të marrë sa më shumë arsyeime të pyetjes.

Hapi 2

Mësuesi/ja i përgatit fishat me tabelën ku vendos disa tipare për t'u vëzhguar dhe plotësuar.

Emri i nxënësit	Ngjyra e flokëve	Ngjyra e syve	Numri i këmbës	Pesha
Elvisa	Të zeza	Të kafta	39	65 kg
Arianiti	Të kafta	Të kaltra	40	60 kg
...				
...				

Nxënësit/et ndahen në grupe dhe përgatiten aq fisha sa grupe formohen. Ata/ato duhet të mbledhin të dhënat brenda grupit të tyre, pasi të plotësojnë emrin e çdo anëtari/e të grupit dhe vetitë e tyre (ngjyrën e flokëve; ngjyrën e syve; numrin e këmbës dhe peshën. Nxënësit/et zgjedhin përfaqësuesin/en, i cili komenton rezultatet.

Hapi 3


Mësuesi/ja shpërndan fishat e tjera të përgatitura me tabelën:

Ngjyra e flokëve	Të zeza	Të kafta	Të kuqe	Të bardha
Numri i nxënësve	1+1	1	1	1
Gjithsej	2	1	1	1

Kërkon nga anëtarët e grupeve të marrin shënimet e prezantuara nga të gjitha grupet lidhur me vetinë e ngjyrës së flokëve.

Hapi 4

Tani, mësuesi/ja kërkon që të dhënat e marra t'i prezantojnë në grafik sa i përket ngjyrës së flokëve dhe numrit të nxënësve.



Në fund, nxënësit/et prezantojnë grafikun dhe mësuesi/ja thekson rezultatin e nxjerrë nga aktiviteti i tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë bashkëpunimin, saktësinë e rezultateve dhe prezantimin grafik të tyre sipas grupeve.

Mësuesi/ja vlerëson arsyetimin e pyetjes së shtruar, idetë dhe saktësinë e tyre, prezantimin e të dhënave tabelare, saktësinë e tyre, kohën e plotësimit të tabelës, si dhe saktësinë e paraqitjes të grafikut.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetja 2 në tekstin e nxënësit/et në faqen 39.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Demonstron të kuptuarit e biodiversitetit si shumëllojshmëri e jetës në Tokë, duke përfshirë shumëllojshmëri brenda secilës specie, ndërmjet specieve të bimëve dhe shtazëve në bashkësi jetësore, si dhe ndërmjet bashkësive jetësore dhe peizazhit fizik që i mbështet ato.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II. 4; I. 4; III. 5; III.2; I.6.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ndryshueshmëria (variacioni)			
Fjalët kyçe: ndryshueshmëria, variacionet, gjenet, kromozomet.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore			
Nxënësi/ja: - shkallëzon etiketat e dhëna duke i renditur ato sipas një shkalle hierarkie nga më e përgjithshmja (e larta) gjer te më e veçanta (e ulëta); - plotëson duke llogaritur vlerën mesatare të kyçit të dorës; - arsyeton pse individët e të njëjtit lloji me veti e karakteristika të përbashkëta dallojnë nga njëri-tjetri.			
Kriteret e suksesit: Rendit etiketat sipas një shkalle hierarkie bazuar në karakteristikat e tyre. Llogarit vlerën mesatare të kyçit të dorës duke i shënuar këto vlera në tabelë dhe nxjerr përfundime lidhur me ndryshueshmërinë. Vlerëso dallimin e individëve apo të njëri-tjetrit me anë të karakteristikave dhe vetive.			
Burimet: Teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketat, fletat A4, fishat (fletat) me udhëzime në kundërfaqen e tyre.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhën shqipe, Matematikë Çështjet ndërkurrikulare: Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Mësuesi/ja përgatit etiketat, ndan nxënësit/et në grupe dhe në çdo grup vendos etiketat e shënuara me këto emërtime:

mbretëria	tipi	lloji	familja	gjinia	klasa	rendi
-----------	------	-------	---------	--------	-------	-------

Mësuesi/ja sqaron se radhitja duhet bërë nga vetitë më të përgjithshme deri te më të veçantat. Kërkon që nxënësit/et t'i radhisin ato sipas një vije logjike (sipas radhës) duke i ngjitur në një fletë të bardhë. Mësuesi/ja përcjell radhitjen e tiketave duke dhënë sqarime nëse kërkohet ndihma nga nxënësit. Nxënësit/et zgjedhin përfaqësuesin e grupit dhe prezanton radhitjen e dalë në grupi e tyre. Mësuesi/ja në fund sqaron që radhitja e duhur duhet të jetë: mbretëria, tipi, rendi, klasa, familja, gjinia.

Hapi 2

Mësuesi/ja shtron pyetjet: A janë individët e të njëjtit lloj të njëjtë? Pse?

Nxënësit/et përgjigjen dhe mësuesi/ja sqaron që individët e të njëjtit lloj edhe pse ngjasojnë, kanë karakteristika të njëjta, dallojnë nga njëri-tjetri dhe kjo quhet variacion apo ndryshueshmëri.

Mësuesi/ja shpërndan tabelat me udhëzimin në kundërfaqe për llogaritjen e vlerës mesatare të matjes. Fton nxënësit, që ashtu si janë të ndarë në grupe të bëjnë matjen e kyçit të dorës dhe ta plotësojnë tabelën me udhëzimin për llogaritjen e matjeve mesatare.


Përmasat e kyçit të dorës (në cm)	Shenja për evidencën e individëve pas matjes	Gjithsej nxënës
8 - 8,9 cm	+,+,+	3
9 - 9,9 cm	+	1
10 - 10,9 cm	+,+,+,+,+	4

Hapi 3

Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të rigrupohen në grupet sipas përmasave të kyçit të dorës d.m.th. grupi 1 nxënësit/et me përmasa të kyçit të dorës 8 - 8,9 cm e kështu me radhë.

Hapi 4

Mësuesi/ja kërkon që grupet të paraqesin rezultatin në fletat A4 me anë të grafikut ku në boshtin X (abshisë) shënojnë vlerat e matjeve të përmasat e kyçit të dorës, ndërsa në boshtin Y (ordinatë) numrin e nxënësve.



Hapi 5

Mësuesi/ja sqaron se përmasat e ndryshme të kyçit të dorës paraqesin variacione që përcaktohen përmes gjeneve që ndodhen në kromozome. Njeriu posedon 46 kromozome (ndërsa qelizat tona seksuale kanë 23 kromozome) të përbëra nga ADN-ja, proteinat dhe një numër shumë i madh i gjeneve. Gjenet janë përgjegjëse për caktimin e vetive (tipareve si ngjyra e flokëve, syve format trupore etj.). Duhet theksuar se në variacione ndikon edhe ndikimi i mjedisit, p.sh.. ata individ që merren me punë fizike kanë përmasa më të mëdha të kyçit të dorës në krahasim me individët që nuk merren me punë fizike.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë bashkëpunimin në grupet punuese, plotësimin e tabelës së rezultateve dhe ndërtimin e grafikut përkatës.

Mësuesi/ja me anë të listës së kontrollit vlerëson bashkëpunimin, angazhimin e tyre në plotësimin e tabelave si dhe saktësinë gjatë ndërtimit të grafikut përkatës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR


Pyetjet 2 dhe 3 në tekstin e nxënësit/et në faqen 41.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Përdor fjalor të duhur shkencor dhe teknologjik gjatë komunikimit gojor ose me shkrim duke përfshirë: klasifikimi, biodiversiteti, bashkësinë jetësore natyrore (biocenoza), marrëdhëniet e ndërsjella, vertebrorët- kurrizorët, invertebrorët - parruazorët, stabiliteti, karakteristikat, organizmin etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: III. 5; I. 3; II. 6; III. 3.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vendbanimi i gjallesave. Biosfera			
Fjalët kyçe: mjedisi, biosfera, atmosfera, litosfera, hidrosfera, organizmat anaerobë.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - shënon informatat e njohura apo të ditura lidhur me mjedisin; - dallon tri pjesët fizike të planetit tokë dhe gjallesat që jetonin në këto pjesë; - veçon pjesët më të rëndësishme për ndryshimet e biosferës gjatë zhvillimit historik.			
Kriteret e suksesit: Plotëso kllasterin me informatat e njohura lidhur me ndarjen e vendbanimin dhe llojet e organizmat që jetojnë aty. Shpjego vendndodhjen e pjesët fizike të planetit tokë dhe së paku një lloj të gjallesave që jetojnë në to. Komento pjesët e veçuara lidhur me ndryshimet që pësuan organizmat gjatë zhvillimit historik të biosferës.			
Burimet: Teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fishat e thata, letër A4			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhe shqipe, Gjeografi Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja fillon orën duke kërkuar nga nxënësit/et të grupohen në grupe dhe iu shpërndan fletat A4 në të cilin ai/ajo ka vizatuar një kllaster me shënimin “Mjedisi” (vendbanimi) i gjallesave. Kërkohet nga nxënësit/et të plotësohet



Nxënësit/et lexojnë detyrën.

Hapi 2

Mësuesi/ja pyet nxënësit/et sa lloje të mjedisit njohin? A e dinë si emërtohen këto ndarje të planetit tokë? Çfarë ndodh me gjallesat në raport me mjedisin? Cilat grupe të organizmave mund të hasim me këtë rast? Çfarë kuptoni me termin Biosferë?

Pas përgjigjeve të dhëna, mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të punojnë në dyshe dhe u cakton paragrafët për t'i lexuar në pjesën biosfera dhe atmosfera. Mësuesi/ja shpërndan ffishat e thata ku nxënësi/ja duhet të shënojë citatat që ka veçuar, lidhur me ndryshimet e biosferës gjatë zhvillimit historik të planetit tokë dhe organizmave që kanë jetuar në të, kurse në kundërfaqen e fisheve ata shënojnë komentet e tyre.

Mësuesi/ja i përzgjedh nxënësit/et me llogaritje të datës (p.sh. 12.10.2018 = 15 ose = 3 ose = 4). Një nxënës lexon punën e tij dhe mësuesi/ja bën kujdes që diskutimi të jetë i përqendruar. Diskutimi mbyllet kur nxënësi që lexoi pjesën e zgjedhur, të lexojë komentet dhe pyetet a do të ndryshonte diçka pas komentit të paraqitura në diskutim. Mësuesi/ja nuk duhet të lejojë komente e diskutim pas leximit të komentit të nxënësit/et të përzgjedhur me datë. Në këtë mënyrë vepron edhe me nxënësit/et e tjerë për paragrafët e dhënë.

Hapi 3

Kërkohet nga nxënësit/et të ndarë në dyshe që të shkruajnë një poemth me pesë vargje.

Dyshet shkëmbejnë fletoret, lexojnë pesëvargëshat e njëri-tjetrit dhe vendosin cilin pesëvargësh do të prezantojnë.

Mësuesi/ja dëgjon dhe ndërhyr për përmirësime sipas rastit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin për bashkëpunimin në dyshe dhe komentet.

Mësuesi/ja vlerëson plotësimin e kllasterit, përzgjedhjen e materialit, komentimin dhe shënimin të pesëvargëshit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetjet 2 dhe 3 në tekstin e nxënësit/et në faqen 41.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon faktorët të cilët ndikojnë në ekzistencën e një organizmi; karakteristikat fizike të mjedisit (temperatura, drita, uji), disponueshmëria e ushqimit; tipat e organizmave të tjerë të pranishëm (prodhuesit, konsumuesit, shpërbërësit).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 4; I. 2; I. 6; III. 5; III. 3.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Faktorët fizikë dhe kimikë që ndikojnë në jetën e gjallesave			
Fjalët kyçe: Faktorët fizikë faktorët kimikë			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - dallon faktorët fizikë nga ata kimikë; - shpjegon ndikimin e faktorëve fizikë dhe atyre kimikë në gjallesa; - argumenton ndikimin e dritës në jetën e një gjallese bimore. Kriteret e suksesit: Veço së paku 3-4 faktorët fizikë nga ata kimikë. Dëshmo me anë të shembujve ndikimin e faktorëve abiotikë në gjallesat. Shpjego ndikimin e dritës te bima e dhënë në foto.			
Burimet: Teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketat			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Fizikë, Kimi, Gjuhë shqipe Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Mësuesi/ja shënon etiketat në tabelë dhe kërkon nga nxënësit/et t'i radhisin në shtyllat përkatëse.

Temperatura	Drita	Presioni atmosferik	Lagështia e mjedisit	reshjet	era
Oksigjeni	Azoti	Dioksidi i karbonit	Fosfori	Squfuri	
Faktorët fizikë			Faktorët kimikë		
Temperatura			Oksigjen		
•			•		
• Drita			• Azoti		
• ...			• ...		

Më pas, disa nxënës/e prezantojnë radhitjen e tyre në shtylla. Mësuesi/ja ndërhyr sipas rastit.

Hapi 2

Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në dyshë dhe i emërton me numra (1, 2, 3, 4). Më pas, udhëzon nxënësit/et të lexojnë paragrafët të ndara në ndalesa, duke u përgjigjur pyetjeve të parashtruara:

Ndalesa 1- (2 paragrafë)

Cilat elemente përcaktojnë cilësinë e një mjedisi të caktuar? Ku ndikon temperatura dhe nga kush varet në një mjedis. Çfarë do të ndodhte me shtazët po mos të ketë energji diellore?

Ndalesa 2- (2 paragrafë)

Ç'është presioni atmosferik dhe kur vepron mbi gjallesat? Sqaro si e përballojnë gjallesat presionin e ulët dhe të lartë (madh)? Ku mundemi të hasim këto lloje të presionit?

Ndalesa 3- (3 paragrafë)

Çfarë paraqet lagështia e ajrit? Ç'kupton me: lagështia e ajrit është 10%? Sqaro kur kemi shumëllojshmëri të gjallesave bimore dhe shtazore? A janë të përshtatshme për gjallesat vendet që preken prej erërave të fuqishme? Rëndit disa prej arsyeve pse erërat e lehta janë më të përshtatshme për gjallesa.

Ndalesa 4- (3 paragrafë)

Cilët faktorë kimikë luajnë rol të rëndësishëm për gjallesat? Si i rikthejnë gjallesat mjedisit këta faktorë kimikë? Ç'mendon, a janë të lidhur faktorët fizikë dhe kimikë?

Dyshet përgjigjen në pyetjet e shtrura dhe mësuesi/ja bën një përmbledhje të faktorëve abiotikë.

Hapi 3

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të shikojnë figurën të veprimtarisë dhe të shpjegojnë ndikimin e dritës në jetën e gjallesave bimore.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë radhitjen e etiketave, komentimin e pyetjeve, dhe shpjegimet e dhëna lidhur me faktorëve fizikë dhe kimikë.

Mësuesi/ja vlerëson saktësinë e radhitjes së etiketave, saktësisë së përgjigjeve dhe shpjegimeve të dhëna lidhur me kërkesën e veprimtarisë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetje 4, 5 dhe 6 në tekstin e nxënësit/et në faqen 49.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon faktorët të cilët ndikojnë në ekzistencën e një organizmi; karakteristikat fizike të mjedisit (temperatura, drita, uji), disponueshmëria e ushqimit; tipat e organizmave të tjerë të pranishëm (prodhuesit, konsumuesit, shpërbërësit).	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2; I. 3; I. 4; II. 4; III. 3.

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Cilësia e tokës, uji dhe ajrit ndikon në jetën e gjallesave

Fjalët kyçe: faktorët, toka, uji, ajri, gjallesa, ndotja.

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- identifikon cilësitë e tokës, ujit dhe ajrit në jetën e gjallesave;
- veçon gjallesat që jetojnë në llojet e ndryshme të tokës dhe rëndësinë e tyre;
- diskuton rreth pasojave të ndotjes të ujit, ajrit në jetën e gjallesave.

Kriteret e suksesit:

- 1- Dallo ndikimin e tre faktorëve: tokës, ujit dhe ajrit në jetën e gjallesave.
- 2- Radhit së paku 2-3 gjallesa në llojet e ndryshme të tokës, duke shpjeguar rëndësinë e tyre.
- 3-Arsyeto pasojat e ndotjes së ujit, ajrit në jetën e gjallesave me anë të shembujve.

Burimet: Teksti i nxënësit

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhën shqipe, Kimi, Gjeografi

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Parashtrohet pyetja: Si mendoni, cilët janë faktorët që ndikojnë në jetën e gjallesave? Informacionet e nxënësve, mësuesi/ja i shënon në tabelë. I nënvizojmë tre faktorët, nëse dalin nga ta: toka, uji, ajri. Nxënësit/et tregojnë sesi mund të ndikojnë në jetën e gjallesave këta tre faktorë.

Hapi 2

Kërkojmë nga nxënësit/et që në fletore të tyre të formojnë një tabelë me dy shtylla. Në anën e majtë të tabelës shënojmë pyetjet rreth mësimi, kurse në të djathtë do t'i shënojnë përgjigjet pasi të lexojnë mësimin. Njëkohësisht dhe mësuesi/ja i shënon këto pyetje në tabelë.

Nxënësit/et lexojnë mësimin duke pasur parasysh pyetjet dhe gjetjen e përgjigjeve në to.

Pyetje	Përgjigje
- Cilat janë cilësitë e tokës? - Cilësitë e ujit? - Pse është i domosdoshëm për jetën e gjallesave? - Cilat janë cilësitë e ajrit?	

Kërkojmë nga një nxënës vullnetarë që të lexojë përgjigjen në pyetjen e parë, rreth cilësisë së tokës. Pasi të përgjigjet, të tjerët e plotësojnë dhe në fund, mësuesi/ja jep sqarime shtesë sipas nevojës. Pason përgjigja rreth pyetjes së dytë, nga një nxënës tjetër. Ndiqet e njëjta procedurë edhe për pyetjen e tretë.

Këto përgjigje paraqiten në tabelë para klasës.

Hapi 3

Kërkojmë nga nxënësit/et që të shpjegojnë me anë të shkrimit shprehjen: “Krimbat e tokës shkrifërojnë dheun dhe ndihmojnë në rritjen e bimëve.”

Nxënësit/et shkëmbejnë në fund fletoret ku vlerësojnë shpjegimin e njërit-tjetrit. Dy-tre/i nxënës/ lexojnë shkrimin para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë dhënies së përgjigjeve dhe prezantimit të tyre.

Mësuesi/ja vlerëson njohuritë, përgjigjet e dhëna në pyetjet e parashtruara dhe shpjegimin rreth rëndësisë së krimbave në shkriftimin e dheut.


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësve të rreshtit të parë iu jepet për detyrë të vëzhgojnë një mjedis me lagështi; rreshti i dytë duhet të vëzhgojë një mjedis pa lagështi dhe rreshtit të tretë, një mjedis me ajër të pastër (pyll, livadh). Vëzhgimi do të bazohet rreth gjallesave bimë që rriten aty.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Diskuton efektin në organizma kur mjedisi bëhet i pafavorshëm (organizmi përshtatet dhe mbijeton, zhvendoset në një vend tjetër ose vdes).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; I. 4; II. 6; III. 3; III. 5			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ndikimi i gjallesave në cilësinë e mjedisit			
Fjalët kyçe: gjallesa bimore, mjedis, shkëmborë, pyll, liqen, kënetë, livadh, moçal, bimë bishtajore.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - diskuton rreth gjallesave bimore në mjedise me lagështi dhe pa lagështi; - analizon tekstin mësimor në bazë të pyetjeve të fletë eksperti; - kategorizon njohuritë rreth ndikimit të gjallesave në mjedise të ndryshme përmes një organizuesi grafik. Kriteret e suksesit: Sqaro rreth 2-3 gjallesa bimore që i vërejte në mjedise të vëzhguara. Shqyrto materialin mësimor për t'iu përgjigjur 3 pyetjeve përmbledhëse nga fletë eksperti. Paraqit ndikimin e gjallesave në transformimin e një mjedisi në mjedis tjetër, përmes organizuesit grafik.			
Burimet: Teksti i nxënësit, Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tabela, fletë eksperti			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Kimi, Fizikë Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Hapim një diskutim me nxënësit/et rreth detyrës së dhënë si detyrë shtëpie, rreth vëzhgimeve të bimëve në tokën me dhe pa lagështi si dhe në ajër të pastër. Gjatë diskutimit të tyre, mësuesi/ja paraqet të dhënat e nxjerra nga vëzhgimet në hartën e mendimeve, në tabelë.



Hapi 2

Formojmë 4 grupe me nxënës dhe brenda çdo grupi nxënësit/et numërojnë nga 1-4. Çdo nxënësi brenda grupit i shpërndahet nga një fletë eksperti, ku janë të shënuara nga 3 pyetje rreth njësisë mësimore. Fletat kanë lloje të ndryshme pyetjesh.

Fletë eksperti 1: Si kthehet liqeni në kënetë? Si rezultat i kujt transformohen liqenet? Ç'rëndësi paraqesin bakteret në rrënjët e bimëve bishtajore?

Fletë eksperti 2: Si kthehet zona shkëmbore në pyll? Çfarë e ndihmon kthimin e kënetës në livadh? Pse bimët bishtajore e pasurojnë tokën me kripëra minerale?

Fletë eksperti 3: Cili është kontributi i likeneve në kthimin e zonës shkëmbore në pyll? Si mund të formohet pylli në zona moçalore? Cili është roli i bimëve bishtajore?

Fletë eksperti 4: Shpjego kthimin e tokës shkëmbore në atë të butë. Çfarë shembulli paraqet liqeni i Prespës? Pse toka para se të mbillet me drithëra, duhet të mbillet me bimë bishtajore?

Nxënësit/et lexojnë tërë materialin mësimor, duke pasur parasysh gjetjen e përgjigjeve në pyetjet e fletës së ekspertit.

Pasi t'u përgjigjen pyetjeve, secili/a nxënës/e shkon në grupin e caktuar të ekspertëve (të gjithë 1-shat në një bankë; të gjithë 2-shat në një vend tjetër e kështu me radhë). Aty sqarohen përgjigjet në pyetjet e fletës së caktuar të ekspertit/es dhe vendosin mënyrën e paraqitjes së përgjigjeve në grupin bazë.

Pas 5-7 minutash kthehen në grupet bazë dhe u sqarojnë nxënësve të tjerë përgjigjet e fletës së tyre. Po ashtu, nëse ka nevojë, përgjigjen në pyetjet shtesë të parashtruar nga nxënësit/et e tjerë.

Hapi 3

Me anë të organizuesve grafik, nxënësit/et individualisht, paraqesin kthimin e mjediseve shkëmbore në pyll, liqenit në kënetë, kënetës në livadh. Dy-tre/i nxënës/e prezantojnë para klasës punimet e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë shpjegimit në grupin bazë.

Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin e nxënësve në grupet eksperte, mënyrën e shpjegimit në grupin bazë, si dhe prezantimet e organizuesve grafikë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mblidh materiale nga interneti mbi gjendjen e lumenjve ose liqeneve në vendin tonë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VI	
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësorë	Rezultati i të nxënësve të temës: Bën dallimin mes termave organizëm, popullatë dhe bashkësi jetësore.- Organizmi është qenie e gjallë.- Popullata definohet si grup i bimëve ose shtazëve të llojit të njëjtë që jetojnë dhe riprodhohen në një vend dhe kohë të caktuar. Bashkësia jetësore përbëhet nga shumë popullata të cilat jetojnë në një vend të veçantë.
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: III.1; I.6; II.7; III.7	
Rezultatet e fushës së kurrikulës : Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmëria e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 2.5 Nivelet e organizimit të gjallesave	
Fjalët kyçe: Habitat, popullatë, bashkësia biologjike, biotop, biocenozë dhe ekosistem	
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore: 1. Hulumton për të treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme me anë të një vep- rimtarie studimore. 2. Interpretin nivelet e organizimit të gjallesave në biocenozat e ndryshme. 3. Kategorizon habitatet në bazë të kushteve që ai i siguron me anë të fotografisë.	
Kriteret e suksesit: 1. Trego disa mundësi që ju ofron mjedisi gjallesave duke specifikuar disa karakteristika dhe për- shtatshmëri. 2. Krahaso nivelet e organizimit të gjallesave në biocenozat e ndryshme duke i paraqitur ato me ane të shembujve 3. Veço habitatet në bazë të kushteve të paraqitura.	
Burimet: Teksti i nxënësit, interneti	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Poster, Fotot	
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuha shqipe, Gjeografia, Kimia, Artet	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, Edukim për media	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Bashkëbisedim rreth gjetjeve të nxënësve rreth detyrës së kërkuar të orës paraprake. Hapi 1. Çdo grup nxënësish, ka realizuar paraprakisht një veprimtari studimore lidhur me mbledhjen e informa- cioneve rreth biotopit përkatës.	

Grupi 1-pylli; grupi 2-oqeani; grupi 3-shkretëtira dhe grupi 4-Poli i veriut.

Çdo grup, me anë të posterit, tregon mundësitë që ofron ai mjedis për jetën e të gjitha gjallesave që jetojnë aty (karakteristikat dhe përshtatshmërinë e tyre).

Parashtrijmë pyetjen: Ç'mendoni, a ka raste që e njëjta gjallesë të përshtatet në habitate të ndryshme?

Hapi 2.

Çdo grupi ekzistues (4 grupeve), arsimtari/ja u cakton nga një nivel organizimi. Materiali mësimor lexohet nga nxënësit e të gjitha grupeve. Më pas, çdo grup përpilon nga tri pyetje për nivelin e caktuar të organizimit të gjallesave. Grupi parashtron pyetjet grupit tjetër, ku anëtarët e këtij grupi përgjigjen (p.sh. gr.1->gr.2; gr.2->gr.1 ;gr.3-> gr.4; gr.4-> gr.3).

në fund Arsimtari/ja përmbledh informatat lidhur me nivelet e organizimit të gjallesave.

Hapi 3.

Nxënësi/ja, individualisht kryen një veprimtari. Përshkruan habitatet e gjallesave të paraqitura në foto, kushtet që secili habitat ia siguron gjallesës përkatëse si dhe tregon se cilat nga gjallesat e dhëna jetojnë në më shumë se një habitat.

Puna paraqitet para klasës nga ana e dy-tre nxënësve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin sipas informacioneve për biotopin, pyetjeve, përshkrimit të kushteve. Arsimtari/ja vlerëson mbledhjen e informatave të paraqitura për biotopin, prezantimit të përshtatshmërisë dhe karakteristikat të gjallesave të jetonin në habitate të ndryshme.


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shpjego me shkrim: A mund të jetoni ju në një habitat, i cili nuk është për ju p.sh. në një shkretëtirë apo në polin e veriut? Pse? Argumentoni përgjigjen.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Hulumton organizmat e gjetur në një habitat specifik (oborr shkolle, park qyteti, kënetë, lum, pyll, livadh, etj.) dhe i klasifikon organizmat sipas sistemit të klasifikimit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2; I. 4; II. 4; III. 3; VI. 1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Punë eksperimentale. Vëzhgojmë gjallesat			
Fjalët kyçe: mikroorganizmat, gjallesat shtazore (milingonat) Gjallesat bimore (likenet)			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - punon aktivitetin hulumtues duke vëzhguar organizimin e gjallesave; - diskuton në grupet e juaja rezultatet e mbledhura lidhur me vëzhgimin e parazitëve, organizimin e milingonave dhe ndryshimet te likenet; - argumenton përfundimet e nxjerra nga rezultatet e vëzhgimit të parazitëve, organizimin e milingonave dhe ndryshimet te likenet. Kriteret e suksesit: Vëzhgo aktivitetin hulumtues duke i mbledhur rezultatet për parazitët, organizimin e milingonave dhe ndryshimet te likenet. Shqyrto e mbledhura gjatë vëzhgimit të kryer të aktivitetit hulumtues. Arsyeto së paku me 1-2 arsye përfundimet e rezultateve të mbledhura gjatë vëzhgimit.			
Burimet: Natyra, teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: ujë, alkool, disa enë, copa druri, lupë, likene.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjeografi, Edukatë qytetare Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Hapim një diskutim me nxënësit/et rreth detyrës së dhënë si detyrë shtëpie, rreth vëzhgimeve të bimëve në tokën me dhe pa lagështi, si dhe në ajër të pastër. Gjatë diskutimit të tyre, mësuesi/ja paraqet të dhënat e nxjerra nga vëzhgimet në hartën e mendimeve, në tabelë.

**Hapi 2**

Formojmë 4 grupe me nxënës/e dhe brenda çdo grupi nxënësit/et numërojnë nga 1-4. Çdo nxënësi/e brenda grupit i shpërndahet nga një fletë eksperti/eje, ku janë të shënuara nga 3 pyetje rreth njësisë mësimore. Fletat kanë lloje të ndryshme pyetjesh.

Fletë eksperti 1: Si kthehet liqeni në kënetë? Si rezultat i kujt transformohen liqenet? Ç'rëndësi paraqesin bakteret në rrënjët e bimëve bishtajore?

Fletë eksperti 2: Si kthehet zona shkëmbore në pyll? Çfarë e ndihmon kthimin e kënetës në livadh? Pse bimët bishtajore e pasurojnë tokën me kripëra minerale?

Fletë eksperti 3: Cili është kontributi i likeneve në kthimin e zonës shkëmbore në pyll? Si mund të formohet pylli në zona moçalore? Cili është roli i bimëve bishtajore?

Fletë eksperti 4: Shpjego kthimin e tokës shkëmbore në atë të butë. Çfarë shembulli paraqet liqeni i Prespës? Pse toka para se të mbillet me drithëra, duhet të mbillet me bimë bishtajore?

Nxënësit/et lexojnë tërë materialin mësimor duke pasur parasysh gjetjen e përgjigjeve në pyetjet e fletës së ekspertit.

Pasi t'u përgjigjen pyetjeve, secili nxënësi shkon në grupin e caktuar të ekspertëve (të gjithë 1-shat në një bankë; të gjithë 2-shat në një vend tjetër e kështu me radhë). Aty sqarohen përgjigjet në pyetjet e fletës së caktuar të ekspertit dhe vendosin mënyrën e paraqitjes së përgjigjeve në grupin bazë.

Pas 5-7 minutash kthehen në grupet bazë dhe u sqarojnë nxënësve të tjerë përgjigjet e fletës së tyre. Po ashtu, nëse ka nevojë, përgjigjen në pyetjet shitesë të parashtruar nga nxënësit/et e tjerë.

Hapi 3

Me anë të organizuesve grafik, nxënësit/et individualisht, paraqesin kthimin e mjediseve shkëmbore në pyll, liqenit në kënetë, kënetës në livadh. Dy-tre nxënës prezantojnë para klasës punimet e tyre.

Hapi 1

Mësuesi/ja ka përgatitur një tretësirë 30 ml alkool dhe 15 ml ujë si dhe sjell likenet e marra nga lëvorja e drurit apo murit. Të njoftuar më herët, nxënësit/et sjellin me vete 2 enët me ujë dhe lupë. Nxënësit/et ndahen në 6 grupe.

Grupi 1-2 (aktivitetin 1) Vëzhgoni parazitët në dru në oborrin e shkollës ose rrotull tij. Nxënësit/et në një enë vendosin nga një lugë përzierje që ka sjellë mësuesi/ja dhe disa parazitë të marrë nga dega e pemës që vëzhguan. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të tregojnë çfarë vërejnë, si dhe të mbajnë shënime.

Grupi 3-4 (aktivitetin 2) Të gjejnë në oborrin e shkollës një vend ku ka milingona dhe të vëzhgojnë me lupë organizimin e tyre. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të mbajnë shënime.

Grupi 5-6 (aktivitetin 3) duhet të gjejnë likenet në lëvoren e drurit (nëse nuk gjejnë të tilla, mësuesi/ja duhet t'i ketë përgatitur më parë). Nxënësit/et duhet të vëzhgojnë dhe të mbajnë shënime mbi ndryshimet që ndodhin. Aktivitetet 1, 2, 3 do të kryhen nga të gjitha grupet.

Hapi 2

Pasi nxënësit/et kanë mbledhur material dhe kanë mbajtur shënime kthehen në klasë dhe në grupet e tyre përmbledhin përfundimet që nxorën.

Hapi 3

Përfaqësuesit e grupeve të zgjedhur nga nxënësit/et e grupit paraqesin përfundimet e grupit të tyre. Arsimtari/ja hap një diskutim rreth rezultateve të dala nga terreni dhe i shënon këto rezultate në tabelë. Mësuesi/ja jep sqarime shtesë sipas nevojës, kurse grupet vlerësojnë punën e tyre me anë të teknikës “dy yje dhe një dëshirë”.

Aktivitetet	Rezultatet përfundimtare
Aktiviteti 1	Ndërveprimi i bimës (drurit) me mikroorganizmat
Aktiviteti 2	Ndërveprimi mes organizmave të njëjtë dhe organizimi i tyre
Aktiviteti 3	Ndërveprimi i dy gjallesave duke iu përshtatur njëra-tjetrës

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë bashkëpunimin dhe rezultatet përfundimtare të dala nga aktivitetet. Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin e nxënësve, mënyrën e vëzhgimit, angazhimin e tyre lidhur me përmbledhjen e rezultateve përfundimtare.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të përfundojnë hulumtimin e aktivitetit 3: Të vëzhgojnë ndryshimet që do të ndodhin pas derdhjes së ujit pas dy ditësh.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan se si përshtatjet shërbejnë për të mundësuar mbijetesën dhe ato mund të jenë strukturale dhe të bazuara në sjellje; sigurimi i ushqimit, strehimi, ikja nga grabitqari, riprodhimi duke gjetur ose tërhequr partnerin ose shpërndarja e farave/fryteve.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; II. 6; III. 3; III. 5; III.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Përshtatshmëria e gjallesave			
Fjalët kyçe: habitat, veçori përshtatëse (disa shtazë, bimë)			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - gjen me çfarë duhet të përshtaten organizmat shtazorë dhe bimorë jetësorë në habitat; - përmbledh informatat e materialit sipas një vije logjike mbi veçoritë e përshtatjes të organizmave të ndryshëm në habitatet e tyre jetësore; - konstaton cilat veçori mundësojnë përshtatjen e shtazës ose bimës që t'i zgjodhe duke e ndihmuar atë për të mbijetuar në mjedisin e saj të veçantë. Kriteret e suksesit: Shqyrto pse peshku nuk mund të jetojë në tokë; krimbat e tokës në pemë dhe gjirafa në Artik. Shëno disa veçori të përshtatjes së organizmave të ndryshëm, si p.sh., peshkut, dhelprës të llojit “Fenek” dhe kaktusit në habitatet e tyre jetësore. Vendos etiketat (shkrimin) për të shpjeguar në vizatimin tënd disa veçori të kafshës apo bimës që e ndihmojnë atë për të mbijetuar në mjedisin e saj të veçantë.			
Burimet: Teksti i nxënësit			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletat A4			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhën shqipe, Arte			
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja shënon tri fjalitë në tabelë:

- Peshqit jetojnë në ujë, por nuk mund të jetojnë në tokë.
- Krimbat e tokës jetojnë nën dhe, por nuk mund të jetojnë në pemë.
- Gjirafat jetojnë në savane afrikane, por nuk mund të jetojnë në Arktik.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të punojnë në mënyrë individuale për të dhënë përgjigje pyetjeve:

- Cila është vetia e përbashkët e paraqitur në këto tri fjali? Çfarë duhet të kenë këta tre organizma për të jetuar në mjediset e përmendura? Pse këta organizma nuk mund të jetojnë në ambientet e tjera?

Pasi nxënësit/et shkruajnë përgjigjet e tyre, i shkëmbejnë ato me shokun/qen e bankës. Ata lexojnë përgjigjet e njëri-tjetrit dhe hartojnë së bashku një përgjigje të re.

Mësuesi/ja dëgjon leximin e disa përgjigjeve, sipas nevojës ato plotësohen dhe diskutohen.

Hapi 2

Nxënësit/et lexojnë materialin (mësimin) dhe detyra e tyre është të përmbledhin atë në disa fjali. Diskutohet me anëtarin e dyshes dhe materiali (fjalitë) e dy anëtarëve do të shkrihen (shënohen) si një.

Mësuesi/ja kërkon disa dyshe vullnetare të lexojnë detyrën përfundimtare. Mësuesi/ja dëgjon leximin e disa detyrave përfundimtare dhe ato plotësohen sipas nevojës.

Hapi 3

Mësuesi/ja shpërndan fletat A4. Nxënësit/et duhet të zgjedhin një kafshë apo bimë, ta vizatojnë atë dhe të përdorin etiketat (shkrimin) për të shpjeguar disa veçori të kafshës apo bimës që e ndihmon për të mbijetuar në mjedisin e saj të veçantë.

Disa nxënës vullnetar paraqesin punimet e tyre, mësuesi/ja i plotëson sipas nevojës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin sipas bashkëpunimit dhe për shpjegimin e dhënë.

Mësuesi/ja vlerëson njohuritë e nxënësve, zgjedhjen e informacionit, tolerancës (shkrimi përfundimtar), shpjegimin për kafshën apo bimën e zgjedhur.


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Si është përshtatur shqiponja për të jetuar dhe gjuajtur në ajër?

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Përdor fjalor të duhur shkencor dhe teknologjik gjatë komunikimit gojor ose me shkrim duke përfshirë: klasifikimi, biodiversiteti, bashkësia jetësore natyrore (biocenoza), marrëdhëniet e ndërsjella, vertebrorët-kurrizorët, invertebrorët, parruazorët, stabiliteti, karakteristikat, organizmi etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.4; I. 6; II. 6; II. 7; III. 5.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Përshtatshmëria e gjallesave (vazhdim)			
Fjalët kyçe: faktorët abiotikë, biotikë, përshtatshmëria e bimëve dhe shtazëve.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e gjallesave në natyrë; - veçon disa nga gjallesat që kanë përshtatshmëri të jetojnë në tokë, ambiente ujore; - ndani pjesët më të rëndësishme për gjallesat që kanë përshtatshmëri të jetojnë në ambiente të ndryshme natyrore.			
Kriteret e suksesit: Dallo ndikimin e dy faktorëve abiotikë dhe biotikë që ndikojnë në shpërndarjen e gjallesave në natyrë. Radhit së paku 2-3 veti të përshtatshmëri që kanë gjallesat të jetojnë në tokë, ambiente ujore. Komento pjesët e veçuara lidhur me përshtatshmëri e gjallesave në ambiente të ndryshme natyrore.			
Burimet: Teksti i nxënësit			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletat A4			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Gjeografi			
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1: Parashtrohet pyetja para nxënësve: Si mendoni, cilët faktorë ndikojnë në shpërndarjen e gjallesave në natyrë?

Informacionet e nxënësve, mësuesi/ja i shënon në tabelë dhe kërkon t'i kategorizojnë në rrethin përkatës:



Hapi 2

Kërkojmë nga nxënësit/et që në fletore të tyre të formojnë një tabelë me dy shtylla. Në anën e majtë të tabelës, shënojmë pyetjet rreth mësimit, kurse në të djathtë do të shënojnë përgjigjet pasi të lexojnë mësimin. Njëkohësisht dhe arsimtari/ja i shënon këto pyetje në tabelë.

Nxënësit/et lexojnë mësimin duke pasur parasysh pyetjet dhe gjetjen e përgjigjeve në to.

Pyetje	Përgjigje
• Çfarë iu siguron toka gjallesave? • Me çfarë janë pajisur bimët që jetojnë në tokë, po kaktuset në shkretëtirë? • Pse antilopa jeton në mjedise me klimë të ftohtë? • Çfarë iu siguron ambienti ujor-gjallesave ujore? Shpjego përmes përshtatshmërisë së peshkut!	

Kërkojmë nga një nxënës (vullnetarisht) që të lexojë përgjigjen në pyetjen e parë, rreth mundësive që iu ofron toka bimëve. Pasi përgjigjet, të tjerët e plotësojnë dhe në fund, mësuesi/ja jep sqarime shtesë sipas nevojës. Pason përgjigja rreth pyetjes së dytë, nga një nxënës tjetër. Ndiqet e njëjta procedurë edhe për pyetjen e tretë dhe të katërt. Këto përgjigje paraqiten në tabelë para klasës.

Hapi 3

Kërkohet nga nxënësit/et të ndahen në dyshe, të shkruajnë një poemth me pesë vargje për temën:

Përshtatshmëria e gjallesave për jetesë.

Secili nxënës në dyshe shkëmben fletoren lexojnë pesëvargëshat e njëri-tjetrit dhe vendosin cilin pesëvargësh do të prezantojnë.

Mësuesi/ja dëgjon dhe ndërhyr për përmirësime sipas rastit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë dhënies së përgjigjeve, prezantimit të tyre dhe bashkëpunimit në dyshe.

Mësuesi/ja vlerëson njohuritë, përgjigjet e dhëna dhe shkrimit të pesëvargëshit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Si është përshtatur lejleku për jetën tokë-ujë-ajër?

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Biodiversiteti		Rezultati i të nxënit të temës: Shfrytëzon organizues grafik për të treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; I. 4; I. 6; II. 6; III. 5			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Gjallesat dhe mjediset natyrore. Veçoritë e ekosistemeve			
Fjalët kyçe: gjallesë, popullatë, bashkësi biologjike, biocenoze, biotop ekosistem, faktorët fizikë, faktorët kimikë, cilësitë e tokës, cilësitë e ujit.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - shkallëzon ndërtuesit e biocenzës në formimin e një zinxhiri të tij; - identifikon cilët faktorë ndikojnë në përcaktimin e cilësisë së një biotopi, dhe disa veçori të ekosistemit; - ilustroni një ekosistem duke ju përmbajtur kritereve të dhëna.			
Kriteret e suksesit: Radhit ndërtuesit e një biocenoze nga pjesa më e vogël te biocenoza. Veço faktorët që ndikojnë në cilësinë e një biotopi si dhe disa veçori të ekosistemit. Vizato një ekosistem me tri bimë dhe tri shtazë nën ndikimin e tre faktorëve fizikë dhe kimikë.			
Burimet: Teksti i nxënësit			
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografitë e gjallesave të njëjta, popullatës, bashkësive biologjike, biotopit, ekosistemit, fishat me pyetje (1, 2).			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Gjeografi, Fizikë, Kimi Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të shënojnë në fletoret e tyre një zinxhir të formimit të biocenzës, duke pasur parasysh fotografitë e prezantuara: Gjallesat → Popullata → Bashkësi biologjike → Biocenoza Jetojnë të paizoluara bashkësi individësh të njëjtë popullatat e ndryshme jetojnë në një vend gjithçka që jeton.			

Këto të dhëna i shënon edhe mësuesi/ja në tabelë dhe rikujton nocionet:

- Cilat gjallesa organizohen në popullata?
- Cilat popullata formojnë bashkësi biologjike?
- A lidhen gjithnjë dy bashkësi biologjike për të krijuar biocenozën? Mësuesi/ja shënon të dhënat në tabelë në formë të barazimeve matematikore:

Gjallesë + gjallesë e njëjtë = Popullatë
 Popullatë + popullatë e ndryshme = Bashkësi biologjike
 bashkësi biologjike tjetër = Biocenozë

Tani, mësuesi/ja me të njëjtën gjuhë kërkon zgjidhjen e barazimit:

Biocenoza + (kjo mbetet e zbrazët në fillim) = Ekosistem

Pas përgjigjeve të nxënësve plotësohet:

Biocenoza + Biotopi = Ekosistem

Hapi 2

Nxënësit/et ndahen në dyshe me numrat 1 dhe 2, dhe mësuesi/ja çdo dysheje iu shpërndan fishat me pyetjet, përgjigjet e të cilave i gjen gjatë leximit të materialit në tekstin e nxënësit/et dhe cakton kohën e duhur për kryerjen e këtij hapi (10 minuta).

Pyetjet e fishës 1

- Cilët faktorë përcaktojnë cilësitë e një biotopi?
- Tregoni disa faktorë fizikë dhe kimikë duke i veçuar ato.
- Si mendoni ju, cilat cilësi përcaktojnë llojin e bimëve dhe kafshëve në biotop dhe shpërndarjen e tyre?
- Si quhet shkenca që studion ekosistemet?

Pyetjet e fishës 2

- Arsyeja pse themi që ekosistemet janë të shumëllojshme.
- Tregoni disa veçori të ekosistemeve.
- Sqaroni përmes shembujve që ekosistemet nuk janë të mbyllura.
- Si janë të lidhura gjallesat në ekosistem, si ndryshon ekosistemi?

Nxënësit/et përgjigjen për pyetjet përkatëse.

Në fund, mësuesi/ja bën një përmbledhje mbi faktorët dhe veçoritë e ekosistemit.

Hapi 3

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et:

Vizatoni një ekosistem, emërton tri bimët, tri kafshë, tre faktorë fizikë dhe tre faktorë kimikë që ndikojnë në të. Në fund, nxënësit/et vlerësojnë veten me anë të fytyrës.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin për bashkëpunim dhe përgjigje, dhe vlerësojnë vizatimin. Mësuesi/ja vlerëson radhitjen e zinxhirit të biocenozës, zgjidhjen e ekuacioneve, bashkëpunimit të tyre në dyshe dhe vizatimit të ekosistemit sipas kërkesave dhe vetvlerësimit të tyre.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Jepni tre shembuj ekosistemesh me përmasa të ndryshme.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan shndërrimin e energjisë së dritës në energji kimike gjatë krijimit të lëndëve ushqyese në shembullin e fotosintezës duke mos u shërbyer me simbole kimike në pasqyrimin e ekuacionit të fotosintezë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2; II. 4; III. 3; III. 8.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Funksioni i ekosistemit. Klasifikimi i gjallesave sipas vendit që zënë në zinxhirin ushqimor			
Fjalët kyçe: habitat, fotosinteza, nivel trofikë, prodhues, konsumator niveli I, konsumator niveli II, konsumator niveli III, dekompozuesit.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - lidh fjalët në fjali për të treguar përse formohen zinxhirët ushqimorë; - plotëson tabelën duke renditur informatat nga teksti lidhur me ndarjen e gjallesave sipas vendit që zënë në zinxhirin ushqimor; - radhit saktë gjallesat sipas niveleve trofike që ato iu përkasin në trenin e formuar. Kriteret e suksesit: Radhit saktë fjalët në fjali duke evidentuar arsyen e formimit të zinxhirët ushqimorë. Radhit informatat në shtyllat përkatëse të tabelës duke i treguar përfundimet që dalin nga kjo radhitje. Rendit gjallesat në nivelet trofike prodhues, konsumatori I, konsumatori II, e kështu me radhë.			
Burimet: Teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: etiketat me fjalë për ndërtimin e fjalisë, etiketat me gjallesa			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuha shqipe, njeriu dhe natyra Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Mësuesi/ja shtron pyetjen: A ka gjallesa që e prodhojnë vetë ushqimin? Pas përgjigjes, mësuesi/ja vendos në tabelë disa etiketa:



Nxënësit/et duhet të formulojnë këtë fjali: Çdo gjallesë ushqehet me një gjallesë tjetër dhe formojnë zinxhirët ushqimorë.

Mësuesi/ja shtron pyetjen: Si mendoni ju, a kanë gjallesat një vend të caktuar në zinxhirët ushqimorë? Pas përgjigjeve të dhëna arrijmë në përfundim se vendi se ku vendosen gjallesat quhet nivel trofik.

Hapi 2

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të lexojnë materialin në faqet 68-69 duke vendosur këto shenja (–, +, ?) pas fjalisë së lexuar dhe vizaton tabelën.

(inf. e njohur) – inf. e plotësuar + (inf. e mësuar) ? (inf. e paqartë) Buzë liqenit zhvillohen bimë barishtore shkurre.

✓ (inf. e njohur)	– (inf. e plotësuar)	+ (inf. e mësuar)	? (inf. e paqartë)
Buzë liqenit zhvillohen bimë barishtore shkurre. oksigen ofron çdo bime kushtet e nevojshme: ujë + kripëra minerale + dioksidin e karbonit të marr nga ajri + energjinë nga rrezet diellore kryhet procesi i fotosintezës	Reaksioni i fotosintezës: Dioksid karboni + uji + drita shqer + oksigjen Habitati i Ne jemi konsumatorët e rendit të pestë se ushqehemi me barishte, peshq, mish, shpendë etj.	Bimët janë niveli i parë trofikë të zinxhirit ushqimorë dhe prodhuesit. Substancat që ajo prodhon iu shërbejnë gjallesave të tjera për ushqim. Kafshët e liqenit ushqehen me bimë dhe quhen konsumatorët e rendit të parë, ose bimëngrënësit	Në cilin nivel trofik vendosen bakteret, kërpudhat, myket? A zbërthejnë ato vetëm materien e vdekur apo edhe të gjallë?

Nxënësit/et krahasojnë njohuritë e mëparshme me ato të reja. Mësuesi/ja iu përgjigjet pyetjes:

*Bakteret, kërpudhat dhe myket i përkasin dekompozuesve, janë zbërthyesit të materies pa jetë në ekosistem.

*Ato zbërthejnë vetëm materien e vdekur pa jetë.

Hapi 3

Mësuesi/ja shkruan në fletat emrat e disa gjallesave si: bimë, peshk, krimba, peshq të vegjël, shkurre, shpendët, njeriu etj. Nxënësit/et i përzgjedhin ato në mënyrë të rastësishme. Ata duhet të radhitën si vagonët e trenit sipas niveleve trofike (dhe cila gjallesë ushqehet me cilën gjallesë).

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njeri-tjetrin për radhitjen e etiketave, plotësimin e tabelës, radhitjen dhe komentimin e pozicionit në lojë.

Mësuesi/ja vlerëson shpejtësinë dhe saktësinë e formulimit të fjalisë, vendosjes së informatave në shtyllat përkatëse në tabelë, si dhe pozicionimi i saktë i tyre te treni i dijes, dhe arsyetimi i pozicionit (nivelet trofike).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxirr nga interneti materiale për kënetën e Kurjanit apo lagunën e Karavastasë. Tregoni si lidhen gjallesat prodhuese me konsumatorët dhe dekompozitorët. Bëni një skemë të renditjes së tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan shndërrimin e energjisë gjatë zbërthimit të lëndëve ushqyese në shembullin e zinxhirit të ushqimit, duke shpjeguar nocionet prodhuesit dhe konsumuesit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 4; I. 6; II. 6; III. 5.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Zinxhirët ushqimorë. Rrjetat ushqimore			
Fjalët kyçe: zinxhirët ushqimorë, rrjetat ushqimore, prodhuesit, konsumatorët 1, 2, 3, .., dekompozuesit.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - emërton gjallesat sipas grupeve të nivelit trofikë që i përkasin; - krahason gjallesat e zinxhirit ushqimor në rrjetat ushqimore që i krijuan vetë; - kombinon gjallesat e paraqitura dhe specifiko marrëdhëniet e ndryshme ushqimore. Kriteret e suksesit: Rendit gjallesat në prodhues, konsumator i rendit 1, 2, 3, 4, 5. Krijo zinxhirët ushqimorë që ndërthuren mes tyre. Lidh së paku dy gjallesat e paraqitura me anë të shigjetave dhe specifiko marrëdhëniet e ndryshme ushqimore.			
Burimet: Teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografitë e bimës, mizës, bretkosës, gjarprit, dekompozuesit, fletat A4 me disa zinxhirë ushqimorë që paraqesin rrjetat ushqimore.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Gjeografi
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja përgatit disa fotografi të gjallesave të ndryshme si p.sh.: bimë, miza, bretkosa, gjarpri, dekompozuesit.



Kërkohet nga nxënësit/et të lidhin me shigjeta nga prodhuesit e gjerë te konsumatorët: 1, 2, 3 dhe dekompozuesit. Mësuesi/ja shtron pyetjen:


- Po t'i vendosnim këto gjallesa në hallka çfarë do të fitonim? (zinxhir)
- Me sa hallka është zinxhiri ushqimor i paraqitur para jush? (5)
- A janë këto hallka të njëjta? Pse? (Jo, janë të niveleve të ndryshme trofike.)

Hapi 2

Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në grupe dhe u shpërndan fletat A4, ku vendos fotografimin e rrjeteve ushqimore dhe kërkon nga nxënësit/et të formojnë zinxhirët ushqimorë, duke i shënuar ato në fletore. Pasi nxënësit/et kanë shënuar së paku 2 zinxhirë ushqimorë, mësuesi/ja kërkon të nxjerrin përfundimet. Në fund, mësuesi/ja sqaron se gërshetimi apo ndërthurja e dy a më shumë zinxhirëve ushqimorë çon në formimin e rrjetave ushqimore. Një gjallesë mund të paraqitet në një zinxhirë si konsumatori 1, por edhe në një tjetër si konsumatori 2 (p.sh., miu mundet të paraqitet edhe si bimëngrënës në një zinxhir ushqimorë edhe si konsumator 2 pasi ushqehet edhe me insekte kërmij e krimba).

Hapi 3

Vizatoni shigjeta në rrjetën ushqimore të mëposhtme për të treguar marrëdhëniet e ndryshme ushqimore.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin për përgjigjet, komentet dhe vizatimet e zinxhirëve ushqimorë. Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et për saktësinë e klasifikimin e gjallesave në nivelet trofike, lidhjen e tyre në zinxhirët ushqimorë dhe rrjetat ushqimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetjet dhe detyrat në faqen 71.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VI	
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor	Rezultati i të nxënit të temës: Gjurmon rrugën e energjisë prej Diellit nëpër qeniet e gjalla dhe identifikon rolet e organizmave të ndryshëm (prodhuesve, konsumuesve, grabitqarëve, presë) në zinxhirin e ushqimit dhe në rrjetën e ushqimit.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës: I.2; I.4; II.6; III.3; III.8;	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmëria e ekosistemeve, ndërtimi dhe funksioni e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 2.13 Rrjedhja e energjisë në ekosistem	
Fjalët kyçe: Energjia, energjia diellore, energjia kimike, piramidat e energjisë	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: 1. Tregon sa është e nevojshme energjia për gjallesat, si sigurohet dhe shndërrohet prej një lloji në tjetrin. 2. Konstaton se energjia zvogëlohet prej prodhuesit tek konsumatorin në çdo hallkë humb energji. 3. Llogarit sa ushqim i nevojitet konsumatorit 2 të ushqehet me konsumatorin 1 me anë të tabelës numerike.	
Kriteret e suksesit: 1. Sqaro pse energjia është e nevojshme për prodhuesit dhe konsumatorit 1,2... si dhe shndërrimin e saj nga një lloj në tjetrin. 2. Llogarit se vetëm 10 % i sasisë së energjisë kalon nga një hallkë më e ulët në një tjetër më të lartë. 3. Njehso sa luan do të ushqehen me 35 gjirafa duke argumentuar zgjidhjen me shkrim.	
Burimet: Teksti i nxënësit/es	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Piramida numerike, fletat A4	
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë shqipe, fizikë, matematikë	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	

Hapi 1. Arsimtari/ja shtron pyetjet:

-A kanë nevojë gjallesat barngrënëse dhe mishngrënëse për energji?

-Nga furnizohet ekosistemi me energji?

-Ç'mendoni ju, si e shëndërrojnë bimët këtë energji diellore në energji kimike?

Nxënësit/et përgjigjen në pyetjet dhe arsimtarja drejton nxënësit/et për të marrë përgjigjet e duhura si:

-Gjallesat kanë nevojë për energji për të kryer veprimet jetësore.

-Ekosistemi me energji furnizohet nga dielli.

-Bimët, përmes procesit të fotosintezës, e shëndërrojnë energjinë diellore në energji kimike (energji që ndodhen brenda substancave që prodhohen nga bimët)

Hapi 2.

Arsimtari/ja ndan nxënësit në grupe dhe sqaron se energjia e një zingjiri ushqimor vjen duke u zvogëluar nga prodhuesit te konsumatori d.m.th.çdo hallkë humbet energji dhe vetëm 10 % kalon nga një hallkë në e ulët në një hallkë më të lartë.

Arsimtari/ja u shpërndan fletat A4 me figurën dhe kërkon nga ata të

-Sheno prodhuesit, konsumatorët 1,2

-Tregoni sa bimë e shtazë nevojiten për të ushqyer çdo nivel të saj.

-Në cilën hallkë është energjia më e ulët dhe më e lartë.

-Duke u bazuar në të dhënë se çdo hallkë humbet energji dhe vetëm 10 % kalon nga një hallkë në e ulët në një hallkë më të lartë. Llogarit sa xhaul do të kanë prodhuesit, sa konsumatorët e rendit 1, sa konsumatorët e rendit 2, nëse themi se ekosistemi merr nga dielli 100.000 J.



Pas plotësimit të fletave, arsimtari/ja bën një përmbledhje ku tregon se energjia rrjedh vetëm në një drejtim: Dielli----->Prodhuesit (bimët) -----> Konsumatorët (kafshët)----->dekompozuesit

Hapi 3. Në bazë të tabelës të paraqitur(tabelës numerike), llogaritni sa luan ushqehen me 35 gjirafa (Nëse 1 luan ushqehet me 7 gjirafa atëherë 35 gjirafa ushqejnë 7 luanë.)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë komenteve, plotësimit të tabelës, dhe llogaritjes.

Arsimtari/ja vlerëson bashkëbisedimet, përgjigjeve, llogaritjes dhe emërimit të gjallesave sipas niveleve trofike.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetja 6,7 në faqe 73.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 4; II. 4; III. 3; III. 7; III. 8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Punë praktike Dheu, ekosistem natyror dhe shumëllojshmëri gjallesash			
Fjalët kyçe: Punë praktike: vëzhgimi dheut, ndërtim të terreneve për vëzhgim.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - vrojton dheun me anë të mjeteve zmadhuese dhe pa mjete zmadhuese duke nxjerr përfundime se a përmban dheu gjallesa; - analizon dheun në përzierje të alkoolit dhe e tregon 6 këndvështrime të ndryshme; - krijon terrene për vëzhgimin e gjallesave të dheut.			
Kriteret e suksesit: Vepro duke e vërtetuar dheun me dhe pa mjete zmadhuese. Arsyeto rezultatet e dala nga, përshkrimi, shoqërimi, krahasimi, analiza, zbatimi, argumentimi, i përzierjes të alkoolit dhe dheut. Ndërto terrenet sipas udhëzimit të dhënë për vëzhgimin e krimbave e dheut, hardhucat, milingonat, bretkosën.			
Burimet: Teksti i nxënësit, natyra (merret dheu) Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Xham zmadhues (lupë), kovë me dhe, mikroskop, xham special, xham mbulues, gotë me ujë e gurë, alkool 180 ml, 6 gota, 2 enë plastike, kuti kartoni, 2 kuti plastike, enë transparente plastike dhe gurë rëre, copa druri, fishat me detyrat për vëzhgimin e aktivitetit 1, fishat me udhëzime për ndërtimin e terreneve dhe detyra për vëzhgim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjeografi, Matematika, Gjuhë shqipe, Kimi Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi i qëndrueshëm për zhvillim			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja përgatit një kovë të mbushur me dhe nga kopshti/oborri i shkollës dhe ndan nxënësit/et në grupe. Çdo grupi i shpërndan fishat me pyetje.			

Grupi 1 – Vrojtto dheun me sy të lirë, shëno çfarë vrojttove.
 Grupi 2 – Vrojtto dheun me xham zmadhues (lupë), shëno çfarë vrojttove. Grupi 3 – Pasi vrojttove dheun me sy të lirë, trego çfarë përfundimesh nxore.
 Grup 4 – Pasi vrojttove dheun me xham zmadhues (lupë), trego çfarë përfundime nxore. Grup 5 – Arsyeto përfundimet e nxjerra nga vrojtimi me sy të lirë.
 Grup 6 – Arsyeto përfundimet e nxjerra nga vrojtimi me xham zmadhues (lupë).
 Nxënësit/et lexojnë përfundimet e tyre të dala nga puna grupore. Mësuesi/ja ndërhyt me raste.

Hapi 2

Mësuesi/ja krijon grupet e reja dhe iu ndan detyrën sipas nivelit të nxënësve. Mësuesi/ja hedh 30 ml alkool në një gotë dhe kërkon nga nxënësit/et të vendosin një sasi të vogël dheu. Çdo grupi i caktohet detyra:
 Grupi 1- Përshkruajnë përzierjen për nga ngjyra, si duket për nga kthjelltësia etj. Grupi 2- Duhet të krahasojnë përzierjen me përzierjen e ujit dhe gurëve.
 Grupi 3- Duhet të shënojnë se me cilat përzierje të tjera ngjason.
 Grupi 4- Duhet të analizojnë përzierje me anë të mikroskopit dhe të tregojnë a ka gjallesa. Grupi 5- Duhet të shënojnë si mundemi ta përdorim këtë lloj përzierjeje.

Nxënësit zgjedhin në grupe nxënësin/en, i cili prezanton rezultatet e dala nga puna e tyre grupore. Pasi nxënësit/et prezantojnë punën e tyre, mësuesi/ja paraqet një përmbledhje duke sqaruar se dheu përmban shumë baktere të llojeve të ndryshme, diku rreth 4000 lloje:

- 19000 lloje të njëqelizorëve të ndryshëm;
- 5000 lloje të krimbave të ndryshëm;
- merimanga, miza, kërpudha, minj, urith etj..

Rol të rëndësishëm për shkriftimin e pasurimin e tokës luan krimbi i shiut.

Numri i gjallesave zvogëlohet me rritjen e thellësisë, sepse ka mungesë të oksigjenit, pakësohen lëndët ushqyese dhe bien temperaturat.

Grupi 6- A mendoni që kjo përzierje është e dobishme apo e dëmshme?

Hapi 3

Mësuesi/ja sjell materialin e nevojshëm për ndërtimin e terreneve për vëzhgimin e gjallesave të dheut. Mësuesi/ja shpërndan fshat me udhëzime për ndërtim. Kërkon nga nxënësit/et të fillojnë përgatitjen e terreneve për gjallesat e dheut dhe të kryejnë vëzhgimet dhe shënojnë në fletore.

Grupi 1 dhe 2 – Në një enë plastike ndërtoni një terren për vëzhgimin e krimbave të shiut. Grupi 3 – Në një kuti kartoni ndërtoni terren për vëzhgimin e hardhucës.

Grupi 4 e 5 – Në një kuti plastike ndërtoni terrenin për vëzhgimin e milingonave. Grupi 6 – Në një enë transparente plastike apo enë qelqi.

Pas përfundimit, nxënësit/et prezantojnë punën e bërë dhe lexohen shënimet të dala nga vëzhgimet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë punën e njërit-tjetrit në grupe dhe konstatimet e tyre.

Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin e tyre në grupe, saktësinë e rezultateve të prezantuara të grupeve si dhe saktësinë e ndërtimit të terreneve për vëzhgim, përfundimet e nxjerra nga këto vëzhgime.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të vazhdohet të vëzhgohen gjallesat në terrenet e punuara (kini kujdes ushqimin për gjallesat).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (nevoja e bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, nevoja e shtazëve për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim. Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella brenda species (p.sh. ujëqit udhëtojnë në grup për të mbrojtur territorin e tyre, rrisin të vegjëlit (këlyshët) e tyre dhe gjuajnë prenjë e madhe). Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet specieve të ndryshme duke mos përdorur emërtime shkencore për këto marrëdhënie vetëm duke pasur parasysh dobinë ose dëmin nga bashkëjetesa e tyre dhe shpjegojnë se si këto marrëdhënie mbështesin qëndrueshmërinë e biodiversitetit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; I. 6; II. 5; III. 3; III. 8.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Marrëdhëniet midis gjallesave			
Fjalët kyçe: marrëdhëniet midis gjallesave, konkurrenca, gjuetia			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - dallon marrëdhëniet midis gjallesave përmes videos; - prezanton rezultatet e nxjerra nga video e prezantuar; - diskuton rreth konkurrencës së bimëve barishtore dhe drunore.			
Kriteret e suksesit: Veço 2 llojet e marrëdhënies midis gjallesave. Paraqit rezultatet me anë të përshkrimit, shoqërimit dhe analizës të videos së prezantuar. Nxirr përfundime lidhur me konkurrencën për nga forma, madhësia dhe nevoja për energji.			
Burimet: teksti i nxënësit, interneti Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kompjuteri, projektori, CD me material nga interneti.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, TIK, Gjeografi

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, Edukim për media

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja përgatit një CD ku prezantohet marrëdhëniet midis gjallesave (konkurrenca dhe gjuetia pra vërehet gjahu dhe preja). Ky material paraqitet para nxënësve dhe kërkohet gjatë shikimit të videos, të nxjerrin përfundimet në mënyrë të strukturuar.

Hapi 2

Nxënësit/et ndahen në grupe (1, 2, 3 dhe grupet 4, 5, 6) dhe secili grup (1-4; 2-5; 3-6) do të kenë të njëjtat detyrat:

Grupi 1-4 Do të **përkrahin** llojet e marrëdhënieve midis gjallesave të njëjta dhe të ndryshme. Të vëzhguara nga materiali i prezantuar.

Grupi 2-5 Do të **shoqërojnë** me pyetjet lidhur me marrëdhëniet midis gjallesave të njëjta dhe të ndryshme. Çfarë ju bën të mendoni? Çfarë ju vjen në mendje?

Grupi 3-6 Do të **analizojnë** si ndërtohen apo dallohen këto marrëdhënie midis tyre (bashkësia biologjike, konkurrencës, gjuetia).

Nxënësit/et prezantojnë detyrën e dhënë ku grupet me detyrë të njëjtë plotësojnë njëri-tjetrin. Mësuesi/ja shënon në mënyrë të strukturuar përfundimin e detyrës.

- Bashkësia biologjike është kur dy gjallesa ndërveprojnë me njëra-tjetrën duke u përshtatur midis tyre.
- Konkurrenca është gara e një bashkësie biologjike për ushqim, territor, lufta e dy meshkujve për të njëjtën femër, bimëve për dritë etj.
- Gjuetia është proces kur një gjallesë vret një gjallesë tjetër (gjahtari-preja). Nëse gjahu rritet në numër ekuilibri në ekosistem prishet.

Hapi 3

Mësuesi/ja hap diskutimin rreth pyetjes:

A ka konkurrencë midis bimëve drunore dhe atyre barishtore për nga forma, madhësia dhe nevoja për energji?

Nxënësit/et diskutojnë dhe paraqesin mendimet e tyre. Mësuesi/ja konkludon nga ana shkencore përgjigjen përfundimtare.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë bashkëpunimit në grup, prezantimit dhe diskutimit.

Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin në grup gjatë detyrës së kërkuar, prezantimit dhe konkludimit të rezultateve, diskutimit dhe saktësisë së përgjigjeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Tregoni se ç'ndodhi në shembullin e dhënë në Australi në tekst. Nxirr përfundime!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim). Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet specieve të ndryshme duke mos përdorur emërtime shkencore për këto marrëdhënie vetëm duke pasur parasysh dobinë ose dëmin nga bashkëjetesa e tyre dhe shpjegojnë se si këto marrëdhënie mbështesin qëndrueshmërinë e biodiversitetit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2; II. 5; II.7; III. 3; III. 8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Format të tjera të marrëdhënieve midis gjallesave. Simbioza			
Fjalët kyçe: simbioza, parazitizmi, komensalizmi, mutualizmi, jeta në koloni e shoqëri.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore			
Nxënësi/ja: - tregon a janë të njëjta forma të jetesës së dy gjallesave që jetojnë të lidhura ngushtë për një kohë të gjatë; - krahason njohuritë e fituara dhe ato ekzistuese për format e ndryshme të simbiozës; - diskuton duke i dalluar format e ndryshme të simbiozës me anë të shembujve. Kriteret e suksesit: Emërto disa forma të ndryshme të simbiozës. Veço informatat e reja lidhur me parazitizmin, komensalizmin, mutualizmin, jetën në koloni e shoqëri. Identifiko së paku 2 forma të ndryshme të simbiozës duke i dalluar ato.			
Burimet: teksti i nxënësit, interneti Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotot, CD materiali nga interneti.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, TIK Çështjet ndërkurrikulare: Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm, Edukim për media (nëse përdorim videon)			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja përgatit disa fotografi (mundemi t'i përdorim edhe fotot e paraqitura në librin e nxënësit/et ose të përgatit videon ku i paraqet format e ndryshme të jetesës të dy gjallesave të lidhura ngushtë për njërin-tjetrin për një kohë të gjatë e njohur si simbioza).

Hapi 2

Parashtrohet pyetja para nxënësve:

- Ç'mendoni, a janë të njëjta forma të jetesës së dy gjallesave që jetojnë të lidhura ngushtë për një kohë të gjatë?
- Emërto disa forma të tilla nëse i di.
- Ku dallojnë ato forma?
- Si konceptohen jeta brenda kolonisë dhe si jeta kolektive (shoqërore)?

Informacionet e nxënësve, mësuesi/ja i shënon në tabelë dhe i nënvizon nëse arrijnë të emërtojnë: parazitizmin, komensalizmin, mutualizmin, jeta në koloni e shoqëri.

Hapi 3

Mësuesi/ja paraqet disa fotografi (ose videon) ku i paraqet format e ndryshme të jetesës të dy gjallesave të lidhura ngushtë për njërin-tjetrin për një kohë të gjatë. Ftohen nxënësit/et të lexojnë materialin në tekstin e nxënësit/et dhe shënojnë shenjën (+) mbi fjalitë që mbartin informacion të ri. Mësuesi/ja pyet nxënësit/et a përputheshin njohuritë që diskutuam më parë me ato që lexuam.

Hapi 4

Hapim diskutimin:

Sa lloje të simbiozës kemi?

Sqaro nocionet: parazitizëm, komensalizmi, mutualizmi, jeta në koloni, jeta kolektive (shoqëri)! Cila formë e simbiozës i shkakton dëme gjallesës?

Si ndërtohet koral dhe çfarë shkëmbejnë ato?

Sqaro përmes shembujve të shoqërisë të bletëve dhe të ujqërimit si është e ndarë dhe e organizuar jeta kolektive!

Mësuesi/ja në fund të diskutimit jep sqarime shtesë sipas nevojës:

Parazitizmi shkakton dëme te bujtari. Komensalizmi – gjallesat përfitojnë nga njëra-tjetra.

Mutualizmi – marrëdhëniet midis dy gjallesave ku përfitojnë të dyja palët.

Kolonia e koraleve ndërtohet nga bashkësia e polipeve, shkëmbejnë lëngje dhe substanca ushqyese midis tyre.

Jeta kolektive e bletëve është e mbyllur dhe e ndarë në rangje (Rangu I mbretëresha + mashkulli; Rangu II bletët punëtore)

Jeta kolektive tek ujqërit – formimi i grupeve që quhen kope (ujku, ujkonja të vegjlit).

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë dhënies së përgjigjeve, diskutimit etj. Mësuesi/ja vlerëson pjesëmarrjen e nxënësve në diskutim, saktësinë e përgjigjeve.


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shëno dëmet që shkaktojnë parazitët (krimbat, vemjet, insektet) te bimët dhe te njeriu.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon të kuptuarit se habitatet e ndryshme mbështesin bashkësitë e ndryshme jetësore (kopshti, livadhi, pema, kënetat, përroi etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; II. 6; III. 3; III. 5.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Biomet natyrore dhe ekosistemet e kultivuara			
Fjalët kyçe: bioma tokësore, pyjet tropikale, gjetherënëse (gjethegjera), shkretëtira			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - krijon një hartë të mendimeve duke i organizuar mendimet lidhur me biomet tokësore; - përshkruan pyjet tropikale, pyjet gjethembajtëse dhe shkretëtirat; - paraqit në tabelë kushtet klimatike, bimësinë dhe kafshët në pyjet tropikale, pyjet gjethembajtëse dhe shkretëtirat. Kriteret e suksesit: Shëno një hartë të mendimeve lidhur me pyjet tropikale, pyjet gjethembajtëse dhe shkretëtirat. Sqaro përhapjen, kushtet klimatike, bimësinë dhe kafshët në pyjet tropikale, pyjet gjethembajtëse dhe shkretëtirat. Plotëso tabelën duke i shënuar kushtet klimatike, bimësinë dhe kafshët që hasim në këto pyjet tropikale, pyjet gjethembajtëse dhe shkretëtirat.			
Burimet: teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografitë e pyjeve tropikale, gjetherënëse (gjethegjera), shkretëtirës			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjeografi, Gjuhë shqipe Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Mësuesi/ja prezanton fotografitë e tri biomeve të ndryshme tokësore gjatë diskutimit të tyre. Mësuesi/ja paraqet të dhënat e nxjerrura në hartën e mendime duke kërkuar plotësimin e tyre:



Hapi 2

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të lexojnë tekstin për biomet tokësore dhe të mbajnë shënime të strukturuar. Tekstin e ndan, sipas 3 biomeve tokësore, në tri ndalesa dhe formulon pyetjet rreth secilës ndalesë.

Ndalesa e parë:

- Pse pyjet tropikale quhen biomet tokësore me numrin më të madh të gjallesave?
- Ku shtrihen dhe çfarë kushtesh klimatike mbizotërojnë në pyjet tropikale?
- Emërto disa bimë duke treguar si shpërndahen ato dhe disa kafshë të xhunglave.

Ndalesa e dytë:

- Pse pyjet gjetherënëse (gjethegjera) si biomet tokësore kanë më pak bimësi se pyjet tropikale?
- Emërto disa bimë gjetherënëse (gjethegjera) duke i katëzuar ato?
- Emërto disa kafshë që i hasim në këto pyje?

Ndalesa e tretë:

- Sa sipërfaqe zënë shkretëtirat dhe çfarë kushte klimatike mbizotërojnë?
- Sqaro përmes kaktusit të veçantën e bimësisë dhe përmes devesë të veçantën e kafshëve në shkretëtirë.
- Trego duke sqaruar cilat ekosisteme të veçanta paraqiten në shkretëtirë.

Përzgjedhjen e nxënësve për të dhënë përgjigje bëhet me anë të stilolapsave (poseduesi i stilolapsit të përzgjedhur do të përgjigjet). Mësuesi/ja plotëson duke sqaruar përgjigjet sipas rastit.

Hapi 3

Nxënësit/et nga shënimet e tyre të strukturuar do të bëjnë plotësimin e tabelës të koncepteve:

Biomet tokësore	Kushtet klimatike	Bimët (bimësia)	Kafshët (gjallesat)
Pyjet tropikale)			
Pyjet gjetherënëse (gjethegjera)			
Shkretëtira			

Kjo tabelë paraqitet edhe nga mësuesi/ja në dërrasën e zezë dhe plotësohet gjatë përgjigjeve të nxënësve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE
Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin për përgjigjet dhe plotësimin e tabelës. Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et në dhënien e ideve në plotësimin e hartës së mendimeve, saktësinë e përgjigjeve, saktësinë e marrjes së shënimeve të strukturuar dhe plotësimit të tabelës.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Plotëso fletoren album (fletore pa vija) me disa pamje nga këto biome si: pyjet tropikale, gjetherënëse dhe shkretëtira.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon të kuptuarit se habitatet e ndryshme mbështesin bashkësitë e ndryshme jetësore (kopshti, livadhi, pema, kënetat, përroi etj.). Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; I. 6; II. 7.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Biomat natyrore dhe ekosistemet e kultivuara			
Fjalët kyçe: biomet natyrore dhe ekosistemet e kultivuara (vazhdim)			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - komenton prezantimin e ekosistemeve si livadhet, deti dhe ekosistemet e kultivuara; - interpreton disa karakteristika të livadhit, detit dhe kush i kërcënon ato për shkatërrim; - krahason këto dy ekosisteme me anë të vetive të përbashkëta dhe të veçanta. Kriteret e suksesit: Trego duke e përshkruar livadhin, detin dhe ekosistemin e kultivuar. Sqaro karakteristikat e livadhit dhe detit duke veçuar bimësinë, gjallesat e tyre, si dhe mënyrën e dëmtimit të tyre. Dallo me anë të vetive të përbashkëta dhe të veçanta dy ekosistemet e shqyrtuara.			

Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD me materiale nga interneti

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjeografi, Gjuhë shqipe, Artet

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, Edukim për media

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Mësuesi/ja paraqet me anë të CD-së, pamjet e ekosistemeve të ndryshme (livadhit, deti dhe ekosistemet e kultivuara) pyes nxënësit:

Çfarë vërejtjet në këtë prezantim, cilat ekosisteme janë prezantuar? A kanë këto ekosisteme gjallesa të njëjta dhe bimësi të njëjta? Pse?

Nxënësit/et përgjigjen në pyetjet e bëra dhe mësuesi/ja i shënon në tabelë informacionet e nxënësve.


Hapi 2

Shqyrtojmë pyetjet:

-Pse bimët e livadheve janë të shumëllojshme dhe të shumta për nga numri? Pse rrjetat e rrënjëve janë të dendura dhe të gërshetuara te bimët barishtore? Emërto disa bimë karakteristike të livadheve, si dhe disa bimë parazitë të livadheve? Çfarë sjell kjo shumëllojshmëri e bimëve? A mundeni të përshkruani ndonjë habitat të livadhit duke ndërtuar ndonjë zinxhirë ushqimorë? Nga kush janë të kërcënuara ekosistemet natyrore si livadhet, deti? Sqaro si dhe në ç'mënyrë? Trego si quhen dhe si krijohen ekosistemet e kultivuara.

Hapi 3

Nxënësit/et bëjnë krahasimin e dy ekosistemeve me vetitë e tyre të veçanta dhe vetive të përbashkëta.



Nxënësit/et plotësojnë duke i veçuar vetitë e këtyre ekosistemeve si të veçanta dhe të përbashkëta. Nxënësit/et shkëmbejnë fletoret në dyshe ku vlerësojnë krahasimin e njërit-tjetrit. Dy-tre nxënës lexojnë krahasimin para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin për komentet dhe përgjigjet e dhëna.

Mësuesi/ja vlerëson komentimin e videos të prezantuar, përgjigjeve të dhëna dhe krahasimit të tyre.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Karakteristikat e livadhit dhe detit paraqiti me anë të vizatimit.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon bimët dhe shtazët endemike, të rrezikuara për zhdukje, që jetojnë në Kosovë. Identifikon mënyra për mbrojtje të llojeve bimore dhe shtazore të rrezikuara në Kosovë. Diskuton arsyet e zvogëlimit dhe zhdukjes së disa bimëve ose shtazëve (p.sh. për shkak të gjuetisë së tepruar, sëmundjeve, llojeve invazive, ndryshimeve dhe shkatërtimeve të habitatit).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; I. 6; II. 3; II. 6; III. 3.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Llojet e bimëve dhe kafshëve të rrezikuara në vendin tonë			
Fjalët kyçe: biodiversiteti, flora, fauna, llojet relikte, endemike			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - dallon disa faktorë për zhvillimin e shumëllojshmërinë e florës dhe faunës në Kosovë; - sqaron përhapjen e florës dhe faunës si dhe ruajtjen e ekosistemeve të këtyre gjallesave; - përmbledh me anë të një shkrimi biodiversitetin, rëndësinë dhe mbrojtjen e tyre. Kriteret e suksesit: Veço 3-4 faktorë që kontribuojnë në zhvillimin e shumëllojshmërisë së florës dhe faunës në Kosovë. Shpjego përhapjen e florës dhe faunës duke emërtuar llojet relikte dhe endemike. Shkruaj rreth biodiversitetit, rëndësisë dhe mbrojtjen e tyre në formë të esesë.			
Burimet: teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: harta e Kosovës.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Gjeografi Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja shënon disa fjalë dhe nxënësit/et me anë të tyre formojnë një deri në dy fjali. Fjalët e dhëna janë: Kosova, faktorët, flora, fauna, shumëllojshmëria.			

Dy-tre/i nxënës/e lexojnë fjalitë e formulara. Mësuesi/ja plotëson përgjigjet e nxënësve sipas rastit dhe bën plotësimin me një ligjëratë të shkurtër për kushtet e përshtatshme për zhvillimin e biodiversitetit të florës e faunës të Kosovës.

Hapi 2

Mësuesi/ja ka përzgjedhur paraprakisht 5 nxënës të cilët do ta luajnë rolin e mësuesit. Secilit i caktohet nga një pjesë të këtij materiali.

Nxënësi/ja 1 - Pasuritë e florës në vendin tonë.

Nxënësi/ja 2 - Pasuritë e faunës në vendin tonë.

Nxënësi/ja 3 - Biodiversiteti dhe rëndësia e tij për njeriun. Nxënësi/ja 4 - Si janë të shpërndara bimët dhe kafshët.

Nxënësi/ja 5 - Rëndësia e biodiversitetit.

Ata/ato do ta përgatisin pjesën e caktuar në shtëpi. Nxënësi/ja i/e parë, kërkon nga klasa të lexojnë pjesën e parë në heshtje. Pas leximit, bën një përmbledhje të pjesës së lexuar dhe përgjigjet në pyetjet e nxënësve sipas rastit. Parashtron vet një pyetje rreth pjesës së shpjeguar duke kërkuar përgjigjen në të. Me këtë rast, ai nxjerr idetë dhe gjykimet e nxënësve. Në vazhdimësi, nxënësi/ja sqaron pjesët e paqarta dhe i parapërgatit për pjesën vijuese. Kjo ecuri e punës do të përsëritet edhe me nxënësit/et e tjerë (2-5).

Hapi 3

Kërkojmë nga nxënësit/et të përmbledhin njohuritë e fituara me anë të një eseje (10 min).

Esetë shkëmbehen mes njëri-tjetrit, pra shokun/shoqen e bankës dhe vlerësohen. Dy-tre/i nxënës/e vullnetarë/e i lexojnë esetë e tyre para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin, gjatë shpjegimit të pjesës së caktuar, pyetjeve dhe përgjigjeve, si dhe shkrimit përmbledhës.

Mësuesi/ja vlerëson përmbledhjen e pjesës së caktuar të çdo nxënësi/e, llojit të pyetjeve të parashtruara, përgjigjeve të marra si dhe mënyrën e përmbledhjes së njohurive në formë eseve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetjet dhe detyrat në faqen 83.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Hulumton organizmat e gjetur në një habitat specifik (oborr shkolle, park qyteti, kënetë, lum, pyll, livadh, etj..) dhe i klasifikon organizmat sipas sistemit të klasifikimit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II. 7; III. 3; III. 7; III. 8; IV. 4; IV. 7.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërisë të ekosistemeve, ndërtimi dhe funksioni i sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Punë praktike Të zbulojmë lidhjet ushqimore në pyllin, lulishten ose kopshtin pranë zonës sonë të banimit.			
Fjalët kyçe: metodat hulumtuese			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - zbulon gjallesat në zonën e shkollës; - zhvillon punën praktike në zonën e shkollës duke evidentuar rrjetat dhe zinxhirët ushqimorë; - shpjegon lidhjen dhe varësinë e gjallesave nga njëra-tjetra. Kriteret e suksesit: Veço duke i ndarë dhe emërtuar gjallesat gjatë punës praktike në zonën e shkollës. Formo zinxhirët ushqimorë të dalë nga puna praktike dhe materiali i mbledhur në zonën e shkollës. Trego lidhjen dhe varësinë e gjallesave nga njëra-tjetra me organizmat e vrojtuar në zonën e shkollës.			
Burimet: Natyra (zona e shkollës) Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletore e shënimeve, laps, gota me kapak, aparat fotografik, rrjetat kapëse me shkop për insektet, lupë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjeografi, Matematikë Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja në orën paraprake së bashku me nxënësit/et përpilon një listë të mjeteve të nevojshme për punën praktike që ata do ta zhvillojnë në zonën e shkollës. Lista e mjeteve: fletore e shënimeve, laps, gota me kapak, aparat fotografik, rrjetat kapëse me shkop për insektet, lupë.			

Hapi 1

Mësuesi/ja cakton zonën e shkollës për punën praktike që do ta zhvillohet, duke pasur parasysh edhe sigurinë e nxënësve gjatë punës praktike.

Hapi 2

Mësuesi/ja cakton zonën hulumtuese dhe sigurohet që janë marrë të gjitha mjetet e caktuara në listën e mjeteve. Ndan nxënësit/et në grupe dhe cakton detyrat e grupeve.

Grupi 1- Grumbullon gjallesat pa shtyllë kurrizore (krimbat, insektet, merimangat etj.) Grupi 2- Identifikon dhe përshkruan gjallesat me shtyllë kurrizore.

Grupi 3- Fotografon zogjtë ose gjallesat tjera.

Grupi 4- Mbledhin pjesët e bimëve barishtore, shkurre dhe drunore. Grupi 5- Vrojtajnë me lupë dheun dhe bimësinë.

Grupi 6- Emërton gjallesat e grumbulluara të grupit 1 dhe 2, si dhe formon zinxhirët ushqimorë.

Hapi 3

Diskutohet rreth punës praktike të kryer në grupet, materialeve të grumbulluara.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë punën në grupe.

Mësuesi/ja vlerëson sigurimin e mjeteve të caktuara, materialin e mbledhur, bashkëpunimin në grupe dhe saktësisë të kryerjes së punës praktike.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Përgatitni fletëpalosje me temën: “Planeti im, më i shëndetshëm dhe i gjelbëruar”

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Vlerëson përfitimet që ka shoqëria njerëzore nga biodiversiteti si dhe problemet që shkaktohen nga zvogëlimi i biodiversitetit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; I. 4; I. 6; II. 3; II. 6; III. 3; III. 6; III. 8; IV. 2.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmëria e ekosistemeve, ndërtimi dhe funksioni i sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Të mësuarit nëpërmjet projekteve			
Fjalët kyçe: projekt, biomet ujore, tokësore, ekosisteme natyrore, artificiale.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - tregon se toka përbëhet nga vendbanimet të ndryshme e populluar me gjallesa të ndryshme; - hulumton rreth bimëve dhe kafshëve që janë përshtatur në mjedisin ku ato jetojnë; - harton planin e kujdesit për ruajtjen dhe zhvillimin e biomave natyrore dhe artificiale. Kriteret e suksesit: Shpjego që Toka përbëhet nga vendbanimet e ndryshme, ku secili prej tyre pasqyron veçoritë e popullatave të gjallesave që jetojnë në të. Kërko në internet rreth përshtatshmërinë të bimëve dhe kafshëve në mjedisin jetësor ku ato jetojnë. Projekto projektin mbi ruajtjen dhe zhvillimin e biomave natyrore, si dhe artificiale në mënyra të ndryshme.			
Burimet: teksti i nxënësit, interneti Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kompjuteri, projektori, enciklopeditë shkencore, flipchart, ngjyrat.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjeografi, Kimi, Gjuhë shqipe, Arte, Tik Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm; Edukim për media			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në grupe dhe çdo grup duhet të punojë në një pjesë të projektit: Grupi 1 - Evidenton biomet ujore në të gjithë planetin tonë. Grupi 2 - Evidenton biomet tokësore në të gjithë planetin tonë.			

Grupi 3 - Faktorët abiotikë që ndikojnë në jetën e gjallesave dhe rregullat e formimit të ekosistemeve artificiale.

Grupi 4 - Specifikimi i gjallesave që jetojnë në këto bioma. Grupi

5 - Baraspeshat natyrore.

Grupi 6 - Ndryshimet dhe ngjashmëritë midis biomave të planetit tonë.

Hapi 2

Kërkojmë nga nxënësit/et që të bëjnë kërkime në internet rreth këtyre temave. Këto kërkime mund të plotësohen edhe me informacione nga enciklopeditë e ndryshme shkencore. Informatat e mbledhura të kenë një renditje logjike. Materiali i mbledhur përgatitet në forma të ndryshme (*Powerpoint*, hamer, harta, postera, paraqitje skematike etj.) për prezantim.

Hapi 3

Fillon prezantimi i punimeve. Gjatë prezantimeve hapet diskutimi rreth mënyrës së paraqitjes së këtyre informacioneve. Bëhet vlerësimi.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë prezantimet e paraqitura.

Mësuesi/ja vlerëson bashkëpunimin gjatë punës kërkimore, lidhjen logjike të informacioneve, mënyrën e prezantimit të temave dhe projektin në tërësi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të plotësohen informatat me shembujt nga shteti ynë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Ndikimi pozitiv: për shembull, ruajtja-konservim i biodiversitetit, pyllëzimi; Ndikimi negativ: p.sh., zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2; I. 4; II. 6; III. 5; III. 7.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ndotja			
Fjalët kyçe: njeriu, ndotja, uji, ajri, ngrohja, globale, shiu acidik.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - defnon termin ndotje në mënyrë verbale; - shpjegon mënyrën e ndotjes së ujit dhe ajrit dhe ndikimit të tyre në qeniet e gjalla; - paraqet në mënyrë grafike njohuritë e fituara rreth ndotjes. Kriteret e suksesit: Përkuftizo me fjalë tuaja kuptimin e termit ndotje. Sqaro ndotjen e ajrit dhe ujit si rezultat i ndotësve të ajrit dhe ndotësve të ujit. Krijoh hartën e mendimeve lidhur me ndotjen dhe ndotësit e ujit, ajrit.			
Burimet: teksti i nxënësit			
Lidhja me lëndët tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Kimi Çështjet ndërkurrikulare: Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja parashtron para nxënësve pyetjen: Ç'kuptoni me ndotje? Informacionet e nxënësve shënohen në tabelë. Dalim në përfundim se hedhja e sendeve të dëmshme në mjedis quhet ndotje. Faktori kryesor i ndotjes është njeriu.			

Hapi 2

Kërkojmë nga nxënësit/et që të formojnë në fletore një tabelë me dy shtylla. Në anën e majtë të tabelës, shënojmë pyetjet rreth mësimit, kurse në të djathtë do t'i shënojnë përgjigjet pasi të lexojnë mësimin. Njëkohësisht dhe mësuesi/ja i shënon këto pyetje në tabelë.


Nxënësit/et lexojnë mësimin duke pasur parasysh pyetjet dhe gjetjen e përgjigjeve në to.

Pyetje	Përgjigje
○ Si ndotet uji? ○ Pse ujërat e zeza dëmtojnë qeniet e gjalla? ○ Me cilat aktivitete njeriu ndotë ajrin? ○ Shpjego arsyet e shfaqjes të ngrohjes globale të tokës? ○ Shpjego formimin e shiut acidik?	

Një nxënës/e në mënyrë vullnetare lexon pyetjen e parë dhe dëgjon përgjigjet nga të tjerët ku në fund, ai/ajo lexon përgjigjen e tij. Mësuesi/ja jep sqarime shtesë sipas nevojës. Ecuria e punës është e njëjtë dhe për pyetjet e tjera të radhës. Mësuesi/ja këto përgjigje i paraqet në tabelë para klasës.

Hapi 3

Nxënësit/et në dyshe plotësojnë hartën e mendimeve rreth njohurive të marra për ndotje.



Harta e mendimeve diskutohet brenda grupit dhe plotësohet sipas rastit nga dyshja tjetër.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë dhënies së informacioneve, përgjigjeve dhe plotësimit të hartës së mendimeve.

Mësuesi/ja vlerëson informacionet e dhëna, saktësinë e përgjigjeve, degëzimin dhe lidhshmërinë e ideve rreth ndotjes në hartën e mendimeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të punohet veprimtaria e dhënë në tekst, duke krahasuar ndikimin e ujit të pastër dhe ujit acidik në rritjen e filizave.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2; I. 4; II. 6; III. 3.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Njerëzit dhe zinxhirët ushqimorë			
Fjalët kyçe: mbrojtja, veprimtaria e njeriut, dëmtimet.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - tregon ç'di për kujdesin dhe mbrojtjen e gjallesave nga njeriu gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre jetësore; - kategorizon informatat për kujdesin dhe dëmtimet e bëra në zinxhirët ushqimorë dikur dhe sot gjatë veprimtarive jetësore të njeriut; - krahason këto dy veprime kujdesin dhe dëmtimet e bëra në zinxhirët ushqimorë gjatë ushtrimit të veprimtarive jetësore dikur dhe sot. Kriteret e suksesit: Shpreh së paku 1-2 mendime për kujdesin dhe mbrojtjen e natyrës dhe gjallesave gjatë ushtrimit të veprimtarive jetësore dikur dhe sot. Radhit informatat sipas 4 kategorive, për të treguar kujdesin dhe dëmtimet e bëra në zinxhirët ushqimorë gjatë ushtrimit të veprimtarive jetësore të njeriut dikur dhe sot. Dallo vetitë e përbashkëta dhe të veçanta gjatë kujdesit dhe dëmtimeve të shkaktuara gjatë veprimit të njeriut dikur dhe sot në zinxhirin ushqimor.			
Burimet: teksti i nxënësit			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Histori, Gjeografi, Gjuhë shqipe Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Mësuesi/ja shtron pyetjen: Si mendoni, a janë kujdesur njerëzit për mbrojtjen e hapësirave natyrore dhe gjallesave në kohërat e lashta? Nxënësit/et japin informacione, të cilat shënohen në tabelë.

Hapi 2

Kërkon nga nxënësit/et që të lexojnë materialin mësimor në heshtje, duke vendosur disa shenja (, -, +, ?) me anë të cilave kontrollojnë njohuritë e tyre. Nxënësit/et punojnë individualisht në vënien e shenjave në tekstin e lexuar. Brenda grupit diskutohen informacionet e ndara sipas shenjave, duke e plotësuar njëri-tjetrit rreth informacioneve të paqarta dhe me informatat e dala nga grupi plotësohet tabela.

✓ (inf e njohur)	-(inf e plotësuar)	+(inf e mësuar)	?(inf e paqartë)
- Shumë kohë më parë njerëzit gjenin të gjithë ushqimin e tyre në natyrë. - Mishin e siguronin duke i gjuajtur kafshët. -	- Disa prej kafshëve mund të ushqehen me bimët që rrit fermeri, ndaj ato tani mund të kenë më shumë ushqim se sa para se të pastrohej toka.	- Numri i zogjve shtegtarë në zonën e Ishull-Lezhës ka pësuar rënie. Zogjtë ushqehen me peshq dhe ose ngjala. Mirëpo, edhe njerëzit gjuajnë peshq e ngjala, ndaj shpesh zogjtë nuk gjejnë mjaftueshëm ushqim.	- Çfarë ndërmori Zelanda e Re për mbrojtjen e ekosistemeve të tyre natyrore nga opiumi. - A munden të mbijetojnë njerëzit pa kryerjen e veprimtarive të tyre (peshkimit).

Në fund, nxënësit/et paraqesin para klasës tabelën e plotësuar. Diskutohen informatat e prezantuar në tabelë. Mësuesi/ja plotëson dhe sqaron sipas rastit.

Hapi 3

Mësuesi/ja ndan nxënësit/et në grupe dhe kërkon të bëjnë krahasimin e ndikimit të veprimtarive njerëzore në zinxhirët ushqimorë dikur dhe sot.



Nxënësit/et plotësojnë duke i veçuar si veti të veçanta dhe të përbashkëta disa veprime të ndikimit të veprimtarive njerëzore në ekosisteme, zinxhirët ushqimorë dikur dhe sot.

Nxënësit/et shkëmbejnë fletoret në dyshe ku vlerësojnë krahasimin e njërit-tjetrit. Dy-tre/i nxënës/e lexojnë krahasimin para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrit për bashkëpunimin, zgjedhjen e informatave gjatë plotësimit të tabelës dhe diagramit.

Mësuesi/ja vlerëson njohuritë e nxënësve lidhur me kujdesin dhe dëmtimin e bimëve dhe kafshëve nga njeriu, gjatë veprimtarive jetësore në zinxhirët ushqimorë, dikur dhe sot.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetjet dhe detyrat

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor		Rezultati i të nxënit të temës: Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Ndikimi pozitiv: p.sh., ruajtja-konservim i biodiversitetit, pyllëzimi; Ndikimi negativ: p.sh., zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 4; II. 7; III. 5; III. 7.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ruajtja e mjedisit			
Fjalët kyçe: mjedis, ndotje mbrojtje, ruajtje, habitat			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - tregon ç'di për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj mjedisit; - parashtron pyetje vetes rreth mbrojtjes dhe kujdesit ndaj mjedisit; - organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën e dhënë. Kriteret e suksesit: Rendit së paku 3-4 informata rreth mbrojtjes dhe kujdesit ndaj mjedisit. Formulo së paku dy pyetje të niveleve të ndryshme lidhur me mbrojtjen dhe kujdesin ndaj mjedisit. Shkruaj mendimin tënd për pyetjen/temën e dhënë.			
Burimet: teksti i nxënësit			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Kimi, Gjeografi, Gjuhë shqipe. Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të përgjigjen në pyetjen e parashtruar: - Çfarë dini rreth ruajtjes të mjedisit? Informacionet e nxënësve shënohen në shtyllën e parë të tabelës së paraqitur:			

Di	Dua të di	Mësova
- Toka është mjedis i përbashkët i miliona organizmave. - Përkujdesja ndaj mjedisit ...		

Hapi 2

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të parashtrojnë pyetje se çfarë dëshirojnë të dinë më tepër rreth mbrojtjes së mjedisit në raport me gjallesat (plotësohet shtylla e dytë me pyetjet e nxënësve). Mësuesi/ja iu paraprinë pyetjeve sipas rastit.

Di	Dua të di	Mësova
- Toka është mjedis i përbashkët i miliona organizmave - Përkujdesja ndaj mjedisit ...	- Ç'hapa mundemi të ndërmarrim për pakësimin e ndotjes? - Si bëhet ruajtja e habitateve?	

Nxënësit/et lexojnë materialin mësimor në heshtje duke pasur parasysh gjetjen e përgjigjeve në pyetjet e shtruara.

Hapi 3

Mësuesi/ja i pyet nxënësit/et, nëse i kanë gjetur përgjigjet në pyetjet e shtruara. Përgjigjet shkruhen në shtyllën e tretë të tabelës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin rreth informacioneve, llojit të pyetjeve dhe shpjegimin, vlerëson nxënësit rreth njohurive që kanë për ruajtjen e mjedisit, nivelit të pyetjeve dhe përgjigjeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Mendoni për një habitat afër shkollës apo vendbanimit tuaj, i cili rrezikohet nga veprimtaria njerëzore.

- Përshkruani habitatin.
- Shpjegoni pse është i rrezikuar.
- Propozoni se çfarë mund të bëhet për të mbrojtur habitatin.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon ndryshimet biologjike të pubertetit. Analizon dhe diskuton zhvillimin seksual gjatë cikleve të ndryshme të jetës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 4; I. 6; II. 6; III. 5; V. 9			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmëria e ekosistemeve, ndërtimi dhe funksioni i sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Puberteti. Ndryshimet në organizëm			
Fjalët kyçe: pubertet, hormone ndryshime fizike.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - tregon ndryshimet në trupin e tij krahasuar me vitin e kaluar; - shqyrton ndryshimet biologjike të pubertetit; - krahason ndryshimet fizike të pubertetit mes vajzave dhe djemve.			
Kriteret e suksesit: Dallon së paku 3 ndryshime fizike në trupin e tij krahasuar me vitin e kaluar. Shpjego së paku 4-5 ndryshimet biologjike të pubertetit. Paraqit ndryshimet fizike të vajzat dhe të djemtë në pubertet me anë të diagramit të Venit.			
Burimet: teksti i nxënësit Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografitë			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Edukata fizike, sportet dhe shëndeti Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Mësuesi/ja hap një bisedë me nxënësit/et rreth pyetjes:

A vëreni ndryshime në trupin tuaj, krahasuar me vitin e kaluar? Informacionet e nxënësve shënohen në tabelë.

Hapi 2

Mësuesi/ja sqaron se këto ndryshime i takojnë fazës së pubertetit. Pastaj shtron pyetjen: Çfarë kuptoni me pubertet?

Duke i drejtuar nxënësit, dalim në përfundim se puberteti është proces i ndryshimeve fizike, emocionale nëpër të cilin kalojnë gjithë njerëzit.

Shqyrtojmë me nxënësit/et pyetjen:

Si mendoni, a e përjetojnë të gjithë njësoj kalimin nga faza e fëmijërisë në atë të pubertetit? Gjatë shqyrtimit të përbashkët dalim në përfundim që ky kalim është i veçantë për çdo njeri.


Si mendoni, kur fillon puberteti te vajzat, djemtë dhe cilat janë ndryshimet që ato/ata pësojnë? A i keni ndarë këto shqetësime me prindërit ose me ndonjë shokun ose shoqen tuaj?

Dalim në përfundim që te vajzat, mosha e fillimit të pubertetit është 8-13 vjeç, ndërsa te djemtë 10-16 vjeç.

Tregohen ndryshimet fizike që ndodhin tek ata gjatë pubertetit, të shoqëruara dhe me fotografi në tekst. Në përgjithësi, puberteti është një periudhë “e pakëndshme”, sepse ndryshimet që shkaktohen në trup nga hormonet janë të shumta.

Hapi 3

Nxënësit/et i paraqesin këto ndryshime fizike me anë të diagramit të Venit.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë përgjigjeve, si dhe gjatë punës individuale në fund. Mësuesi/ja vlerëson përgjigjet e nxënësve gjatë shqyrtimit si dhe krahasimin e ndryshimeve fizike gjatë pubertetit te vajzat dhe djemtë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetjet dhe detyrat

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e Njeriut		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon procesin e rritjes dhe zhvillimit, proceseve riprodhuese njerëzore dhe problemet e abuzimit seksual. Identifikon institucionet ku mund të kërkojnë ndihmë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I. 4; I. 2; I. 6; III. 3; V. 7; VI. 4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla pavarësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmëria e ekosistemeve, ndërtimi dhe funksioni i sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Abuzimi seksual dhe institucionet ku mund të kërkohet ndihmë			
Fjalët kyçe: abuzim seksual, jo i drejtpërdrejtë, telefon, rrjete sociale, foto			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - tregon ç'kupton me termin “abuzim”; - shpjegon përmes diskutimit mënyrat e ndryshme të abuzimit; - vlerëson rëndësinë e paraqitjes së abuzuesve në institucionet ku mund të kërkojnë ndihmë adekuate. Kriteret e suksesit: Sqaro me fjalë tuaja kuptimin e fjalës “abuzim”. Shqyrto përmes shembujve të dhënë çfarë problemesh paraqet abuzimi. Arsyeto me së paku 3-4 arsye rëndësinë e prindërve në uljen e përqindjes së abuzimit seksual.			
Burimet: teksti i nxënësit, interneti Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kompjuteri, projektori, CD me videon e përgatitur.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Edukatë qytetare Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja paraqet një video ku mundën të vërehen disa forma të abuzimit si: me telefon, me anë të fotografive të pahijshme në kompjuter, ngacmime seksuale online.			
Hapi 1 Mësuesi/ja hap një bisedë me nxënësit/et rreth situatave abuzuese të paraqitura në videon e dhënë me pyetjet:			

- Ç'kuptoni me termin abuzim?
- A identifikuat ndonjë situatë ku jeni gjetur ju apo shoku/shoqja juaj?
- Nëse po, e keni biseduar për këtë? E keni denoncuar abuzuesin?
- A kanë pasoja fëmijët e abuzuar seksualisht? Si ndihen ata?

Nga biseda del se abuzimi seksual i fëmijës është përfshirja e një fëmije në një aktivitet seksual, për të cilin fëmija nuk është i përgatitur fizikisht dhe është i/e paaftë të japë miratimin, duke shkelur ligjet dhe tabutë sociale të shoqërisë.

Fëmijët e abuzuar seksualisht kanë pasoja të mëdha fizike dhe emocionale, të cilat ndikojnë edhe në fazat e mëvonshme të jetës. Fëmija i abuzuar seksualisht ndihet i frikësuar, i shqetësuar ose në gjendje konfuze, ndihet i turpëruar dhe fajëson veten. Nuk janë të gatshëm të denoncojnë abuzuesin.

Hapi 2

Mësuesi/ja fton nxënësit të diskutojnë rreth bisedës telefonike të lexuar nga ana e tij/saj:

- Si mendoni, a mund të themi se edhe kontakti jo i drejtpërdrejtë paraqet abuzim seksual?
- Si do të kishit vepruar ju në vend të Violës?
- Si mendoni ju, cilët individ munden t'i dalin në ndihmë Violës? Po juve, sikur të gjendeshit në raste të tilla?

Nga diskutimi me nxënësit dalin këto përfundime:

Edhe kontakti jo i drejtpërdrejtë, si ngacmim me telefon, fotot e pahijshme në kompjuter apo ngacmimet seksuale online janë abuzime seksuale me pasoja emocionale, mendore. Prindërit, mësuesit, psikologët, mjekët dhe punonjësit që të mbrojnë të drejtat e fëmijëve.

Hapi 3

Nxënësit duhet të shkruajnë përgjigjen në fletore.

- Si munden të ulin përqindjen e abuzimeve të fëmijëve, prindërit?

Disa nxënës të përzgjedhur me anë të lapsave lexojnë shkrimet e tyre dhe mësuesi/ja bën një përmbledhje: Prindërit duhen të jenë të kujdesshëm dhe të informuar me kë shoqërohet fëmija i tyre.

Duhet të inkurajojnë fëmijët në biseda të hapura me ta rreth ndodhive në shkollë apo jashtë saj.

Kontrollojnë faqet e rrjeteve sociale që përdorin fëmijët dhe mësojnë fëmijën si të mbrohet në raste të tilla.

Hapi 4

Nxënësit/et kontrollojnë njohuritë e tyre me anë të një mini testi.

Testo veten:

Shënoni (V) nëse thënia është e vërtetë, ose (G) nëse është e gabuar.

- Abuzimi seksual me fëmijët ka pasoja fizike dhe emocionale tek ata. _____
- Fëmijët nuk janë të gatshëm për të denoncuar abuzuesit. _____

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë paraqitjes së njohurive rreth abuzimeve të ndryshme fizike.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetjet dhe detyrat

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VI	
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut	Rezultati i të nxënit të temës: Vlerëson rëndësinë e higjienës personale për shëndetin e tyre.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.2; I.6; III.8	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmëria e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: 3.2 Higjiena personale	
Fjalët kyçe: higjiena personale, shëndet.	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: 1-Tregon ç'kupton me termin <i>higjienë</i> . 2-Shpjegon mbajtjen e higjienës personale. 3-Vlerëson rëndësinë e higjienës personale për shëndetin e tyre.	
Kriteret e suksesit: 1-Sqaro me fjalë tuaja kuptimin e fjalës <i>higjienë</i> . 2-Trego mbajtjen e higjienës personale duke e demonstruar atë. 3-Arsyeto me së paku 2 arsye rëndësinë e higjienës personale për shëndetin tënd.	
Burimet: Teksti i nxënësit	
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa, furçë dhëmbësh, krehër, danga të thonjve.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Edukata qytetare	
Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	

Hapi 1. Arsimtari/ja hap një bisedë me nxënës/e rreth pyetjeve:

-Çfarë kuptoni me higjienë?

-A kujdeseni edhe ju për trupin tuaj?

Nga biseda del që higjienë do të thotë rregulla për një shëndet më të mirë, që largojnë bakteriet dhe viruset prej trupit tonë.

-Higjiena personale përfshin higjienën e trupit, të duarve, të kokës, të këmbëve, të gojës.

Hapi 2. Formojmë 5 grupe të nxënësve ku secilit grup përzgjedh një etiketë me mbajtjen e higjienës të pjesës e caktuar të trupit:

- higjienën e trupit; të duarve; të kokës; të këmbëve; të gojës.

Hapi 3. Përfaqësuesi/ja i/e çdo grupi paraqet para klasës mënyrën e mbajtjes së higjienës të pjesës të caktuar të trupit duke bërë një demonstrim të thjeshtë.

Hapi 4. Nxënësit/et kontrollojnë njohuritë e tyre me anë të një minitesti.

Testo veten:

Shënoni (V) nëse thënia është e vërtetë, ose (G) nëse është e gabuar.

- Higjienë do të thotë rregulla për një shëndet më të mirë. _____
- Higjiena personale përfshinë vetëm higjienën e trupit. _____

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë paraqitjes së njohurive rreth higjienës personale dhe demonstrimin e saj.

Arsimtari/ja vlerëson njohuritë e nxënësve rreth higjienës personale dhe hapave të mirëmbajtjes së saj.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Pyetje dhe detyra

Dt. _____

Test – Biologji

Emri dhe mbiemri _____ Kl. _____

1. Cila qelizë mundet të vërehet pa mikroskop? (7 pikë)

- a) Qeliza bakteriale
- b) Qeliza epiteliale
- c) Veza e shpendëve

2. Njësia më e vogël ndërtuese e gjallesave është: (7 pikë)

- a) qeliza.
- b) indi.
- c) organi.

3. Cili protozorë shkakton sëmundjen e malarjes? (9 pikë)

4. Shënoni tre faktorë që mundësojnë shumimin e shpejtë të mikroorganizmave. (9 pikë)

_____,
_____, _____

5. Nga lëndët e poshtëshënuara, rrethoni lëndën organike: (9 pikë)

Buka, uji, lëkura, frutat, shkumësi, druri

6. Skiconi një kërpudhë, duke i shënuar pjesët e saja ndërtuese. (10 pikë)

7. Dalloni së paku 3 veti të përbashkëta dhe 3 veti të veçanta të bimëve njëthelbore dhe bimëve dythelbore. (10 pikë)

Bimët njëthelbore (Veti e veçantë)

Bimët njëthelbore dhe bimët dythelbore (Veti e përbashkët)

Bimët dythelbore (Veti e veçantë)

8. Përshkruani një bimë pa lule me 3-4 veti, por që është e gjelbërt gjatë vitit. (10 pikë)

9. Si mendoni, çfarë ndodh me majanë në brumin e bukës, pasi është pjekur buka? (14 pikë)

10. Cili është dallimi ndërmjet teorisë dhe ligjit? Argumentoni përgjigjen. (15 pikë)

Pikët	0-39	40-54	55-69	70-84	85-100
Nota	1	2	3	4	5

Arsimtari/ja:

Dt. _____

TEST – BIOLOGJI

Emri dhe mbiemri _____ Kl. _____

1. Faktor fizik është: (7 pikë)

- a) Oksigjeni;
- b) Temperatura;
- c) Hidrogjeni.

2. Mjedisi përbëhet nga vendi dhe gjallesat. (7 pikë)

- a) E saktë;
- b) e pasaktë.

3. Cilat gjallesa ndihmojnë në krijimin e humusit?

4. Çfarë është habitat? (9 pikë)

5. Shënoni disa forma të simbiozës: (9 pikë)

_____, _____, _____

6. Lidhni emërtimet e kolonës 1 me çfarë paraqesin ato në kolonën 2. (10 pikë)

Kolona 1	Kolona 2
Biocenoza	Vendbanimi
Biotop	Vendbanimi gjallesat
Ekosistem	Gjallesat

7. Skiconi një zinxhir ushqimor të mjedisit tokësorë, i cili duhet të përmbajë: një prodhues, një konsumator I, një konsumator II, një konsumator të lartë dhe një dekompozitor. (10 pikë)

8. Vendosni në radhë sipas shkallës hierarkike: Ekosistem, popullatë, bashkësi biologjike, gjallesë.

(10 pikë)

1 _____, 2 _____,
3 _____, 4 _____.

9. Shpjegoni si ndikojnë vendet e grumbullimit të mbeturinave në mjedisin ku jeton me 3 argumente?

(14 pikë)

10. Vlerësoni, a është abuzimi seksual vendosja e fotografive të pahijshme në internet nga një individ i njohur apo i panjohur?

(15 pikë)

Pikët	0-39	40-54	55-69	70-84	85-100
Nota	1	2	3	4	5

Arsimtari/ja:

REFERENCA

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2016.

Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës, gusht 2016.

Kurrikulat lëndore/programet mësimore për lëndën *Biologji* 6, Prishtinë, Kosovë.

Standarde për tekstet shkollore, Prishtinë, 2011.

E. Ruka, L. Memushi, Z. Bajrami, Biologjia 3, Tiranë, Shqipëri.

Prentice Hall Science Explorer, From Bacteria to Plants, Human Biology and Health, 2005.

Pjesë të përzgjedhura nga Ligji “Për shëndetin riprodhues”, i Republikës së Kosovës:

https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L76_al.pdf

https://www.helpsteaching.com/questions/Biology/Grade_7

<https://www.dreamstime.com>

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:57(072)(075.2)

Gaxha, Diana

Biologjia 6 : libër për mësuesin/en : për klasën e 6-të të
arsimit 9-vjeçar / Diana Gaxha . - Prishtinë : Pegi, 2024. - 134 f.
: ilustr. : 20.7 x 28 cm.

ISBN 978-9951-843-25-6